



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 31

Tiranë – E hënë, 29 shkurt 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 3, datë 23.2.2016	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve nr. 485, datë 4.6.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë; nr. 816, datë 18.3.2014 të Gjykatës së Apelit Shkodër; nr. 00-2015-623, datë 9.3.2015 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi). Pezullimin e ekzekutimit të vendimeve të mësipërme.....
	2451
Vendimi Gjykatës Kushtetuese nr. 4, datë 23.2.2016	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të nenit 169 të Kodit Civil në pjesën që nuk njeh të drejtën subjektive të ish-pronarit që të kompensohet për humbjen e pasurisë me ekuivalencën e vlerës së saj.....
	2458
Vendimi Gjykatës Kushtetuese nr. 5, datë 23.2.2016	Me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosarsyetimit brenda një afati të arsyeshëm të vendimit nr. 1761, datë 9.9.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.....
	2464
Vendimi Gjykatës Kushtetuese nr. 6, datë 23.2.2016	Me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm.....
	2467
Vendimi Gjykatës Kushtetuese nr. 7, datë 24.2.2016	Me objekt kundërshtimin e vendimit nr. 48/2015 të Kuvendit të Shqipërisë “Për mosdërgimin në Gjykatën Kushtetuese të çështjes për konstatimin e papajtueshmërisë me detyrën e deputetit të zotit Koço Kokëdhima” dhe konstatimin e antikushtetutshmërisë së këtij vendimi. Konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetit për zotin Koço Kokëdhima. Interpretimin e nenit 70 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
	2471

Vendimi Gjykatës Kushtetuese nr. 8, datë 26.2.2016	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve nr. 381, datë 12.3.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 138, datë 13.2.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2013-1013, datë 19.7.2013 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).....	2488
Vendimi Gjykatës Kushtetuese nr. 9, datë 26.2.2016	Me objekt papajtueshmërinë e paragrafit të dytë të nenit 55 të Kodit Penal dhe të paragrafit të katërt të nenit 278 të Kodit Penal me nenet 7, 17/1, 135/1 dhe 145/1 të Kushtetutës.....	2492

**VENDIM****Nr. 3, datë 23.2.2016****NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 16.11.2015 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 61/19 Akti, që i përket:

KËRKUESE: Shoqëria “Albsig” sh.a.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Pashko Curri, Banka Kombëtare Tregtare sh.a.

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. 485, datë 4.6.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë; nr. 816, datë 18.3.2014 të Gjykatës së Apelit Shkodër; nr. 00-2015-623, datë 9.3.2015 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).

Pezullimin e ekzekutimit të vendimeve të mësipërme.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 42, 124, 131/f, 132/1 dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27 e vijues dhe 45 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fatmir Hoxha, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, të cilat kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:**I**

1. Nga materialet bashkëlidhur kërkesës rezultoi se provuar se shtetasi Pashko Curri ka lidhur me shoqërinë “Alb-Siguracion” sh.a. (*Albsig*) kontratën e datës 6.8.2009 për sigurimin nga zjarri dhe rreziqet shtesë për pasurinë e paluajtshme dhe të luajtshme të një kompleksi turistik në zonën e Shëngjinit, Lezhë, në pronësi të këtij shtetasi. Kontrata ishte e vlefshme për një afat 1-vjeçar.

2. Në datën 30.10.2009 është vërtetuar ngjarja e sigurimit, një zjarr që ka shkatërruar tërësisht pronën e siguruar, dhe subjekti i interesuar i është drejtuar shoqërisë së sigurimit për t’a dëmshpërblyer për dëmin e shkaktuar.

3. Shoqëria “Albsig” sh.a., duke pretenduar se nuk është vërtetuar ngjarja e sigurimit e parashikuar në kontratë, pra zjarri aksidental, pasi sipas saj zjarri ka qenë i qëllimshëm, ka refuzuar pagesën e shumës së pretenduar.

4. Për këto arsye subjekti i interesuar Pashko Curri i është drejtuar me padi gjykatës me objekt detyrimin e shoqërisë “Albsig” sh.a. të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga kontrata e sigurimit dhe t’i paguajë atij shumën 28.500.000 lekë për dëmin material të shkaktuar, shumën 3.826.831 lekë si fitim i munguar për 180 ditë, shumën 325.345 lekë si fitim i munguar dhe interesa për periudhën 30.4.2010-11.5.2012, kurse nga data 11.5.2012 deri në likuidimin e detyrimit të paguajë një fitim prej 3.943 lekësh në ditë.

5. Me vendimin nr. 485, datë 4.6.2012, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka vendosur: “*Pranimin e pjesës së padisë së paditësit Pashko Curri. Detyrimin e shoqërisë “Alb-Siguracion” sh.a. Tiranë të dëmshpërblejë paditësin Pashko Curri në shumën 32.326.831 (tridhjetë e dy milionë e treqind e njëzet e gjashtë mijë e tetëqind e tridhjetë e një) lekë. Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër.*”.

6. Me vendimin nr. 816, datë 18.3.2014, Gjykata e Apelit Shkodër ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të mësipërm.

7. Me vendimin nr. 00-2015-623, datë 9.3.2015, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga shoqëria “Albsig” sh.a.



II

8. **Shoqëria “Albsig” sh.a.** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë sipas objektit, duke parashtruar këto shkaqe në mënyrë të përmbledhur:

8.1. *Është cenuar e drejta e aksesit* në gjykim. Gjykata e Apelit Shkodër e ka zhvilluar gjykimin në mungesë të kërkuarit (palë e paditur në proces). Po ashtu, kjo gjykatë nuk ka zbardhur në kohë vendimin dhe nuk i ka komunikuar vendimin e plotë të arsyetuar kërkuarit. Për të kapur afatet kërkuar ka depozituar rekurs brenda afatit ligjor, megjithatë ky rekurs nuk është depozituar asnjëherë i plotë në kushtet e moskomunikimit të vendimit nga Gjykata e Apelit. Ishte detyrë e administratës gjyqësore të njoftonte kërkuarin dhe t'i komunikonte vendimin, veçanërisht në kushtet kur gjykimi është bërë në mungesë dhe pa dijeninë e tij.

8.2. *Është cenuar parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi gjykatat e faktit kanë mbajtur qëndrim të njëanshëm, duke marrë në shqyrtim vetëm provat e paraqitura nga pala paditëse në gjykim. Gjykatat e faktit nuk janë investuar për të marrë dokumente shkresore ose prova me ekspert, ndonëse ka pasur kërkime në lidhje me këto nga kërkuar. Ato kanë anashkaluar ekspertimin piroteknik apo thirrjen e një grupi ekspertësh për të provuar dhe marrë një mendim të specializuar për ngjarjen. Gjykatat kanë gabuar edhe në lidhje me vlefshmërinë e provave të marra nga dosja penale, e cila ishte ende nën hetim.

8.3. *Është cenuar parimi i gjykimit nga një gjykatë e paanshme*, pasi i njëjti trup gjykues i Gjykatës së Apelit Shkodër ka shqyrtuar si çështjen e themelit, ashtu edhe kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të formës së prerë të kësaj gjykate. Kërkuar i është drejtuar gjykatës me kërkesë për përjashtim të trupit gjykues, e cila nuk është pranuar. Megjithatë, pa u arsyetuar vendimi për kërkesën për përjashtimin e trupit gjykues, kërkesa për pezullim u pushua për mungesë të kërkuarit.

8.4. Gjykatat e kanë bazuar vendimin e tyre në fakte e rrethana që nuk rezultojnë nga një vlerësim i drejtë i të gjitha provave në gjykim, si rrjedhojë kanë keqinterpretuar e keqzbatuar dispozitat ligjore. Gjykatat kanë lejuar vazhdimin e gjykimit pa u paguar taksa e padisë, ndërkohë

që duhej të kthenin aktet për plotësimin e të metave të padisë. Duke lejuar shkeljet procedurale të paditësit dhe personit të tretë në gjykim, gjykatat janë treguar të njëanshme.

8.5. *Është cenuar standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor*. Gjykata e Apelit ka vendosur në pjesën arsyetuese të vendimit të saj të gjithë arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë, ndërsa Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk ka dhënë arsytet se përse shkaqet e paraqitura në rekurs nuk janë të parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile (KPC).

8.6. Gjykata e Lartë nuk ka marrë parasysh pretendimet e ngritura në rekurs dhe nuk ka korrigjuar mangësitë dhe gabimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta, edhe pse janë të tilla që parashikohen në nenin 472 të KPC-së.

8.7. Gjykata e Lartë për të njëjtën çështje ka mbajtur qëndrime të ndryshme. Me vendimin e datës 12.8.2014, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Apelit, ndërkohë që vetëm 7 muaj më vonë ka vendosur mospranimin e rekursit.

9. **Subjekti i interesuar Pashko Curri** në prapësimet me shkrim drejtuar Gjykatës, ka parashtruar sa vijon:

9.1. Pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit është i pabazuar, pasi mospjesëmarrja në gjykimin në apel nuk është për faj të gjykatës. Sipas ligjit, gjykimi në apel bëhet me shpallje, sikurse është bërë në rastin konkret. Në dosjen gjyqësore ndodhet lista e çështjeve për gjykim, ku përfshihet në numrin rendor 8 edhe çështja në fjalë. Shpallja është bërë në këndin e Gjykatës së Apelit, por edhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë, në formën e kërkuar nga ligji. Kjo provohet me shkresën nr. 2405/1 prot., datë 10.11.2015 të Kancelares së Gjykatës së Apelit Shkodër, sipas së cilës lista e gjykimeve për muajin mars 2014, ku përfshihet edhe çështja e kërkuarit, është dërguar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë me e-mailin e datës 17.2.2014 dhe është konfirmuar marrja dhe afishimi pranë këndit të njoftimeve nga kancelari i asaj gjykate.

9.2. Kërkuar është njohur me vendimin e Gjykatës së Apelit, çka provohet me faktin se rekursi në përmbajtje dhe formë paraqitet i plotë, si edhe me faktin se kërkuar ka paraqitur në Gjykatën e Lartë edhe kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit.



9.3. Pretendimi për cenimin e parimit të kontradiktoritetit është i pabazuar. Gjatë gjykimit në gjykatat e zakonshme është zhvilluar një proces i rregullt gjyqësor, ku palëve u është garantuar zhvillimi i një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm. Në ankimin civil kërkuar nuk ka paraqitur ndonjë kërkesë për marrje prove apo për të caktuar grup ekspertësh, për pasojë çdo pretendim i mëvonshëm nuk përbën shkelje procedurale, aq më tepër të nivelit kushtetues.

9.4. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë e ka shqyrtuar rekursin duke iu përmbajtur kriteret të përcaktuara në nenin 467 në lidhje me nenin 472 të KPC-së dhe vendimi ka respektuar standardin e arsytimit. Në pjesën hyrëse të vendimit janë pasqyruar rigorizisht shkaqet e ngritura në rekurs, të cilat konstatohet lehtësisht se nuk janë të karakterit ligjor, por kanë të bëjnë me çështje fakti.

9.5. I pabazuar është edhe pretendimi se Gjykata e Lartë ka mbajtur dy qëndrime të ndryshme, pasi në rastin konkret jemi para dy vendimeve të ndryshme. Edhe pse jemi para së njëjtës çështje, vendimet kanë objekte të ndryshme dhe për pasojë funksioni i Gjykatës së Lartë në shqyrtimin e tyre ka qenë i ndryshëm.

10. **Subjekti i interesuar, Banka Kombëtare Tregtare sh.a.,** në prapësimet me shkrim drejtuar Gjykatës, ka parashtruar sa vijon:

10.1. Në kundërshtim me sa pretendon kërkuar janë zhvilluar procese të rregullta gjyqësore në të tria shkallët e gjykimit dhe nuk janë kryer shkelje të rregullave procedurale, aq më tepër ndonjë shkelje e të drejtave kushtetuese që të lejonte investimin e Gjykatës Kushtetuese në këtë çështje.

10.2. Vendimet gjyqësore janë rrjedhojë e një analize të hollësishme të kërtimeve në padi dhe të qëndrimeve të palëve ndërgjyqëse, si dhe e një analize të plotë dhe të hollësishme të provave. Fakti që kërkuar nuk ka marrë pjesë në gjykimin në apel nuk e bën të cenueshëm procesin, pasi nga ana e gjykatës nuk është kryer apo lejuar ndonjë shkelje që cenon të drejtat e palëve në gjykim. Është detyrë e vetë palëve të informohen mbi shpalljet e datave të seancave në Gjykatën e Apelit dhe jo detyrim i kësaj të fundit të lajmërojë palët me fletëthirrje.

10.3. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka konstatuar se gjykatat e zakonshme kanë vepruar

në përputhje me ligjin dhe duke dhënë vendime të arsyetuara. Kërkuar kishte kohën e mjaftueshme dhe mundësinë të paraqiste një rekurs të plotë, për më tepër që ai dispononte vendimin e Gjykatës së Apelit, për sa kohë që ka paraqitur kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të atij vendimi.

10.4. Pretendimi se Gjykata e Lartë ka mbajtur dy qëndrime të ndryshme për të njëjtën çështje është i pabazuar. Nga pikëpamja ligjore nuk kemi të bëjmë me dy qëndrime të ndryshme, pasi në marrjen e vendimit nr. 301/2014 për pezullimin e ekzekutimit Gjykata e Lartë e ka shtrirë gjykimin vetëm në ekzistencën e kushteve për pezullim, ndërsa në marrjen e vendimit nr. 623/2015 ajo ka shqyrtuar shkaqet e ngritura në rekurs.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuar

11. Gjykata vëren se kërkuar legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të rregullimit kushtetues të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, si dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit të parashikuar nga neni 30/2 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

12. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar në mënyrë të vazhdueshme se interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor, kurse problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave. Gjykata ndërhyr në ato raste kur, përmes veprimeve të tyre, gjykatat e zakonshme cenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Në këto raste, Gjykata nuk bën rivlerësimin e fakteve e të rrethanave, por një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm.



Detyra e Gjykatës nuk është zgjidhja e një mosmarrëveshjeje juridike për çështje fakti, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj dhe përbëjnë elementin thelbësor në përcaktimin e autoritetit të një gjykimi kushtetues (*shih vendimin nr. 62, datë 23.9.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Bazuar në këto standarde, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuarit se gjykatat e kanë bazuar vendimin e tyre në fakte e rrethana që nuk rezultojnë nga një vlerësim i drejtë i të gjitha provave në gjykim, se kanë keqinterpretuar e keqzbatuar dispozitat ligjore dhe nuk kanë marrë masat për plotësimin e të metave të padisë, apo se Gjykata e Lartë ka mbajtur qëndrime të ndryshme për të njëjtën çështje nuk janë ngritur në nivel kushtetues, për rrjedhojë nuk mund të bëhen objekt i kontrollit kushtetues. Po ashtu, pretendimi për cenimin e parimit të paanshmërisë në gjykim i referohet një procesi të ndryshëm, që ka të bëjë me shqyrtimin nga ana e Gjykatës së Apelit të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të vendimit të formës së prerë, i cili nuk është objekt i kërkesës në shqyrtim. Për pasojë, kërkuari nuk legjitimohet *ratione materiae* në lidhje me këto pretendime.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit në gjykim

14. Kërkuari pretendon cenimin e së drejtës së aksesit në gjykim, pasi Gjykata e Apelit Shkodër jo vetëm e ka zhvilluar gjykimin në mungesë të tij, por edhe nuk ka e zbardhur në kohë dhe nuk i ka komunikuar vendimin e arsyetuar, në mënyrë që të paraqiste në Gjykatën e Lartë një rekurs të plotë me të gjitha argumentet kundër atij vendimi. Sipas kërkuarit ishte detyrë e administratës gjyqësore të njoftonte kërkuarin dhe t'i komunikonte vendimin, veçanërisht në kushtet kur gjykimi është bërë në mungesë dhe pa dijeninë e tij.

15. Në nenin 42/2 të Kushtetutës parashikohet se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për

të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, por edhe të drejtën për të pasur prej saj një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Në rast se mohohet kjo e drejtë procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (*shih vendimin nr. 8, datë 26.2.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Gjykata vëren se e drejta për t'u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshme të individit. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjake në raport me palën kundërshtare. E drejta për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 34, datë 25.7.2011; nr. 18, datë 23.4.2013; nr. 51, datë 21.11.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Gjykata ka vlerësuar se kontrolli i kushtetutshmërisë së një vendimi gjyqësor vlerësohet në një kontekst të caktuar faktesh që lidhen me të drejtën për proces të rregullt ligjor. Rastet që i paraqiten Gjykatës mbi bazën e ankimit të individëve, duhet të shqyrtohen domosdoshmërisht në bazë të provueshmërisë së fakteve të dhëna. Marrja e vendimit për çështje kushtetuese kondicionohet nga përcaktimi i



fakteve kushtetuese, mbi bazën e të cilave vlerësohet respektimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Përderisa Gjykata Kushtetuese ka autoritetin për të vendosur përfundimisht për çështje të kushtetutshmërisë së procesit gjyqësor, ajo nuk mund ta ushtrojë këtë kompetencë pa analizuar faktet e natyrës kushtetuese (*shih vendimin nr. 5, datë 2.3.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Gjykata, bazuar në aktet e dosjes gjyqësore, vëren se gjykimi në Gjykatën e Apelit është bërë në mungesë të kërkuarit. Me shpalljen e datës 14.2.2014 administrata e Gjykatës së Apelit Shkodër ka bërë njoftimin për seancën gjyqësore të datës 13.3.2014. Në këtë seancë kërkuari nuk është paraqitur dhe gjykata ka marrë vendim për zhvillimin e gjykimit në mungesë të tij, pasi rezultoi se ka dijeni dhe pa shkaqe të arsyeshme nuk është paraqitur në gjykim (procesverbali i datës 13.3.2014). Seanca e radhës për shpalljen e vendimit është caktuar nga gjykata në datën 18.3.2014, në të cilën sërish kërkuari nuk ka qenë i pranishëm.

19. Në lidhje me njoftimin për datën e seancës së parë gjyqësore në dosjen gjyqësore është administruar shpallja e bërë nga Gjykata e Apelit Shkodër. Neni 460 i KPC-së parashikon se njoftimi për ditën dhe orën e gjykimit bëhet nga gjykata e apelit me shpallje pranë saj dhe në gjykatat përkatëse të shkallës së parë. Megjithatë nga dosja gjyqësore nuk rezulton nëse kjo shpallje është bërë edhe pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

20. Nga aktet e çështjes konkrete në shqyrtim rezulton, gjithashtu, se në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë kërkuari ka pretenduar se janë shkelur procedurat për një gjykim të drejtë e të paanshëm për shkak të zhvillimit të gjykimit pa u njoftuar pala e paditur. Sipas tij sekretaria e Gjykatës së Apelit nuk e ka nxjerrë shpalljen në stendat ku bëhen njoftimet për gjykimet civile dhe penale, për pasojë ai nuk ka pasur mundësi të informohet në lidhje me datën e gjykimit, si dhe nuk e ka njoftuar kërkuarin nëpërmjet numrit të telefonit. Ai ka pretenduar se edhe pas konstatimit të mungesës së kërkuarit në seancën e parë në Gjykatën e Apelit, nuk është njoftuar me fletëthirrje për seancën tjetër të gjykimit. Megjithatë, Gjykata vëren se ndonëse kërkuari i ka ngritur këto pretendime në rekurs, ato nuk rezultojnë të jenë pasqyruar në vendim, ndërkohë

që në të rezulton se janë pasqyruar vetëm disa shkaqe që kanë të bëjnë me themelin e çështjes.

21. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se pasqyrimi i shkaqeve të rekursit në pjesën hyrëse të vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë përbën një element të domosdoshëm dhe të rëndësishëm të tij, i cili nuk ka thjesht karakter formal në përmbajtjen e vendimit gjyqësor dhe se mungesa e paraqitjes së shkaqeve të parashtruara në rekurs, në vendimin e Gjykatës së Lartë, krijon dyshime, ndër të tjera, edhe për realizimin efektiv të së drejtës së aksesit në gjykatë nga ana e kërkuarve. Mosparaqitja e shkaqeve të parashtruara në vendim, përveçse është një e metë serioze e arsytimit, lë shkas për ekuivoke e dyshime në lidhje me marrjen në shqyrtim dhe vlerësimin e pretendimeve të kërkuarit nga ana e Gjykatës së Lartë (*shih vendimin nr. 29, datë 22.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Ky raport ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit). Një qëndrim i ndryshëm do ta kthente Gjykatën Kushtetuese në një instancë të zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj. Gjykata rithekson se roli i Gjykatës së Lartë, si gjykatë e ligjit, është i një natyre të pazëvendësueshme. Ajo i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për ta bërë vetë këtë rol aktiv, që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar efektivisht edhe në vendimmarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta, veçanërisht në rastet kur dy gjykata i kanë dhënë përgjigje diametralisht të kundërta pretendimeve të ngritura (*shih vendimin nr. 62, datë 23.9.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Duke iu referuar dyshimit për realizimin efektiv të së drejtës së aksesit në gjykatë nga ana e kërkuarit, Gjykata thekson se është detyrë e Gjykatës së Lartë të bëjë të mundur realizimin efektiv të së drejtës së aksesit, pa lënë shkas për ekuivoke në lidhje me marrjen



në shqyrtim dhe vlerësimin nga ana e saj të pretendimeve të ngritura në rekurs.

23. Bazuar në sa më sipër, Gjykata vlerëson se duke vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur, pa u dhënë përgjigje përfundimtare pretendimeve të ngritura nga kërkuesi, Gjykata e Lartë ka cenuar të drejtën e aksesit në kuptimin substancial, si element i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, si dhe të neneve 72, 77 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2015-623, datë 9.3.2015 të Kolegjit Civil i Gjykatës së Lartë.

- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Vitore Tusha, Fatmir Hoxha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

Anëtarë kundër: Altina Xhoxhaj

MENDIM PAKICE

1. Në çështjen me kërkuese shoqërinë “Albsig” sh.a. jam kundër vendimit të shumicës për shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, për arsyet si vijojnë.

2. Kërkuesja ka pretenduar para Gjykatës se i është cenuar e drejta e aksesit në gjykim, pasi Gjykata e Apelit Shkodër e ka zhvilluar gjykimin në mungesë të saj, si palë e paditur. Po ashtu, sipas saj, kjo gjykatë nuk ka zbardhur në kohë vendimin dhe nuk i ka komunikuar vendimin e plotë të arsyetuar kërkueses.

3. Gjykata në jurisprudencën e saj konstante ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave. Konkretisht, e drejta për t’u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshëm të individit. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjake në raport me palën kundërshtare. E drejta për t’u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës, në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 34, datë 25.7.2011; nr. 18, datë 23.4.2013; nr. 51, datë 21.11.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

4. Për sa i përket së drejtës së aksesit, ajo u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t’i drejtohen një gjykate, e cila do t’i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë, për t’i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Në këtë kuptim, ky standard përfshin të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën, për çështjet civile përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit në një organ gjyqësor duhet të jetë një e drejtë që lidhet me themelin dhe jo një e drejtë e pastër formale. Aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Mohimi i së drejtës për t’iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 7, datë 27.2.2013, nr. 14, datë 26.3.2012; nr. 4, datë 23.2.2011; nr. 14, datë 3.6.2009; nr. 7 datë 11.3.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).



5. Nga aktet e dosjes gjyqësore rezulton se me shpalljen e datës 14.2.2014, administrata e Gjykatës së Apelit Shkodër ka bërë njoftimin për seancën gjyqësore të datës 13.3.2014. Në këtë seancë kërkesja nuk është paraqitur dhe gjykata ka marrë vendim për zhvillimin e gjykimit në mungesë të saj, pasi rezultonte se ka pasur dijeni dhe pa shkaqe të arsyeshme nuk është paraqitur në gjykim (procesverbali i datës 13.3.2014). Seanca e radhës për shpalljen e vendimit është caktuar nga gjykata në datën 18.3.2014, në të cilën sërish kërkesja nuk ka qenë e pranishme.

6. Gjkata ka vlerësuar se personi që ushtron ankim/rekurs është i interesuar të ndjekë fatin e ankimit të tij, megjithatë kjo nuk nënkupton se i takon vetëm atij përgjegjësia të ndjekë pafundësisht fatin e dosjes gjyqësore, e cila administrohet nga gjykata dhe jo nga kërkuesi. Është detyrë e administratës gjyqësore të njoftojë ankuesin/rekursuesin kur dokumentacioni që shoqëron ankimin/rekursin është i paplotë. E drejta e ankimit, ashtu si edhe ajo e aksesit në gjykatë nuk mund t'i cenohen kërkuetit për shkaqe që rrjedhin nga mangësitë ose gabimet në veprimtaritë e vetë organeve shtetërore (shih vendimin nr. 32, datë 22.7.2011 të Gjykatës Kushtetuese).

7. Në lidhje me njoftimin për datën e seancës së parë gjyqësore, në dosjen gjyqësore është administruar shpallja e bërë nga Gjykata e Apelit Shkodër. Neni 460 i KPC-së parashikon se njoftimi për ditën dhe orën e gjykimit bëhet nga gjykata e apelit me shpallje pranë saj dhe në gjykatat përkatëse të shkallës së parë. Megjithatë nga dosja gjyqësore nuk rezulton nëse kjo shpallje është bërë edhe pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Për këtë arsye, me shkresën e datës 30.6.2015, iu kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë që, për nevoja të gjykimit kushtetues, të vërë në dispozicion të Gjykatës kopje të listës së çështjeve për gjykim në Gjykatën e Apelit Shkodër të datës 13.4.2014. Me shkresën nr. 605 prot., datë 16.7.2015, kancelari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë ka dërguar informacion për çështjet në gjykim në Gjykatën e Apelit Shkodër, nga ku rezulton se çështja me palë shoqërinë “Albsig” sh.a. dhe Pashko Currin, me relator M.H., e shpallur për gjykim në datën 23.4.2014, i referohet një kërkesë me objekt: pezullimin e ekzekutimit të vendimit. Për pasojë,

kësaj gjykate i është kërkuar sërish informacion në lidhje me gjykimet e muajit mars 2014, konkretisht të datës 13.3.2014. Me shkresën nr. 840 prot., datë 20.10.2015, kancelarja e kësaj gjykate është përgjigjur se në adresën e saj elektronike disponon vetëm listat e gjykimeve që fillojnë nga muaji prill 2014 dhe se lista e gjykimeve për muajin mars mund të gjendet në adresën elektronike të ish-kancelarit të asaj gjykate. Pavarësisht kësaj përgjigjeje, vetë subjekti i interesuar ka paraqitur para Gjykatës disa akte që kanë të bëjnë me shpalljen e listës së gjykimeve përkatëse në Gjykatën e Apelit Shkodër, ku figuron e shpallur edhe çështja në fjalë, provë e cila, çuditërisht, nuk u pranua nga shumica.

8. Në vendimin nr. 51, datë 21.11.2013, me kërkesë Mirela Sinanin, Gjykata është shprehur: *“Në rastin konkret, Gjykata konstaton se nga materialet e administruara në dosjen gjyqësore, gjykimi i çështjes në Gjykatën e Apelit Tiranë është zhvilluar pa praninë e palëve. Procesverbali i datës 15.4.2008 mban shënimin “gjykata vendosi gjykimin në mungesë, palët ka(në) dijeni me shpallje sipas ligjit”. Në përfundim të procesit, Gjykata e Apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Po ashtu, gjatë gjykimit kushtetues të çështjes, është administruar shkresa nr. 1539 prot., datë 20.6.2013, e kancelares së Gjykatës së Apelit Tiranë, bashkëngjitur së cilës gjendet një kopje e listës së gjykimeve, ku rezulton të jetë edhe emri i kërkuettes (nr. rendor 15). Kurse nga shkresa nr. 7492, datë 12.6.2013 e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë rezulton se: “...listat e gjyqeve të ardhura nga Gjykata e Apelit Tiranë, për gjykimet e asaj gjykate, afishohen në stendat e shpalljeve në hollin e katit të parë, ku qëndrojnë deri në datën e gjykimit. Pas kësaj date listat asgjësohen”. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata, bazuar në faktin se njoftimi i kërkesës për ditën dhe orën e gjykimit të çështjes është bërë nga Gjykata e Apelit Tiranë me shpallje pranë saj, duke i afishuar në datën 1.4.2008 listat e çështjeve për gjykim në datën 15.4.2008, po ashtu, në mungesë të ndonjë prove të kundërt të paraqitur nga kërkuetsja për të justifikuar pamundësinë objektive dhe të arsyeshme për të mos kontrolluar listat e shpallura, vlerëson se pretendimi i kërkuettes për mosrespektimin e procedurave të njoftimit nga Gjykata e Apelit Tiranë, është i pabazuar.” (shih paragrafët 10-12 të vendimit).*

9. Bazuar në jurisprndencën e saj, Gjykata edhe në rastin konkret duhej të kishte vendosur



rrëzimin e kërkesës, për sa kohë që është arritur të provohet nga palët në gjykim se gjykatat kanë respektuar rregullat procedurale për njoftimin dhe se mungesa në gjykim është pasojë e veprimeve të vetë kërkuësës, dhe jo i atyre të administratës gjyqësore. Në mungesë të ndonjë prove të paraqitur nga kërkuësja, lidhur me pamundësinë objektive dhe të arsyeshme për të mos kontrolluar listat e shpallura në gjykatën e shkallës së parë, pretendimi i saj për mosmarrijen dijeni për procesin është i pabazuar. Bazuar në vetë argumentet e kërkuësës nuk rezulton që ajo të mos jetë vënë në dijeni për vendimin, të mos ketë pasur mundësinë që të njihet me arsyetimin e plotë të vendimit të Apelit, apo të mos ketë pasur kohën e nevojshme për të paraqitur edhe rekurs shtesë në Gjykatën e Lartë, nëse do e vlerësonte të nevojshme. Për më tepër, nga rekursi i administruar në dosjen gjyqësore, rezulton se kërkuësja ka paraqitur argumentet e saj të plota në kundërshtim të vendimeve të gjykatave të faktit. Po ashtu, rezulton se me kërkesën e datës 7.8.2014 kërkuësja ka paraqitur edhe kërkesë për pezullim në Gjykatën e Lartë, e cila është pranuar me vendimin e Kolegjit Civil të datës 12.8.2014. Fakti nëse personi ka ose jo dijeni për procesin/vendimin mund të provohet me çdo lloj mjeti të lejuar nga ligji procedural dhe në këtë kuptim edhe paraqitja e plotë e rekursit, si dhe paraqitja e kërkesës për pezullim në Gjykatën e Lartë provon se kërkuësja është njohur në kohë me vendimin e Gjykatës së Apelit dhe se ka pasur të gjitha mundësitë dhe kohën e mjaftueshme për të paraqitur argumentet e saj në kundërshtim të këtij vendimi.

10. Për sa i takon qëndrimin të shumicës së Gjykata e Lartë duhej t'u kishte dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura në rekurs në lidhje me mungesën e njoftimit të kërkuësës, vlerësoj gjithashtu, se është i pabazuar.

11. Gjykata, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, ka tashmë një qëndrim të konsoliduar, sipas të cilit kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Një linjë e tillë lidhur me raportin ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese

të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit) (*sibih vendimet nr. 4, datë 28.2.2006; nr. 19, datë 2.4.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Gjykata duhet të investohet vetëm nëse konstaton shkelje të parimeve të procesit të rregullt ligjor dhe nëse këto shkelje nuk janë konstatuar dhe riparuar nga Gjykata e Lartë. Në këtë kuptim, vetëm fakti i mosdhënies përgjigje pretendimeve të paraqitura në rekurs, nuk është i mjaftueshëm për shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë. Në rast se Gjykata do të arrinte në përfundimin se ka pasur shkelje në procesin gjyqësor të zhvilluar në gjykatat e faktit, pra se kërkuësja nuk ka marrë dijeni për procesin gjyqësor në Gjykatën e Apelit, ajo mund të vendoste shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë dhe ta kthente çështjen për rishqyrtim për riparimin e shkeljeve të konstatuara gjatë procesit.

13. Për të gjitha argumentet e mësipërme vlerësoj se kërkesa duhej të rrëzohej si haptazi e pabazuar.

Anëtare: Altina Xhoxhaj

VENDIM

Nr. 4, datë 23.2.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 27.10.2015 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 58/16 Akti, që u përket palëve:

KËRKUESE: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Ministria e Drejtësisë,



Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Safet Sulaj

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i nenit 169 të Kodit Civil në pjesën që nuk njeh të drejtën subjektive të ish-pronarit që të kompensohet për humbjen e pasurisë me ekuivalencën e vlerës së saj.

BAZA LIGJORE: Nenet 134/d dhe 145/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet 125, 297 dhe 298 të Kodit të Procedurës Civile.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Besnik Imeraj, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të gjykatës referuese, që është shprehur për pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Ministrisë së Drejtësisë, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë (*gjykata referuese*) është vënë në lëvizje për gjykimin e çështjes civile me paditës shtetasin Safet Sulaj (subjekt i interesuar), të paditur Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe me objekt detyrimin për njohjen e paditësit pronar me parashkrim fitues mbi një pronë truall dhe shtëpi të ndodhur në Vlorë, zona kadastrale 8601 me nr. 16/90 pasurie. Paditësi ka pretenduar se e ka poseduar pasurinë objekt gjykimi për më shumë se njëzet vjet, pa ndërprerje, në mënyrë publike, sikur të ishte pronar dhe qetësisht, si dhe se pasuria objekt gjykimi nuk është e përfshirë në rrethin e pasurive të paluajtshme të patjetërsueshme si pronë publike.

2. Në seancën përgatitore të datës 17.3.2015, Avokatura e Shtetit në mënyrë alternative ka kërkuar nga gjykata që nëse e gjen kërkesëpadinë të bazuar në ligj dhe në prova, me vendim përfundimtar të akordojë një shumë të caktuar kompensimi si pasojë e humbjes së pronësisë mbi sendin. Ky kërkim është kundërshtuar nga paditësi, pasi ai nuk parashikohet nga nenet 169 dhe 170 të Kodit Civil, si edhe në rastin konkret

gjykata ndodhet përpara fitimit të pronësisë me parashkrim fitues.

3. Gjykata referuese, duke vlerësuar se neni 169 i KC-së, në pjesën që nuk parashikon të drejtën për kompensim të ish-pronarit, vjen në kundërshtim me Kushtetutën dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*), me vendimin nr. 1097 akti, datë 9.2.2015, ka vendosur pezullimin e gjykimit të kësaj çështjeje dhe në bazë të nenit 145/2 të Kushtetutës i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë për kontrollin e kushtetutshmërisë së përmbajtjes së kësaj dispozite.

II

4. **Gjykata referuese** ka parashtruar këto argumente përpara Gjykatës për të mbështetur qëndrimin e saj për jokushtetutshmërinë e nenit 169 të Kodit Civil, në pjesën që nuk njeh të drejtën subjektive të ish-pronarit që të kompensohet për humbjen e pasurisë me ekuivalencën e vlerës së saj:

4.1 Në nenin 18 të Kushtetutës është sanksionuar parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit. Çmohet se prona e ish-pronarit dhe ajo e pronarit të bërë rishtazi nëpërmjet parashkrimit fitues nuk mbrohen në mënyrë të barabartë kur bëhet fjalë për formulën e zgjidhjes ligjore të nenit 169 të KC-së. Zgjidhja ligjore e shumëzimit me zero të pasurisë së ish-pronarit dhe begatimi me gjithçka i pronarit të ri krijon pabarazi në të drejtën e pronës. Nëse pasuria e humbur në mënyrë të pavullnetshme për shkak të ligjit do të ekuivalentohej në një vlerë kompensuese nga pronari i ri, do të arrihej mbrojtja kushtetuese dhe ligjore e barabartë dhe proporcionale e secilit prej këtyre subjekteve.

4.2. Përmbajtja e kundërshtuar e nenit 169 të KC-së bie ndesh me nenin 17 të Kushtetutës. Edhe pse kufizimi i së drejtës së pronësisë në këto raste bëhet nga ligji, konkretisht neni 169 i KC-së, nuk arrihet të identifikohet asnjë argument i interesit publik që përligjë nihilizmin e çdo të drejte pasurore të ish-pronarit, qoftë edhe të drejtën subjektive për t'u kompensuar për ekuivalencën e vlerës së të drejtës së humbur për shkak të ligjit.

4.3. Neni 169 i KC-së, që parashikon humbjen e pronësisë për shkak të ligjit, por nuk parashikon mjetin ligjor korrigjues, konkretisht të



drejtën e ish-pronarit për t'u kompensuar, vjen në kundërshtim me kushtëzimin kushtetues të nenit 17, pasi e drejta e pronës e një subjekti nihilizohet në thelbin e saj. Po ashtu, mospërdorimi i asnjë mjeti korrigjues nga ligji implikon shkeljen edhe të një dimensionit tjetër të Kushtetutës, konkretisht moscenimin në thelb të së drejtës për pronë.

4.4. Përmbajtja e nenit 169 të KC-së bie ndesh me nenin 41 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Parashkrimi fitues si mënyrë origjinale e fitimit të pronësisë përbën një kufizim të së drejtës së pronës ekuivalent me shpronësimin, për më tepër ky shpronësim faktik realizohet nga ligji për llogari të një subjekti tjetër. Nëpërmjet kësaj mënyre fitimi pronësie ligji me plotësimin e disa kushteve shpronëson një subjekt të caktuar dhe pronëson një subjekt tjetër. Ky konkluzion bën që të mos vlerësohet apo identifikohet asnjë argument që të privojë ish-pronarin për të drejtën e kompensimit në vlerën ekuivalente të së drejtës së humbur. Kjo mënyrë kufizimi merr më tepër rëndësi në rastin e parashkrimit fitues, ku nuk identifikohet dot asnjë arsye sociale, ekonomike, politike e humane për të konkluduar se prona duhet të hiqet pa asnjë kundërshtim.

5. **Subjekti i interesuar, Ministria e Drejtësisë**, në parashtrimet me shkrim drejtuar Gjykatës ka prapësuar sa vijon:

5.1. Gjykata referuese nuk legjitimohet për të kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së përmbajtjes së nenit 169 të KC-së. Ajo nuk ka parashtruar mjaftueshëm arsye serioze për antikushtetutshmërinë e kësaj dispozite, pasi gjatë gjithë argumenteve të paraqitura pranon se dispozita ashtu siç është parashikuar e kalon testin e kushtetutshmërisë dhe është në përputhje me standardet e GJEDNJ-së.

5.2. Pretendimi i kërkuarit për trajtim të diferencuar në mbrojtjen e së drejtës së pronës është i pabazuar. Dhe vetë gjykata referuese pranon se këto subjekte nuk janë në kushte të njëjta. Në mënyrë të arsyeshme ligji ka favorizuar subjektin diligjent që të bëhet pronar rishtazi dhe me titull origjinal mbi sendin, ndërkohë që ka anuluar dhe shuar titullin e pronësisë pronarit që fle mbi të drejtat e tij, duke e ndëshkuar atë civilisht për pasivitetin e pajustificuar në qarkullimin civil.

5.3. Pretendimi për cenimin e nenit 17 të Kushtetutës është i pabazuar. Parashkrimi fitues si mënyrë origjinale e fitimit të pronësisë u shërben interesave publike të shtetit dhe shoqërisë. Mënyra origjinale e fitimit të pronësisë me parashkrim fitues dhe rregullimi i saj diktohet nga nevoja e sigurisë juridike në qarkullimin civil dhe nevoja për të begatuar qarkullimin civil me vlerën e shtuar të pronës në veçanti dhe pasurisë në përgjithësi. Gjithashtu, kufizimi i së drejtës së pronësisë në rastin konkret është bërë nga ligji, konkretisht nga neni 169 i Kodit Civil.

5.4. E drejta e pronës, megjithëse është e mbrojtur nga neni 41 i Kushtetutës, nuk është e drejtë absolute. Neni 17 i Kushtetutës parashikon mundësinë e kufizimit të të drejtave për një interes publik dhe për arritjen e një qëllimi që justifikon kufizimin e së drejtës. Neni 41 i Kushtetutës parashikon kritere për shpronësimin apo kufizimin me ligj në ushtrimin e kësaj të drejte, ndërkohë që në nenin 169 të KC-së nuk kemi të bëjmë me shpronësim të mirëfilltë dhe formal.

5.5. Në çështjen J.A.Pye Ltd. kundër Mbretërisë së Bashkuar GJEDNJ-ja ka shqyrtuar pajtueshmërinë e legjislacionit për parashkrimin me dispozitat e KEDNJ-së (vendim i Dhomës së Madhe), e cila vlerësoi se nuk kishte cenim të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

6. Subjektet e tjera të interesuara nuk kanë paraqitur pretendime.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e gjykatës referuese

7. Përpara se të shprehet në lidhje me thelbin e pretendimeve, Gjykata do të ndalet në vlerësimin e legjitimitimit të gjykatës referuese, i vënë në dyshim nga subjekti i interesuar Ministria e Drejtësisë. Sipas këtij subjekti gjykata referuese nuk ka parashtruar mjaftueshëm arsye serioze për antikushtetutshmërinë e kësaj dispozite dhe se në argumentet e paraqitura ajo pranon se përmbajtja e parashkimit ligjor të kundërshtuar kalon testin e kushtetutshmërisë dhe është në përputhje me standardet e GJEDNJ-së.

8. Siç është shprehur në mënyrë të vazhdueshme Gjykata në jurisprudencën e saj, kërkesa për kontroll incidental, që përbën mjetin e aksesit të gjykatës së juridiksionit të zakonshëm



në gjykimin kushtetues, rregullohet nga neni 145/2 i Kushtetutës, sipas të cilit kur gjyqtari çmon se ligji (ose dispozita të tij) bie në kundërshtim me Kushtetutën, nuk e zbaton atë, por pezullon gjykimin dhe ia dërgon çështjen Gjykatës Kushtetuese për t'u shprehur në lidhje me kushtetutshmërinë e normës. Përmbajtja e dispozitës kushtetuese është konkretizuar në nenin 68 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i cili përcakton edhe disa kushte, të cilat duhet të respektohen nga gjykata referuese për të iniciuar gjykimin incidental: *së pari*, gjatë një procesi gjyqësor ajo duhet të përcaktojë/identifikojë ligjin që zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete (lidhjen e drejtpërdrejtë); *së dyti*, duhet të parashtrijë arsye serioze për jokushtetutshmërinë e ligjit ose dispozitave të tij, duke referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës.

9. Përpara marrjes së vendimit të pezullimit të çështjes, gjykata referuese duhet të konkludojë se gjykimi që ka nisur nuk mund të përfundojë pa iu dhënë përgjigje çështjes së kushtetutshmërisë së ligjit nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Në këtë kuptim, kërkohet një raport i domosdoshëm midis vendimit të Gjykatës (zgjidhjes së çështjes së kushtetutshmërisë) dhe zgjidhjes së çështjes konkrete nga gjykata referuese. Po ashtu, gjykata referuese, në zbatim të parimit të kushtetutshmërisë, përpara se t'i drejtohet Gjykatës duhet të bëjë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar ligjin e zbatueshëm në përputhje me Kushtetutën (*shih vendimin nr. 55, datë 21.7.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Është detyrim i gjykatës referuese të zgjidhë dyshimet interpretative, duke i dhënë normës së zbatueshme një interpretim që përputhet me parimet kushtetuese. Në këto kushte, gjyqtari referues është i detyruar të zbatojë, midis interpretimeve të ndryshme të mundshme, atë që konsiderohet se përputhet me parimin kushtetues, që në të kundërt do të cenohej. Vetëm në rast se gjyqtari vlerëson se të gjitha interpretimet e mundshme bien në kundërshtim me Kushtetutën, atëherë ai duhet t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese duke kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së normës të individualizuar si e zbatueshme në rastin konkret

(*shih vendimin nr. 7, datë 16.2.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Duke e vlerësuar legjitimitimin e gjykatës referuese në këndvështrim të kriterëve si më sipër, Gjykata vëren se në rastin konkret gjykata referuese është vënë në lëvizje me kërkesëpadi të subjektit të interesuar Safet Sulaj kundër Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, me objekt të saj njohjen e paditësit pronar mbi një pronë truall dhe shtëpi mbi të me anë të parashkrimit fitues, në bazë të nenit 169 të KC-së. Në këto kushte, dispozita e kundërshtuar është ligji i zbatueshëm në rastin konkret.

B. Lidhur me pretendimet për cenimin e neneve 11,17,18 etj. të Kushtetutës

11. Në lidhje me argumentet që mbështesin pretendimet për cenimin e normave e parimeve konkrete kushtetuese, gjykata referuese argumenton se përmbajtja e nenit 169 të KC-së, në pjesën që nuk parashikon të drejtën për kompensim të ish-pronarit, bie ndesh me nenet 11, 17, 18 dhe 41 të Kushtetutës, si edhe me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

12. Sipas nenit 41 të Kushtetutës: "Prona fitohet me dhurim, me trashëgimi, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në Kodin Civil." Në legjislacionin tonë, sa më sipër, rregullohet përmes nenit 149 të KC-së, i cili parashikon se: "Pronësia është e drejta për të *gëzuar* dhe *disponuar* lirisht sendet, brenda kufijve të caktuar nga ligji", ndërsa në nenet 164-190 të këtij Kodi parashikohen mënyrat përkatëse të fitimit dhe të humbjes së pronësisë. Sipas nenit 169 të KC-së "*Personi që ka poseduar qetësisht e pa ndërprerje, duke u sjellë sikur të ishte pronar për njëzetë vjet në një pronë të paluajtshme, bëhet pronar i saj*". Parashkrimi fitues (me titull ose pa titull) është një nga mënyrat e fitimit të pronësisë, parashikuar në nenet 168 dhe 169 të KC-së. Në thelb, elementi i përbashkët i parashkrimit fitues me titull dhe atij pa titull është posedimi i qetë dhe pa ndërprerje i sendit. Për parashkrimin fitues me titull (sikurse parashikohet nga neni 168 i KC-së), përveç posedimit të pandërprerë prej 10 vjetësh të sendit të paluajtshëm, kërkohet që të ekzistojë veprimi juridik për kalimin e pronësisë, veprim i cili nuk është i ndaluar nga ligji, si dhe ekzistenca e mirëbesimit (vetëm për kohën e bërjes së veprimit juridik për fitimin e pronësisë), pra që fituesi i sendit nuk ka ditur ose



nuk ka qenë i detyruar të dinte që personi nga i cili ka fituar sendin nuk ishte pronar ose që veprimi juridik për kalimin e pronësisë nuk ishte i vlefshëm. Parashkrimi fitues me titull mbulon çdo lloj pavlefshmërie, si atë relative, ashtu edhe atë absolute, sepse kjo është një mënyrë fitimi pronësie me anë të posedimit dhe një mënyrë primare e fitimit të pronësisë. Ndërsa fitimi i pronësisë me parashkrim fitues pa titull, institut i parashikuar nga neni 169 i KC-së, ka si element thelbësor dhe të vetëm ekzistencën e posedimit qetësisht dhe pa ndërprerje të sendit të paluajtshëm për 20 vjet. Natyrisht që sjellja gjatë këtij posedimi duhet të jetë njësoj sikur poseduesi të ishte pronar i sendit. Nëse janë plotësuar kushtet e përcaktuara në këto dispozita, pronari i mëparshëm i sendit humbet të drejtën e tij të pronësisë mbi sendin, pasi parashkrimi fitues në kushtet e përcaktuara në ligj mund të sjellë lindjen ose fitimin e së drejtës së pronësisë.

13. Sipas gjykatës referuese, papajtueshmëria e kësaj dispozite (nenit 169 të KC-së) qëndron në mungesën e parashikimit prej saj të mundësisë së kompensimit të ish-pronarit, i cili humb pronësinë si pasojë e ndërhyrjes së institutit të parashkrimit fitues, por ajo nuk ka ngritur pretendime në lidhje me përmbajtjen e kësaj dispozite, pra në lidhje me këtë institut në vetvete. Për pasojë, Gjykata vlerëson se nuk mund të ndalet në kontrollin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të institutit të parashkrimit fitues, si një nga mënyrat origjinale të fitimit të pronësisë. Gjykata rithekson se në vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjeve, ajo nisat nga prezumimi i pajtueshmërisë së tyre me Kushtetutën. Kjo do të thotë se lidhur me antikushtetutshmërinë e pretenduar duhet të parashtrihen argumente bindëse për t'i dhënë mundësi kësaj Gjykate të vlerësojë nëse zgjidhjet ligjore të zbatuara shkelin normat dhe vlerat kushtetuese (*shih vendimin nr. 5, datë 5.2.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Gjykata vlerëson, gjithashtu, se e drejta e pronësisë, si një nga të drejtat e mbrojtura nga Kushtetuta, nuk cenohet si pasojë e mosparashikimit të së drejtës së kompensimit të ish-pronarit në rast të transferimit të titullit të pronësisë, si pasojë e zbatimit të nenit 169 të KC-së. Titullari i së drejtës së pronësisë është i mbrojtur në çdo rast kur pretendon cenimin apo

kufizimin e kësaj të drejte. Neni 169 i KC-së kërkon posedimin e pronës nga poseduesi jopronar qetësisht e pa ndërprerje dhe duke u sjellë si të ishte i tillë, ndërkohë që çdo veprim i kryer nga pronari i ligjshëm gëzon mbrojtje ligjore dhe sjell efektin e ndërprerjes së efektit të parashkrimit dhe moszbatimit e këtij instituti. Sipas GJEDNJ-së, pretendimi për kompensim në raste të tilla duhet trajtuar në këndvështrim të parimit të sigurisë juridike. Sipas saj, shuarja e së drejtës së pronësisë, kur pronari nuk ka mundur të rimarrë tokën e tij si pasojë e zbatimit të ligjit, nuk mund të thuhet se është haptazi pa baza të arsyeshme. Për këtë arsye ka pasur një interes të përgjithshëm për afatet dhe shuarjen e titullit të pronësisë në përfundim të afatit. Kërkesa për kompensim në rastin kur njëra palë nuk ka arritur të ndërpresë afatin e parashkrimit, bie në kundërshtim me konceptin e “afatit”, qëllimi i të cilit është vazhdimësia e sigurisë ligjore që pala tjetër nuk do të paditet pas kalimit të një date të caktuar (*shih vendimin datë 30 gusht 2007 në çështjen J.A. Pye (Oxford) ltd dhe J.A. Pye (Oxford) Land ltd kundër Mbretërisë së Bashkuar*).

15. Parimi i sigurisë juridike përfshin, krahas qartësisë, kuptueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit normativ, edhe besimin te sistemi juridik, pa marrë përsipër garantimin e çdo pritshmërie për mosndryshim të një situate të favorshme ligjore. Besueshmëria ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të cenojnë jetën e tij private ose profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme (*shih vendimin nr. 20, datë 15.4.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas subjektit të interesuar, parashkrimi fitues si mënyrë origjinale e fitimit të pronësisë u shërben interesave publikë të shtetit dhe shoqërisë. Mënyra origjinale e fitimit të pronësisë me parashkrim fitues dhe rregullimi i saj diktohen nga nevoja e sigurisë juridike në qarkullimin civil dhe nevoja për të begatuar qarkullimin civil me vlerën e shtuar të pronës në veçanti dhe pasurisë në përgjithësi.

16. Në ndryshim nga sa pretendon gjykata referuese shpërblimi i drejtë është një koncept kushtetues i lidhur me rastet e shpronësimit apo kufizimit të së drejtës së pronës me ligj për



interesa publikë, sipas nenit 41 të Kushtetutës. Për pasojë, humbja e pronësisë si pasojë e shpronësimit për interes publik nuk është e njëjtë me kalimin e titullit të pronësisë si pasojë e ndërhyrjes së parashkrimit fitues. Ndërsa në rastin e parë gjendemi përballë një marrëdhënieje midis individit pronar dhe shtetit, ku individi zhvishet nga e drejta e pronësisë sa herë që ndërhyr një interes publik dhe ka të drejtë të ketë pretendime vetëm në lidhje me masën e shpërblimit, në rastin e dytë gjendemi përballë një marrëdhënieje private mes pronarit dhe poseduesit jopronar, individë apo shteti, ku pronari ka të gjitha të drejtat ligjore dhe mundësitë që të pretendojë dhe mbrojë të drejtën e tij.

17. Për sa më sipër, në vlerësim të Gjykatës, nuk është arritur të argumentohet mjaftueshëm në nivel kushtetues se mungesa e një parashikimi ligjor në nenin 169 të KC-së për njohjen e së drejtës së kompensimit për ish-pronarin në rastin e kalimit të titullit me anë të parashkrimit fitues bie ndesh me parimet dhe standardet kushtetuese të pretenduara nga gjykata referuese. Në kushtet kur gjykata referuese nuk ka arritur të paraqesë argumente bindëse për të mbështetur kërkesën e saj, kjo kërkesë është e pabazuar dhe duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja “a”, 134, pika 1, shkronja “d” dhe 145, pika 2 të Kushtetutës, si dhe të neneve 68, 69, 70, 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Besnik Imeraj, Fatos Lulo

MENDIM PARALEL

1. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) ka vendosur rrëzimin e kërkesës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë (gjykata referuese) lidhur me papajtueshmërinë me Kushtetutën të nenit 169 të Kodit Civil (KC) në pjesën që nuk njeh të drejtën subjektive të ish-pronarit që të kompensohet për humbjen e pasurisë me ekuivalencën e saj, me arsyetimin se “*nuk është arritur të argumentohet mjaftueshëm në nivel kushtetues se mungesa e një parashikimi ligjor në nenin 169 të KC-së për njohjen e së drejtës së kompensimit për ish-pronarin në rastin e kalimit të titullit me anë të parashkrimit fitues bie ndesh me parimet dhe standardet kushtetuese të pretenduara nga gjykata referuese*” (shih paragrafin nr. 17 të vendimit të shumicës).

2. Pajtohem me vendimin e shumicës për rrëzimin e kërkesës, por ndaj mendim të ndryshëm nga ajo (shumica) në lidhje me themelin e pretendimeve.

3. Shumica në vendimin e saj pasi ka arsyetuar se gjykata referuese plotëson kriteret e legjitimitetit në kuptim të nenit 145/2 të Kushtetutës, për sa i përket themelit të pretendimeve argumenton mbi *ratio-n* e institutit të parashkrimit fitues, të parashikuar nga nenet 168 dhe 169 të KC-së (shih paragrafin nr. 12 të vendimit të shumicës), si dhe mbi të drejtën e kompensimit të ish-pronarit në rastin e transferimit të titullit të pronësisë (shih paragrafët nr. 14-15 të vendimit të shumicës). Bazuar në veçoritë e këtyre dy instituteve, shumica ka arritur në përfundimin, sikurse u përmend më lart, se kërkesa e gjykatës referuese *nuk është ngritur në nivel kushtetues*. Sipas shumicës, në kushtet kur gjykata referuese nuk ka arritur të paraqesë argumente bindëse për të mbështetur kërkesën e saj, *kjo kërkesë është e pabazuar* (shih paragrafin nr. 17 të vendimit të shumicës).

6. Jam i mendimit se vendimi i shumicës është kontradiktor dhe i paqartë. Përfundimi në të cilin ka arritur shumica lë vend për konfuzion nëse kërkesa e gjykatës referuese nuk është ngritur në nivel kushtetues apo është haptazi e pabazuar. Kjo paqartësi bëhet më e evidente edhe për faktin se pavarësisht se shumica ka vlerësuar se gjykata referuese *nuk ka arritur të argumentojë mjaftueshëm në nivel kushtetues*, ajo (shumica) ndalet në themelin e pretendimeve.



7. Në ndryshim nga shumica, në rastin në shqyrtim mendoj se kërkesa e gjykatës referuese është haptazi e pabazuar. Sikurse vlerëson edhe shumica instituti i parashkrimit fitues dhe ai i dëmshpërblimit janë dy institute diametralisht të kundërta me njëra-tjetrën. Nisur nga kjo pikëpamje, në vlerësimin tim nuk ka ometim legjislativ në formulimin e nenit 169 të KC-së dhe për pasojë do të ishte e tepërt dhe e panevojshme çdo lloj ndërhyrje në këtë drejtim në nenin në fjalë.

Anëtar: Vladimir Kristo

VENDIM NR. 5, datë 23.2.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 13.10.2015 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 53/12 Akti, që i përket:

Kërkues: Enver Rrapaj

SUBJEKT I INTERESUAR: Ferdinand Dollani

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosarsyetimit brenda një afati të arsyeshëm të vendimit nr. 1761, datë 9.9.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

BAZA LIGJORE: Nenet 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si edhe ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fatmir Hoxha, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkesit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Në datën 11.10.2010 kërkesi ka paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan kërkesëpadinë me objekt lirimin dhe dorëzimin e pasurisë së paluajtshme në pronësinë e tij, si dhe shpërblimin për përdorimin dhe dëmtimin e pasurisë.

2. Me vendimin nr. 1761, datë 9.9.2011, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka vendosur: *“Pranimin e kërkesëpadisë. Detyrimin e të paditurit Ferdinand Dollani që t’i lirojë dhe dorëzojë paditësit Enver Rrapaj një ndërtesë dykatëshe, ku kati i parë ka një sipërfaqe prej 472.5 m² dhe kati i dytë ka një sipërfaqe prej 485 m², të ndodhur në lagjen “28 Nëntori” të qytetit Elbasan, duke u përcaktuar vendndodhja me kufizimet e ndërtesës sipas hartës treguese të regjistrimit, që është bashkëngjitur certifikatës për vërtetim pronësie të lëshuar nga ZVRPP-ja Elbasan. Detyrimin e të paditurit Ferdinand Dollani që t’i paguajë paditësit Enver Rrapaj një shpërblim për përdorimin e ndërtesës dykatëshe në shumën prej 1.000.000 lekësh.”*

3. Në përfundim të gjykimit kërkesi është pajisur me shkurtimin e vendimit, i cili përmban dispozitivin e tij, por deri në paraqitjen e kërkesës në Gjykatën Kushtetuese nuk i është vënë ende në dispozicion vendimi i plotë dhe i arsyetuar i gjykatës.

II

4. **Kërkuesi Enver Rrapaj** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë sipas objektit, duke parashtruar në mënyrë të përmblëdhur:

4.1 Edhe pse kanë kaluar 4 vjet nga pranimi i kërkesëpadisë, vendimi nuk është zbardhur ende i arsyetuar, sepse gjyqtari i çështjes është shkarkuar nga detyra, ndërkohë që kërkesi disponon vetëm një shkurtim vendimi.

4.2 Kërkesi i është drejtuar kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë



(KLD), por nuk është kryer asnjë veprim për zgjidhjen e kësaj situate.

4.3 Kërkuesi nuk mund të ngrejë padi të re në gjykatë, pasi kjo çështje përbën gjë të gjykuar, dhe as nuk mund të padisë gjykatën për mosarsyetimin e vendimit.

5. **Subjekti i interesuar Ferdinand Dollani** nuk ka paraqitur prapësime me shkrim para Gjykatës lidhur me pretendimet e ngritura në kërkesë.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

6. Gjykata vëren se kërkuari legjitimohet *ratione personae*, pasi ai është një nga subjektet që mund të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues në bazë të nenit 134/1/g të Kushtetutës, si dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 2-vjeçar që ka parashikuar neni 30/2 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

7. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae* Gjykata ka pranuar se kërkesat e individëve për cenimin e së drejtës për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm mund të merren në shqyrtim, pavarësisht se gjykimi për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese dhe ligjore të tyre ende nuk ka përfunduar në të gjitha shkallët e gjykimit prej gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimin nr. 51, datë 20.7.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Në të tilla raste Gjykata shqyrton nëse ka pasur mjete, të cilat kërkuari duhej t'i shfrytëzonte në plotësim të kushtit të shterimit të mjeteve. Në këtë drejtim, në kuptim të nenit 13 të KEDNJ-së, mjetet në dispozicion të një ndërgjyqësi për të parashtruar një ankesë për zgjatjen e procesit janë “efektive” në qoftë se ato “parandalojnë shkeljen e pretenduar, pengojnë vazhdimin e saj ose ofrojnë një riparim të përshtatshëm për çdo shkelje që tashmë ka ndodhur” (*shih vendimin nr. 56, datë 21.7.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Nga aktet e administruara konstatohet se kërkuari i është drejtuar me kërkesë si kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, Ministrisë së Drejtësisë dhe KLD-së për të gjetur zgjidhje për situatën e krijuar. Megjithatë asnjë nga këto mjete nuk kanë qenë efektive në kuptim të

standardeve të mësipërme të jurisprudencës së Gjykatës dhe GJEDNJ-së. Për këto arsye, Gjykata vlerëson se kërkuari legjitimohet t'i drejtohet asaj në lidhje me kërkimin objekt kërkesë, në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës.

B. Për pretendimin e mosarsyetimit të vendimit brenda një afati të arsyeshëm dhe cenimit të së drejtës së aksesit në gjykatë

9. Kërkuari pretendon se edhe pse kanë kaluar 4 vjet nga shpallja e vendimit, ai ende nuk ka një vendim gjyqësor të arsyetuar, i cili të jetë i ekzekutueshëm me qëllim rivendosjen e së drejtës së cenuar.

10. Në nenin 42/2 të Kushtetutës parashikohet se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Në rast se mohohet kjo e drejtë procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (*shih vendimin nr. 8, datë 26.2.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Gjykata në jurisprudencën e saj ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që



cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave (*shih vendimin nr. 27 datë 24.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, e drejta e aksesit kërkon edhe pajisjen e palëve në proces me një vendim gjyqësor të arsyetuar, në të cilin gjykata tregon me qartësi faktet, ligjin e zbatueshëm dhe arsyet që e kanë shtyrë për të bërë zgjedhjen ndërmjet disa mundësive. Në jurisprudencën kushtetuese e drejta për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar është konsideruar pjesë përbërëse dhe e pandarë e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të neneve 42, 142/1 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Arsyetimi i vendimeve gjyqësore është një element thelbësor i një vendimi të drejtë dhe funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, duke iu dhënë njëkohësisht mundësinë për ta kundërshtuar atë. Duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimin nr. 18, datë 31.3.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Gjykata, bazuar në informacionin dërguar asaj me shkresat nr. 1037 prot., datë 26.10.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe nr. 3308/1 prot., datë 23.10.2015 të KLD-së, vëren se me vendimin nr. 306, datë 8.3.2013 të KLD-së është marrë masa disiplinore “Shkarkim nga detyra” ndaj gjyqtarit Xh.K. Si pasojë kanë ngelur një sërë vendimesh tërësisht të paarsyetura, që u përkasin subjekteve të ndryshme, mes të cilave edhe kërkuesi. Për këtë qëllim, vetë gjykata e shkallës së parë i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë dhe KLD-së për të dhënë sugjerime dhe për të ndihmuar për zgjidhjen e situatës. Me shkresën nr. 1106 prot., datë 24.5.2013 të zëvendëskryetarit të KLD-së i është kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan të zbatojë legjislacionin në fuqi, duke garantuar të drejtën e qytetarëve për një proces të rregullt ligjor nëpërmjet dërgimit të akteve të dosjeve përkatëse për shqyrtim në gjykatën e apelit apo Gjykatën e Lartë, me qëllim që këto gjykata të vlerësojnë nëse aktet procedurale, përfshirë edhe vendimin gjyqësor, janë në përputhje me ligjin, duke urdhëruar edhe riparimin e të metave që konstatohen. Ky qëndrim është përsëritur edhe me shkresat nr. 1421/1 prot., datë 22.7.2015 dhe nr. 1994/1 prot., datë 1.9.2015 të KLD-së, në

vijim të komunikimeve mes këtij organi dhe vetë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Po ashtu, sipas KLD-së, në kushtet kur gjyqtari është i shkarkuar nga detyra, ai nuk është më subjekt i kontrollit të këtij organi.

13. Si pasojë e udhëzimeve të dhëna nga KLD-ja, rezulton se disa nga çështjet e përfunduara, por të pazbardhura, për të cilat është paraqitur ankim, janë dërguar në gjykata më të larta, ndërsa çështja e kërkuesit, meqenëse nuk është ankimuar, nuk është shqyrtuar nga një gjykatë më e lartë. Edhe pse kërkuesi, në përputhje me të drejtat e tij procedurale, u është drejtuar institucioneve përgjegjëse për kërkim informacioni dhe për marrjen e një vendimi në lidhje me dosjen e tij gjyqësore (kërkesat e datave 7.4.2015, 23.4.2015 dhe 8.6.2015), përfundimisht me shkresën nr. 570 prot., datë 3.6.2015 kancelari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan i është përgjigjur se ai mund t'i drejtohet me ankim Gjykatës së Apelit Durrës për mosarsyetimin e vendimit, sipas dispozitave procedurale.

14. Sipas nenit 308 të KPC-së vendimi duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues që kanë marrë pjesë në dhënien e tij, kurse në çështje të ndërlikuara gjykata mund të shpallë vetëm dispozitivin e vendimit, duke e dorëzuar atë të arsyetuar në sekretari jo më vonë se dhjetë ditë, ose të shtyjë shpalljen e arsyetuar të vendimit deri në pesë ditë. Sipas nenit 309 të KPC-së vendimi mbështetet vetëm në të dhënat që ndodhen në aktet dhe që janë shqyrtuar në seancë gjyqësore. Po sipas kësaj dispozite, gjykata i çmon provat e marra gjatë gjykimit të çështjes, sipas bindjes së saj të brendshme, të formuar nga shqyrtimi i të gjitha rrethanave të çështjes në tërësinë e tyre. Kurse në nenin 310 të KPC-së parashikohen elementet që duhet të përmbajë vendimi gjyqësor nga pikëpamja strukturore. Megjithatë, Gjykata vëren se dispozitat procedurale nuk përmbajnë asnjë parashikim për rregullimin e situatave të tilla si rasti konkret në shqyrtim.

15. Gjykata vëren se kërkuesi është pajisur pas përfundimit të gjykimit me një shkurtim të vendimit gjyqësor, i cili përmban vetëm dispozitivin e tij dhe deri në momentin e shqyrtimit të kësaj çështjeje, për shkak të shkarkimit nga detyra të gjyqtarit të çështjes, i cili



e ka shqyrtuar atë si gjyqtar i vetëm, nuk ka ende një vendim përfundimtar të formës së prerë, i cili të jetë i ekzekutueshëm, çka në thelb i ka cenuar atij të drejtën e aksesit.

16. Gjykata vëren se situata vazhdon të mbetet pa zgjidhje konkrete, si pasojë edhe e një boshllëku ligjor për rregullimin e situatave të tilla. E vetmja zgjidhje për kërkuesin është depozitimi i ankimit në një gjykatë më të lartë, me qëllim riparimin e të metave, çka bie ndesh me interesat e tij si pala gjyqfuese. Gjykata ka theksuar në jurisprudencën e saj se u takon organeve shtetërore që të gjejnë mjetin e përshtatshëm efektiv për të rivendosur të drejtat e cenuara të individëve, në rast se ky cenim ka ardhur si pasojë e veprimeve apo mosveprimeve të këtyre organeve. Situata konkrete e lindur si pasojë e largimit nga detyra të gjyqtarit të çështjes pa plotësuar detyrimet ligjore për arsyetimin e vendimeve të tij, për më tepër kur rezulton nga aktet se në të njëjtën situatë me kërkuesin ndodhen edhe shumë shtetas të tjerë, kërkon një zgjidhje sa më të shpejtë. Në kushtet kur kuadri ligjor paraqet boshllëk për rregullimin e këtyre situatave, si dhe bazuar në rolin dhe misionin e Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Gjykata e gjen me vend të theksojë domosdoshmërinë dhe detyrimin e ndërhyrjes së këtyre organeve për të gjetur mjetin e përshtatshëm dhe mekanizmat për shmangien dhe zhblokimin e situatave të tilla, me qëllim respektimin e së drejtës së shtetasve për një proces të rregullt.

17. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për mohimin e së drejtës së aksesit në gjykatë është i bazuar dhe si i tillë duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.

- Konstatimin e cenimit të së drejtës së aksesit në gjykatë si pasojë e mosarsyetimit të vendimit nr. 1761, datë 9.9.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Vitore Tusha, Fatmir Hoxha, Fatos Lulo

VENDIM

Nr. 6, datë 23.2.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo anëtar i Gjykatës Kushtetuese, kryesues i seancës

Sokol Berberi anëtar i “ “

Vitore Tusha anëtare e “ “

Fatmir Hoxha anëtar i “ “

Gani Dizdari anëtar i “ “

Fatos Lulo anëtar i “ “

Besnik Imeraj anëtar i “ “

me sekretare Edmira Babaj, në datën 23.9.2015 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 46/9 Akti, që u përket palëve:

KËRKUES: Sami Abazi

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Shoqëria Përmbartimore Private “Hoti Bailiff Service”, Durrës

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Besnik Imeraj, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të



kërkuesit, që është shprehur për pranimin e kërkesës, dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesi ka qenë në marrëdhënie pune pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit (në vijim MPPTT), sot MTI-ja në pozicionin specialist në Drejtorinë e Transportit Rrugor. Me aktin nr. 1926/1, datë 6.3.2006 të sekretarit të Përgjithshëm është njoftuar për kalimin në listë pritjeje, për shkak të ristrukturimit të vendit të punës.

2. Duke mos qenë dakord me këtë vendim kërkuesi i është drejtuar Komisionit të Shërbimit Civil, duke kërkuar anulimin e vendimit dhe kthimin në vendin e mëparshëm të punës. Komisioni i Shërbimit Civil (në vijim KSHC-ja), me vendimin nr. 413, datë 9.6.2006, ka pranuar kërkesën e zotit Sami Abazi, duke shfuqizuar aktin nr. 22, datë 1.3.2006 të DAP-it, si dhe ka urdhëruar kthimin e ankuesit në vendin e mëparshëm të punës.

3. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 185, datë 3.11.2006, ka rrëzuar padinë e MPPTT-së, duke lënë në fuqi vendimin e KSHC-së.

4. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 1380, datë 30.11.2007, ka vendosur mospranimin e rekursit.

5. Gjykata e Apelit, me vendimin nr. 178, datë 11.5.2007, ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit për vendimin nr. 185, datë 3.11.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Kërkuesi fillimisht është përpjekur që ta zgjidhë me mirëkuptim ekzekutimin e këtij vendimi, por pasi nuk ka gjetur zgjidhje i është drejtuar shërbimit përmbartimor (në vijim SHPP) “Hoti Bailiff Service”, Durrës, i cili fillimisht i është drejtuar me shkresën e datës 5.7.2011 MPPTT-së për ekzekutimin në mënyrë vullnetare të vendimeve. Në datën 12.7.2011 MPPTT-ja kthen përgjigje se i duhej vënë në dispozicion dokumentacioni origjinal dhe se ky dikaster nuk disponon fonde. Pas kërkesës së SHPP-së ndaj Degës së Thesarit Tiranë për bllokimin e shumës 3.210.083 lekë, Dega e Thesarit, me shkresën e saj nr. 2580 të datës 3.10.2011, njofton MPPTT-në për vendosjen e sekuestros konservative, në rast moszbatimi të urdhrit të ekzekutimit. Në datën 21.10.2011, kryetari i Degës së Thesarit nxjerr

urdhër të brendshëm për vënien në sekuestro konservative, duke vënë në dijeni MPPTT-në dhe SHPP-në. Meqë urdhri nuk po zbatohet, SHPP-ja i është drejtuar përsëri MPPTT-së për ta ekzekutuar brenda 5 ditëve (shkresa nr. 00201/14, datë 16.1.2013). MPPTT-ja pas kësaj kërkon vënien në dispozicion të të gjithë dokumentacionit gjyqësor origjinal. Në vijim, SHPP-ja i drejtohet me urdhër sërish Degës së Thesarit (shkresa nr. 193/1, datë 29.1.2014). Përsëri Sekretari i Përgjithshëm i MTI-së (ish-MPPTT-ja), nëpërmjet shkresës nr. 2092/1, datë 23.4.2014, i kërkon SHPP-së vendimin e KSHC-së. Dega e Thesarit, me shkresën nr. 4817/1, prot. datë 28.5.2014, i drejtohet MTI-së, duke vënë në dijeni edhe SHPP-në për masat që duhet të marrin për ekzekutimin e vendimit. Sekretari i Përgjithshëm i MTI-së, me shkresën nr. 2726/1, datë 3.6.2014, i kthen përgjigje SHPP-së se do të veprojë sa më shpejt sapo t’i vihet në dispozicion buxheti i nevojshëm.

II

6. **Kërkuesi** pretendon cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur:

6.1. Nuk është vepruar për të vënë në ekzekutim menjëherë vendimin gjyqësor. Institucionet kanë zvarritur ekzekutimin e vendimeve gjyqësore dhe vendimin e ish-KSHC-së, duke mos qenë të predispozuara për të zbatuar vendimet përkatëse.

6.2. Subjektet e interesuara nuk kanë parashtruar argumentet e tyre.

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

III

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

7. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se çështja e legjitimitimit të kërkuesit lidhet drejtpërdrejt me iniciimin e një procesi kushtetues. Individit, në kuptim të neneve 131/f, 134/1/g dhe 134/2 të Kushtetutës, mund ta vërë në lëvizje këtë Gjykatë për çështje që lidhen me interesat e tij, kur pretendon se i janë cenuar të



drejtat kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike, çka nënkupton se kërkuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete (*shih vendimin nr. 52, datë 20.7.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Gjykata vlerëson se kërkuesi ka interes të ligjshëm për të kërkuar zbatimin e vendimit gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm dhe se në rastin konkret ai u është drejtuar gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, duke shteruar mjetet juridike për mbrojtjen e së drejtës së tij. Për ekzekutimin e vendimit gjyqësor kërkuesi i është drejtuar debitorit për ekzekutimin vullnetar të detyrimit, si edhe shërbimit përmbarimor për fillimin e procedurave për ekzekutimin e detyrueshëm.

9. Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se kërkuesi legjitimohet për t'iu drejtuar kësaj Gjykate për konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi ai ka përdorur të gjitha mjetet ligjore në dispozicion dhe se nuk ka mjet tjetër për rivendosjen e së drejtës të cenuar.

B. Për pretendimin për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm

10. Gjykata ka theksuar se ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i vendimit të formës së prerë të gjykatës është pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Parimet kushtetuese të lidhura me procesin e rregullt ligjor, si dhe detyrimi për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, i parashikuar në nenin 142/3 të Kushtetutës, nënvizojnë faktin se çdo qytetar, i cili i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pa kufi për realizimin e saj. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjyqimit të drejtë dhe çdo organ shtetëror duhet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre (*shih vendimin nr. 21, datë 7.4.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Gjykimi për realizimin e një të drejte përbëhet nga dy faza, të cilat janë të lidhura

pazgjidhshmërisht me njëra-tjetrën. Faza e parë, ose gjykimi në kuptimin e ngushtë, ka të bëjë me njohjen ose deklarimin e së drejtës, që si rregull përfundon kur vendimi gjyqësor merr formë të prerë. Në fazën e dytë, kur nevojitet edhe ndërhyrja, qoftë edhe me masa shtrënguese, për zbatimin e vendimit gjyqësor, realizohet ai që quhet qëllimi i drejtësisë. Në këtë fazë e drejta është e sigurt, por kërkohet që ajo të vihet në jetë.

12. Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individ i ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Pa dyshim që një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës (*shih vendimet nr. 21, datë 7.4.2014; nr. 14, datë 30.3.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore deri në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces (*shih vendimin nr. 14, datë 30.3.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Gjykata në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen dhe interesin e kërkuesit, si dhe të autoriteteve përkatëse.

i) Kompleksiteti i çështjes

15. Për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme (*shih vendimin nr. 15, datë 30.3.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Gjykata vëren se çështja në shqyrtim ka për objekt mosekzekutimin e vendimit të formës



së prerë brenda një afati të arsyeshëm për kthimin e kërkuarit në vendin e mëparshëm të punës dhe pagimin e detyrimeve monetare përkatëse. Kjo çështje në vlerësimin e Gjykatës nuk paraqet rrethana të veçanta apo kompleksitet që mund të justifikojë një vonesë në ekzekutimin e vendimit, ndaj vlerësimi i sjelljes së autoriteteve publike dhe kërkuarit është me rëndësi në këtë kontekst.

ii) Interesi dhe sjellja e kërkuarit

17. Në rastin konkret interesi i kërkuarit është i dukshëm dhe real, për sa kohë që detyrimi i palës debitore lidhet me të drejtën e tij për t'u kthyer në punë dhe për t'u paguar. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës rezulton se kërkuari ka vepruar në përputhje me të drejtat e tij procedurale, duke shteruar mjetet ligjore në dispozicion për ekzekutimin e detyrimit që buron nga vendimi gjyqësor i formës së prerë. Ai ka shfaqur interes të vazhdueshëm për ekzekutimin dhe nuk rezulton të jetë bërë shkak apo të ketë shkaktuar vonesa në këtë drejtim.

18. Me aktin nr. 1926/1, datë 6.3.2006 të sekretarit të Përgjithshëm është njoftuar për kalimin në listë pritjeje për shkak të ristrukturimit të vendit të punës. Duke mos qenë dakord me këtë vendim kërkuari i është drejtuar Komisionit të Shërbimit Civil, duke kërkuar anulimin e vendimit dhe kthimin në vendin e mëparshëm të punës. Komisioni i Shërbimit Civil, me vendimin nr. 413, datë 9.6.2006, ka pranuar kërkesën e kërkuarit, duke shfuqizuar aktin nr. 22, datë 1.3.2006 të DAP-it, si dhe ka urdhëruar kthimin e ankuesit në vendin e mëparshëm të punës. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 185, datë 3.11.2006, ka rrëzuar padinë e MPPTT-së, duke lënë në fuqi vendimin e KSHC-së. Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit. Gjykata e Apelit, me vendimin nr. 178, datë 11.5.2007, ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit.

iii) Sjellja e autoriteteve

19. Gjykata ka theksuar se në fazën e ekzekutimit marrin pjesë jo vetëm palët, pra debitori dhe kreditori, por edhe organet kompetente të ngarkuara me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Roli i këtyre organeve bëhet vendimtar kur debitori nuk pranon të ekzekutojë vullnetarisht detyrimin e tij karshi kreditorit. Në raste të tilla procesi i vendosjes në vend i një të drejte të shkelur

përfshin jo vetëm vendimarrjen e gjykatave, por edhe mënyrën e kryerjes së veprimeve konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë (*shih vendimin nr. 24, datë 22.4.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Kur autoritetet administrative refuzojnë, neglizhojnë ose vonojnë t'i ekzekutojnë këto vendime, garancitë që gëzon një palë e përfshirë në një proces gjyqësor e humbasin qëllimin e tyre. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por ajo nuk mund të jetë në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës (*shih vendimin nr. 8, datë 23.3.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në lidhje me autoritetet publike të përfshira në këtë proces duhet të shqyrtohet sjellja e secilit prej tyre. Për sa u përket veprimeve të përmbaaruesit gjyqësor privat, si subjekt procedural në fazën e ekzekutimit, rezulton se shoqëria përmbaarimore "Hoti Bailiff Service", Durrës i është drejtuar me shkresën e datës 5.7.2011 MPPT-së për ekzekutimin në mënyrë vullnetare të vendimeve. Në datën 12.7.2011 MPPT-ja kthen përgjigje se i duhej vënë në dispozicion dokumentacioni origjinal dhe se ky dikaster nuk disponon fonde. Pas kërkesës së SHPP-së ndaj Degës së Thesarit Tiranë për bllokimin e shumës 3.210.083 lekë, Dega e Thesarit, me shkresën e saj nr. 2580 të datës 3.10.2011, njofton MPPT-në për vendosjen e sekuestros konservative në rast moszbatimi të urdhrit të ekzekutimit. Në datën 21.10.2011 kryetari i Degës së Thesarit nxjerr urdhër të brendshëm për vënien në sekuestro konservative, duke vënë në dijeni MPPT-në dhe SHPP-në. Meqë urdhri nuk po zbatohet, SHPP-ja i është drejtuar MPPT-së për ta ekzekutuar brenda 5 ditëve këtë urdhër (shkresa nr. 00201/14, datë 16.1.2013). MPPT-ja pas kësaj kërkon vënien në dispozicion të të gjithë dokumentacionit gjyqësor origjinal. Në vijim, SHPP-ja i drejtohet me urdhër sërish Degës së Thesarit (shkresa.193/1, datë 29.1.2014). Përsëri sekretari i Përgjithshëm i MTI-së (ish-MPPTT-ja), nëpërmjet shkresës nr. 2092/1, datë 23.4.2014, i kërkon SHPP-së vendimin e KSHC-së. Dega e Thesarit, me shkresën nr. 4817/1 prot, datë 28.5.2014, i drejtohet MTI-së, duke vënë në dijeni edhe



SHPP-në për masat që duhet të marrin për ekzekutimin e vendimit. Sekretari i Përgjithshëm i MTT-së, me shkresën nr. 2726/1, datë 3.6.2014, i kthen përgjigje SHPP-së se do të veprojë sa më shpejt sapo t'i vihet në dispozicion buxheti i nevojshëm. Këto veprime nuk të krijojnë bindjen te Gjykata se është treguar vullnet për ekzekutimin e vendimit.

22. Gjykata ka theksuar se i takon debitorit të gjejë një mundësi zgjidhjeje sa më të përshtatshme, me qëllim vënien në vend të së drejtës së kreditorit. Autoritetet shtetërore nuk mund të justifikohen me pamundësinë objektive për të mos respektuar një detyrim që vjen nga një vendim gjyqësor, por duhet të përpiqen me të gjitha mjetet dhe mundësitë që kanë në dispozicion për ta zbatuar atë. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se shteti duhet të marrë përsipër vazhdimisht detyrimin për të siguruar palët pjesëmarrëse në proces se do të kenë mundësi reale të ekzekutojnë vendimin gjyqësor të formës së prerë dhe se e drejta për të pasur akses në gjykatë do të ishte iluzion nëse sistemi ligjor ose zbatimi i tij në praktikë do të bëhej shkak që një vendim gjyqësor i formës së prerë të mbetet i paekzekutuar dhe i pazbatueshëm për një kohë tepër të gjatë (*shih vendimin nr. 14, datë 30.3.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Bazuar në standardet e mësipërme dhe referuar veprimeve konkrete dhe sjelljes së debitorit, Gjykata vlerëson se pretendimi për mungesën e vendeve të lira për sistemimin e kërkesës nuk e shmang debitorin nga detyrimi për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Ai duhet të kishte marrë të gjitha masat e nevojshme dhe duhej të gjente mjetin e përshtatshëm ligjor për kthimin e kërkesës në punë, si një detyrim ligjor i cili rrjedh nga një vendim gjyqësor që tashmë është titull ekzekutiv. E njëjta logjikë vlen edhe për pjesën tjetër të vendimit të formës së prerë në lidhje me detyrimet monetare.

24. Në përfundim, Gjykata konstaton cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6/1 i KEDNJ-së, si rrjedhojë e mosekzekutimit brenda një afati të arsyeshëm të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “P” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g”, të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 185, datë 3.11.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Vladimir Kristo (kryesues), Vitore Tusha, Sokol Berberi, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Besnik Imeraj, Fatos Lulo

VENDIM

Nr. 7, datë 24.2.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“

me sekretare Blerina Basha, në datat 28.10.2015 dhe 23.11.2015 mori në shqyrtim në seancë plenare, me dyer të hapura, çështjen me nr. 65/20 Akti, që i përket:

KËRKUES: një e pesta e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga z. Ivi Kaso, me autorizim.



SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga z. Alban Brati, me autorizim.

Deputeti Koço Kokëdhima, përfaqësuar nga av. Artan Hajdari, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: Kundërshtimi i vendimit nr. 48/2015 të Kuvendit të Shqipërisë, “Për mosdërgimin në Gjykatën Kushtetuese të çështjes për konstatimin e papajtueshmërisë me detyrën e deputetit të zotit Koço Kokëdhima” dhe konstatimi i antikushtetutshmërisë së këtij vendimi.

Konstatimi i papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetit për zotin Koço Kokëdhima.

Interpretimi i nenit 70 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 7, 70, 71, 124, 131/e dhe 134/1/c të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenet 66 dhe 71 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjo i relatorin e çështjes Fatmir Hoxha; pretendimet e kërkesit, një të pestës së deputetëve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, i cili kërko i pranimin e kërkesës; prapësimet e subjekteve të interesuara, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe deputetit Koço Kokëdhima, të cilët kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Në datën 25.2.2015 një grup deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike kanë depozituar në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë (*Kuvendi*) kërkesë për ndjekjen e procedurave parlamentare për konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit për deputetin Koço Kokëdhima, me pretendimin se ky deputet e ka ushtruar mandatin në kundërshtim me paragrafët 2 dhe 3 të nenit 70 të Kushtetutës, pasi ka përfutur fonde nga buxheti i shtetit gjatë ushtrimit të detyrës.

2. Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, në përputhje me nenin 13/4 të Rregullores së Kuvendit, pasi ka zhvilluar procedurën e shqyrtimit të kësaj kërkesë dhe ka vlerësuar se kërkesa plotëson kushtet formale

sipas nenit 70/4 të Kushtetutës, ia ka kaluar atë seancës plenare për votim.

3. Në seancën plenare të datës 16.4.2015 Kuvendi ka rrëzuar kërkesën e grupit të deputetëve dhe ka marrë vendimin nr. 48/2015, “Për mosdërgimin në Gjykatën Kushtetuese të çështjes për konstatimin e papajtueshmërisë me detyrën e deputetit të zotit Koço Kokëdhima”.

II

4. **Kërkesi, një e pesta e deputetëve të Kuvendit**, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë për kundërshtimin e vendimit nr. 48/2015 të Kuvendit, konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetit Koço Kokëdhima, si dhe interpretimin e nenit 70 të Kushtetutës, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur sa vijon:

4.1. Për legjitimitimin e kërkesës

4.1.1. Kushtetuta ka njohur dy mënyra për të vënë në lëvizje Gjykatën për konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit të deputetit. Mënyra e parë parashikohet në pikën 4 të nenit 70 të Kushtetutës, e cila ndiqet vetëm për pretendimet për shkeljen e pikës 3 të po këtij neni, kurse mënyra e dytë parashikohet në nenet 131/e dhe 134/1/c të Kushtetutës, ku me kërkesë të një të pestës së deputetëve Gjykata vendos për çështje që lidhen me papajtueshmërinë në ushtrimin e mandatit. Pasi është abuzuar nga Kuvendi me mekanizmin e parë, është detyrë e një të pestës së deputetëve që të kërkojë zbatimin e mekanizmit të dytë.

4.1.2. Kërkesa për interpretimin përfundimtar të pikave 2, 3 dhe 4 të nenit 70 të Kushtetutës përmbush kriteret kushtetuese. *Së pari*, ekziston një marrëdhënie e ngushtë ndërmjet fakteve të çështjes konkrete dhe normës që kërkohej të interpretohet. *Së dyti*, subjektet në konflikt kanë mbajtur qëndrimin e tyre për kuptimin/interpretimin e kësaj norme. Qëndrimi është shprehur jo vetëm në raportin e Këshillit për Mandatet, por edhe nëpërmjet votimit në seancë plenare. *Së treti*, problemi kushtetues ka ardhur si pasojë e paqartësive në zbatimin e normës kushtetuese nga ana e shumicës parlamentare. *Së katërti*, shprehja e vullnetit të Kuvendit (shumicës parlamentare) është realizuar nëpërmjet vendimit të kundërshtuar nr. 48/2015.



4.2. *Për kërkesën për interpretimin e nenit 70 të Kushtetutës*

4.2.1. Kërkuesi pretendon se interpretimi i nenit 70 të Kushtetutës është i nevojshëm për sqarimin e çështjeve që kanë të bëjnë me:

4.2.1.1. Ndalimi për përfitimin e fondeve publike nga ana e një deputeti është i lidhur me momentin e lidhjes së kontratës, apo me ofrimin e një shërbimi privat nga shoqëria në pronësi të tij gjatë kohës që deputeti është mandatar si i tillë?

4.2.1.2. Nëse provohet se deputeti ka përfituar fonde publike, a mundet shumica parlamentare të ndalojë me vendim dërgimin e çështjes përpara Gjykatës Kushtetuese nëpërmjet analizimit të deformuar të fakteve dhe provave? Cili është roli i Kuvendit dhe Gjykatës Kushtetuese në këtë proces?

4.2.1.3. A përfshihet papajtueshmëria e përcaktuar nga ligji nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” (ligji nr. 9367/2005) në rastet që pasjellin mbarimin/pavlefshmërinë e mandatit të deputetit, në kuptim të pikës 2 të nenit 70 dhe pikës 2/c të nenit 71 të Kushtetutës?

4.2.1.4. A i lejohet deputetit që njëkohësisht të jetë edhe anëtar i asamblesë të përgjithshme të një shoqërie aksionare (pra të kryejë njëkohësisht një detyrë publike dhe një detyrë private)?

4.2.2. Qëndrimi i Kuvendit dhe opozitës parlamentare ka krijuar një konflikt kushtetues që rezulton nga interpretimi i ndryshëm i nenit 70 të Kushtetutës. Duke keqinterpretuar këtë dispozitë dhe rolin e tij në këtë proces, Kuvendi ka analizuar provat dhe faktet dhe ka vendosur se nuk ndodhej para rasteve të shkeljes së nenit 70, çka është një interpretim i gabuar, sepse kompetenca për konstatimin e papajtueshmërisë, pra për vlerësimin e provave dhe fakteve, i takon Gjykatës Kushtetuese, ndërsa detyra e Kuvendit është vetëm vlerësimi i aspekteve formale të mocionit.

4.2.3. Sipas shumicës parlamentare ndalimi i shprehur në pikën 3 të nenit 70 të Kushtetutës ka të bëjë vetëm me lidhjen e kontratave pas marrjes së mandatit të deputetit, ndërkohë që për iniciuesin e mocionit ofrimi i shërbimeve private dhe përfitimi i fondeve publike nga një deputet

pas mandatimit, pavarësisht kur janë lidhur kontratat, përbën shkelje të kësaj dispozite.

4.3. *Për kërkesën për shfuqizimin e vendimit nr. 48/2015 të Kuvendit dhe konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit për deputetin Koço Kokëdhima*

4.3.1 Ndalimi për ushtrimin e aktivitetit fitimprurës është vendosur në nivel kushtetues, me qëllim që të eliminohet konsiderimi i funksionit të deputetit si një mundësi për të shtuar burimin e të ardhurave private nëpërmjet pozitës së favorshme si anëtar i organit më të lartë përfaqësues.

4.3.2 Shoqëria tregtare në pronësi të deputetit Koço Kokëdhima ka realizuar veprimtari fitimprurëse që burojnë nga pasuria e shtetit dhe pushtetit vendor nëpërmjet ofrimit të shërbimeve të faturuara në të paktën 150 raste. Kushtetuta nuk flet as për momentin e lidhjes së kontratës, as për shpërndarjen ose jo të dividendit. Mjafton konstatimi i faktit se gjatë kohës që ushtron mandatin deputeti ose shoqëria tregtare në pronësi të tij ka ushtruar veprimtari fitimprurëse dhe ka përfituar të ardhura nga buxheti i shtetit, për të qenë para rastit klasik të pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës.

4.3.3 Zotërimi i aksioneve në shoqërinë “Abissnet” sh.a. nënkupton se deputeti ka qenë anëtar i Asamblesë së Përgjithshme, si një nga organet drejtuese të shoqërisë. Duke zotëruar 100% të aksioneve, ky deputet, të paktën në periudhën 2.8.2014-06.2.2014, ka ushtruar njëkohësisht funksionin publik të deputetit dhe atë privat të anëtarit dhe drejtuesit të organit drejtues të një organizate fitimprurëse.

5. **Subjekti i interesuar, Kuvendi**, në prapësimet e tij para Gjykatës ka argumentuar sa vijon:

5.1. Sipas pikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës, Kuvendi ka legjitimitetin e vetëm për të iniciuar një gjykim kushtetues për një çështje të tillë. Në mungesë të vendimit të Kuvendit, Gjykata nuk ka lëndë apo çështje për të gjykuar, çka sjell edhe mungesën e juridiksionit të saj për të shqyrtuar çështjen e konstatimit të papajtueshmërisë me mandatin të deputetit Koço Kokëdhima. Ky rregullim, duke përbërë një normë specifike, ka përparësi dhe përjashton rregullimin e normës së përgjithshme që sanksionon neni 134 i Kushtetutës.



5.2. Nga interpretimi literal, sistematik dhe teleologjik i pikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës, arrihet në përfundimin se kushtetutëbërësi ka pasur si qëllim të vetëm t'i njohë Kuvendit të drejtën për të vlerësuar mocionet mbi këto çështje, por edhe që kjo vendimmarrje të kalojë nëpërmjet procedurave të zakonshme të votimit. Nëse kushtetutëbërësi do të kishte dashur t'i hiqte Kuvendit të drejtën për të vlerësuar këto mocione, mund ta kishte bërë duke mos përdorur në këtë dispozitë fjalën “vendos”, por të shprehur në të njëjtën mënyrë siç ka vepruar për komisionet hetimore në pikën 2 të nenit 77 të Kushtetutës.

5.3. Gjykata, bazuar në jurisprudencën e saj, nuk e interpreton Kushtetutën *in abstracto*, por për të zgjidhur një nga çështjet konkrete që përcaktohen në nenin 131 të Kushtetutës apo dispozita të tjera kushtetuese. Rrjedhimisht, edhe për shkak të mungesës së lëndës/mosmarrëveshjes konkrete që t'i përkasë njëres prej çështjeve që përcaktohen në këto dispozita kushtetuese, Gjykata nuk ka juridiksion për të ushtruar kompetencën e saj kushtetuese për interpretimin përfundimtar të Kushtetutës.

6. **Subjekti i interesuar, deputeti Koço Kokëdhima**, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për të marrë pjesë në gjykim si palë që preket drejtpërdrejt nga procesi për shkak të efektit të këtij vendimi mbi mandatin e tij. Në seancën e datës 28.10.2015 Gjykata vendosi pranimin e kërkesës, duke e legjitimuar këtë subjekt për të marrë pjesë në gjykim dhe për t'u dëgjuar për pretendimet e tij. Përfaqësuesi i këtij subjekti në prapësimet e tij para Gjykatës ka argumentuar sa vijon:

6.1. Kërkuesit i mungon legjitimiteti për të iniciuar këtë gjykim kushtetues, pasi i vetmi subjekt që legjitimohet në paraqitjen e kërkesës për konstatimin e papajtueshmërisë me mandatin e deputetit është Kuvendi. Në këtë lloj gjykimi nuk gjen zbatim neni 134/1/c i Kushtetutës. Po ashtu, kërkuesi nuk mund t'i drejtohet Gjykatës me kërkesë për interpretim *in abstracto* të pikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës. Në mungesë të një mosmarrëveshjeje konkrete, pasi nuk ka një vendim të Kuvendit në kuptim të kësaj dispozite dhe as një kërkesë të paraqitur prej tij si subjekt i legjitimuar, Gjykata nuk mund të vendosë të bëjë

interpretimin përfundimtar të normës kushtetuese.

6.2. Deputeti Koço Kokëdhima nuk ka përfituar asnjë pasuri të shtetit apo të pushtetit vendor gjatë kohës që ka pasur një mandat të vlefshëm deputeti. Ai ka qenë aksionar i shoqërisë “Abissnet” sh.a. prej datës 29.10.1999 (data e themelimit të saj) deri në datën 6.2.2014 kur ka tjetërsuar (shitur) të drejtat mbi aksionet e tij. Të gjitha pagesat e kryera nga institucionet shtetërore ndaj kësaj shoqërie janë rrjedhojë e ekzekutimit të detyrimeve për kontrata të lidhura para datës së fitimit të mandatit të deputetit. Për më tepër, deputeti Koço Kokëdhima, si ortak apo aksionar i shoqërisë, nuk ka përfituar drejtpërdrejt ose në mënyrë indirekte, pasi shoqëria nuk ka ndarë dividend në lidhje me fitimet e arkëtuara si rrjedhojë e pagesave të kryera nga institucionet shtetërore. Ai është larguar si aksionar pa u mbyllur viti financiar për shoqërinë.

6.3. Kërkesa e paraqitur nga kërkuesi bie ndesh me KEDNJ-në dhe praktikën e GJEDNJ-së. Heqja e mandatit të deputetit me arsyetimin se ka përfituar nga fondet publike, përbën ndërhyrje të paligjshme dhe joproporcionale në reputacionin e tij, të garantuar nga neni 8 i KEDNJ-së. Heqja e mandatit cenon të drejtën për të ushtruar funksionin e deputetit dhe privon votuesit për t'u përfaqësuar nga kandidati i zgjedhur prej tyre për kohën deri në përfundim të mandatit.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitetin e kërkuesit

A.1. Për kërkimin për konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetit Koço Kokëdhima

7. Kërkuesi, një e pesta e deputetëve të Kuvendit, i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetit Koço Kokëdhima. Sipas këtij subjekti, Kushtetuta ka njohur dy mekanizma për të vënë në lëvizje juridiksionin kushtetues në të tilla raste, njëri bazuar në pikën 4 të nenit 70 të Kushtetutës, kurse tjetri bazuar në nenet 131/e dhe 134/1/c të Kushtetutës. Sipas kërkuesit, duke qenë se Kuvendi ka abuzuar me mekanizmin e parë, është detyrë e tij



të kërkojë zbatimin e mekanizmit të dytë, duke iu drejtuar drejtpërdrejt Gjykatës për ushtrimin e juridiksionit të saj në përputhje me nenin 70/4 të Kushtetutës.

8. Sipas subjekteve të interesuara, për sa kohë Gjykata nuk është vënë në lëvizje në përputhje me parashikimin e pikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës, kërkesit i mungon legjitimiteti për të iniciuar gjykimin kushtetues për konstatimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit Koço Kokëdhima.

9. Kushtetuta në nenin 131 ka përcaktuar kompetencat kryesore të Gjykatës Kushtetuese, kurse në nenin 134/1 të saj ka përcaktuar rrethin e subjekteve kushtetuese, të cilat legjitimohen të vënë në lëvizje juridiksionin kushtetues. Në pikën 2 të nenit 134 është përcaktuar kriteri kushtetues i “detyrimit për të justifikuar interesin”, i cili është elementi përcaktues në ndarjen e rrethit të subjekteve kushtetuese në dy kategori: subjekte të kushtëzuara dhe subjekte të pakushtëzuara. Si një nga subjektet e pakushtëzuara, një e pesta e deputetëve legjitimohet të vërë në lëvizje Gjykatën, në kuptim të nenit 131 të Kushtetutës, pa pasur nevojën e justifikimit të interesit të tij (*shih vendimin nr. 19, datë 15.4.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, nenet 131 dhe 134 të Kushtetutës nuk mund të lexohen të shkëputura nga dispozitat e tjera kushtetuese materiale ose procedurale, të cilat përkufizojnë kompetencën, si dhe përcaktojnë mekanizmin dhe procedurën për vënien në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se normat kushtetuese nuk mund të interpretohen si norma të izoluar, por duhen parë në harmoni me normat e tjera kushtetuese. Një qëndrim i tillë bazohet në faktin se asnjë dispozitë e Kushtetutës nuk mund të nxirret jashtë kontekstit të saj dhe të interpretohet më vete, pasi çdo dispozitë kushtetuese duhet të interpretohet në mënyrë që të jetë e pajtueshme me parimet themelore kushtetuese, kjo për arsye se të gjitha normat dhe parimet kushtetuese formojnë një sistem harmonik, pa kontradikta të brendshme. Në leximin e Kushtetutës nevojitet harmonizimi i tekstit të saj integral dhe pajtimi i atyre dispozitave që mund të duket se krijojnë përplasje mes tyre (*shih vendimin nr. 29, datë 30.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Sipas pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës deputetët nuk mund të kryejnë asnjë veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor dhe as të fitojnë pasuri të këtyre. Kurse sipas pikës 4 të po këtij neni: “*Për çdo shkelje të paragrafit 3 të këtij neni, me mocion të Kryetarit të Kuvendit ose të një së dhjetës së anëtarëve të tij, Kuvendi vendos për dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese, e cila konstaton papajtueshmërinë*”. Në këtë dispozitë është përcaktuar Kuvendi si subjekt i posaçëm që vë në lëvizje gjykimin kushtetues, si dhe subjektet që iniciojnë procedurat parlamentare për këtë qëllim (Kryetari i Kuvendit ose një e dhjeta e anëtarëve të tij). Përmbajtja e nenit 70/4 të Kushtetutës reflektohet edhe në nenin 66/3 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, sipas të cilit kërkesa për papajtueshmëri mund të paraqitet në Gjykatë nga Kuvendi për sa kohë vazhdon mandati i deputetit. Vendimarrja e Kuvendit, në kuptim të nenit 70/4 të Kushtetutës, është në funksion të legjitimitetit të këtij subjekti për iniciimin e gjykit kushtetues për konstatimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit (*shih vendimin nr. 29, datë 30.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në kushtet kur dispozita e pikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës është norma e posaçme që rregullon procedurën për iniciimin e këtij lloji gjykimi, ajo prevalon mbi parashikimin e përgjithshëm të neneve 131 dhe 134 të Kushtetutës. Gjykata vëren se ky është edhe interpretimi që vetë kërkesi u ka bërë këtyre dispozitave kushtetuese, pasi siç dhe rezulton nga materialet e kërkesës ai nuk i është drejtuar drejtpërdrejt Gjykatës për konstatimin e papajtueshmërisë me mandatin e deputetit, por ka ndjekur rrugën parlamentare, duke i kërkuar Kuvendit që ta dërgojë çështjen në këtë Gjykatë.

12. Në përfundim, Gjykata vlerëson se kërkesi, një e pesta e deputetëve, si një nga subjektet e parashikuara në nenin 134 të Kushtetutës, nuk legjitimohet t’i drejtohet drejtpërdrejt Gjykatës për të kërkuar konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetit. Në të tilla raste, në pajtim me pikën 4 të nenit 70 të Kushtetutës, Gjykata mund të vihet në lëvizje vetëm me vendim të Kuvendit.



A.2. Për kërkimin për interpretimin e nenit 70 të Kushtetutës

13. Kërkuesi ka kërkuar para Gjykatës interpretimin përfundimtar të nenit 70 të Kushtetutës, duke evidentuar në kërkesë edhe çështjet që nevojiten të sqarohen nga ky interpretim.

14. Sipas subjekteve të interesuara, Gjykata nuk e interpreton Kushtetutën *in abstracto*, por për të zgjidhur një nga çështjet konkrete që përcaktohen në nenin 131 të Kushtetutës apo dhe dispozita të tjera kushtetuese. Rrjedhimisht, edhe për shkak të mungesës së lëndës/mosmarrëveshjes konkrete që t'i përkasë njërës prej çështjeve që përcaktohen në këto dispozita kushtetuese, Gjykata nuk ka juridiksion për të ushtruar kompetencën e saj kushtetuese për të bërë interpretimin përfundimtar të Kushtetutës.

15. Gjykata rithekson se një e pesta e deputetëve përfaqëson një nga subjektet e parashikuara në nenin 134/1/c të Kushtetutës, të cilat kanë të drejtë të vënë në lëvizje juridiksionin kushtetues për arsye të një interesi publik, pa u kushtëzuar me një interes subjektiv konkrete. Interesi i këtyre funksionarëve publikë për të mbrojtur sistemin normativ dhe parimet shtetformuese si konstitucionalizmi, shteti i së drejtës, demokracia, dinjiteti njerëzor, barazia sociale etj., të shpalosura në Kushtetutë, nuk është i kushtëzuar (*shih vendimin nr. 59, datë 23.12.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në nenin 124 të Kushtetutës parashikohet se Gjykata garanton respektimin e Kushtetutës dhe bën interpretimin përfundimtar të saj. Në këtë kuptim, Gjykata, nëpërmjet dhënies së drejtësisë kushtetuese, siguron epërsinë e Kushtetutës në sistemin ligjor. Interpretimi përfundimtar i ligjit themelor të shtetit është një nga funksionet e rëndësishme të kësaj Gjykate dhe ajo e ushtron këtë kompetencë sa herë që vihet në lëvizje për t'u shprehur për një nga çështjet e parashikuara në nenin 131 të Kushtetutës dhe në normat e tjera kushtetuese, sepse gjatë këtij kontrolli është i nevojshëm, në çdo rast, interpretimi i kuptimit të normave kushtetuese që lidhen me çështjen konkrete në shqyrtim (*shih vendimin nr. 24, datë 9.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Interpretimi përfundimtar që bën Gjykata nuk ka si qëllim shtimin e normave të reja në sistemin e normave detyruese ligjore, por deklarin e pohimin e përmbajtjes së këtyre normave. Me qëllim shmangien e çdo mundësie për ndërhyrje nga Gjykata në kompetencat e pushtetit ligjvënës, Gjykata nuk merr përsipër të kryejë rolin e legjislatorit, por t'u japë jetë normave kushtetuese përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre (*shih vendimin nr. 29, datë 30.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Gjykata në praktikën e vazhdueshme të saj ka vlerësuar se ushtrimi i kompetencës së interpretimit përfundimtar të normës kushtetuese kërkon plotësimin e kushteve si vijon: *Së pari*, norma që kërkohet të interpretohet duhet të jetë e paqartë dhe si pasojë e kësaj paqartësie që ajo mbart dhe kuptimit që i është dhënë ka lindur një “problem/mosmarrëveshje kushtetues/e. *Së dyti*, kërkohet të ekzistojë një marrëdhënie e ngushtë ndërmjet normës konkrete kushtetuese dhe fakteve, mosmarrëveshjeve ose çështjeve të përcaktuara konkretisht në një ose disa akte të organit kompetent, si pasojë e zbatimit ose kuptimit të padrejtë të kësaj norme kushtetuese. *Së treti*, kërkohet që organet, të cilat zbatojnë normën kushtetuese, të kenë mbajtur qëndrimin e tyre për kuptimin/interpretimin e kësaj norme. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se qëndrimet e mbajtura nga një organ për interpretimin e normave konkrete të Kushtetutës, që shprehen nëpërmjet vendimeve të këtij organi, janë të mjaftueshme për kryerjen e një interpretimi përfundimtar (*shih vendimin nr. 59, datë 23.12.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në vështrim të standardeve të mësipërme kushtetuese dhe të rrethanave të çështjes konkrete, Gjykata vlerëson nëse kërkesa plotëson kushtet që ajo të vihet në lëvizje për të bërë interpretimin përfundimtar të dispozitës kushtetuese objekt i kërkesës.

20. Sipas pikës 2 të nenit 70 të Kushtetutës deputetët nuk mund të ushtrojnë njëkohësisht asnjë detyrë tjetër shtetërore, përveç asaj të anëtarit të Këshillit të Ministrave, kurse sipas pikës 3 të po këtij neni deputetët nuk mund të kryejnë asnjë veprimtarisë fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor dhe as të fitojnë pasuri të këtyre. Duke iu referuar pretendimeve të kërkuesit, Gjykata vëren se ai ka



ngritur këto çështje për interpretim në lidhje me pikat 2 dhe 3 të nenit 70 të Kushtetutës: Ndalimi për përfitimin e fondeve publike nga ana e një deputeti është i lidhur me momentin e lidhjes së kontratës, apo me ofrimin e një shërbimi privat nga shoqëria në pronësi të tij gjatë kohës që deputeti është mandatar si i tillë? A përfshihet papajtueshmëria e përcaktuar nga ligji nr. 9367/2005 në rastet që passjellin mbarimin/pavlefshmërinë e mandatit të deputetit, në kuptim të pikës 2 të nenit 70 dhe pikës 2/c të nenit 71 të Kushtetutës? A i lejohet deputetit që njëkohësisht të jetë edhe anëtar i Asamblesë të Përgjithshme të një shoqërie aksionare (pra të kryejë njëkohësisht një detyrë publike dhe një detyrë private)?

21. Kur një grup deputetësh vë në lëvizje Gjykatën për interpretimin përfundimtar të Kushtetutës duhet të argumentojë se ka më shumë se një interpretim ose zbatim të ndryshëm të Kushtetutës dhe se nga ky fakt kanë ardhur pasoja të tilla që kanë shkaktuar nevojën për një interpretim përfundimtar të Kushtetutës (*shih vendimin nr. 59, datë 23.12.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata vëren se kërkuesi nuk paraqiti argumente kushtetuese të mjaftueshme lidhur me legjitimitimin e tij për interpretimin e pikave 2 dhe 3 të nenit 70 të Kushtetutës as në kërkesë, as në seancë plenare. Gjithashtu, ai nuk paraqiti as ndonjë argument kushtetues apo qëndrim konkret për mënyrën e ndryshme të leximit të këtyre dispozitave lidhur me çështjet e parashtruara, nga të cilat mund të lindin dyshime për mënyrën e interpretimit të tyre. Çështjet e mësipërme të ngritura për interpretim nga kërkuesi, për mënyrën se si janë parashtruar ato, kanë të bëjnë në thelb me mënyrën e interpretimit të akteve ligjore në fuqi, që parashikojnë ndalimet e posaçme në ushtrimin e mandatit të deputetit. Interpretimi i secilit rast papajtueshmërie, siç kërkohet nga kërkuesi, nuk është funksion i kësaj Gjykate. Këto pretendime ngjajnë më shumë me një kërkesë për dhënien e një opinionit këshillimor nga ana e Gjykatës për interpretimin e dispozitave ligjore në të ardhmen. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk legjitimohet për interpretimin e pikave 2 dhe 3 të nenit 70 të Kushtetutës.

B. Për interpretimin e përmbajtjes së pikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës

22. Kërkuesi ka kërkuar para Gjykatës edhe interpretimin e pikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës. Sipas tij: ekziston një mosmarrëveshje konkrete ndërmjet shumicës dhe pakicës parlamentare, që ka lindur si pasojë e zbatimit ose kuptimit të ndryshëm/gabuar të normës kushtetuese; subjektet në konflikt kanë mbajtur qëndrimin e tyre për kuptimin/interpretimin e kësaj norme, i cili është shprehur jo vetëm në raportin e Këshillit për Mandatet, por edhe nëpërmjet votimit në seancë plenare dhe miratimit të vendimit nr. 48/2015 nga ana e Kuvendit; problemi kushtetues ka ardhur si pasojë e paqartësive në zbatimin e normës kushtetuese nga ana e shumicës parlamentare. Sipas kërkuetit, duke keqinterpre-tuar këtë dispozitë dhe rolin e tij në këtë proces, Kuvendi ka analizuar provat dhe faktet dhe ka vendosur se nuk ndodhej para rasteve të shkeljes së nenit 70/3, ndërkohë që kompetencën për konstatimin e papajtueshmërisë, pra për vlerësimin e provave dhe fakteve, e ka Gjykata Kushtetuese. Detyra e Kuvendit është vetëm vlerësimi i aspekteve formale të mocionit. Ai është i detyruar t'ia dërgojë çështjen Gjykatës sa herë ka një pretendim të bazuar për shkeljen e kësaj dispozite kushtetuese.

23. Gjykata vëren se sipas pikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës, për çdo shkelje të pikës 3 të këtij neni, ajo vihet në lëvizje vetëm me kërkesë të Kuvendit. Megjithatë kjo dispozitë, sipas kërkuetit dhe subjekteve të interesuara, shfaq paqartësi në lidhje me diskrecionin që ka Kuvendi në këtë proces, pra nëse vendimmarrja e Kuvendit është vetëm një hap formal i nevojshëm për iniciimin e gjykimit kushtetues, apo nëse ky organ ka të drejtë të vendosë edhe në lidhje me meritën e çështjes? Si pasojë e kësaj paqartësie ka lindur një mosmarrëveshje kushtetuese mes shumicës dhe pakicës parlamentare, të cilat mbajnë qëndrime të ndryshme për kuptimin e dispozitës që kërkohet të interpretohet. Po ashtu, zgjidhja e mosmarrëveshjes së lindur është e lidhur me mënyrën e interpretimit të dispozitës konkrete kushtetuese. Nga ana e organeve që e zbatojnë dispozitën kushtetuese është mbajtur qëndrimi për interpretimin e saj. Një e dhjeta e deputetëve, pjesë e opozitës parlamentare, ka kërkuar me mocion vënien në lëvizje nga Kuvendi të



Gjykatës Kushtetuese për konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit. Ky i fundit, i cili në ushtrimin e funksionit kryesor si ligjvënës është në të njëjtën kohë edhe interpretuesi i parë i normës kushtetuese, ka mbajtur qëndrimin se neni 70/4 i Kushtetutës nuk e detyron Kuvendin t'i drejtohet në çdo rast Gjykatës, por është ky organ që vlerëson rast pas rasti nëse janë kushtet për iniciimin e gjykimit kushtetues. Kuvendi (shumica parlamentare) në seancë plenare, me vendimin nr. 48/2015, ka vendosur mosdërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese. Për pasojë, një grup deputetësh i pakicës parlamentare i është drejtuar drejtpërdrejt Gjykatës, duke kërkuar konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetit, si dhe interpretimin e pikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës.

24. Gjykata vëren, gjithashtu, se për kuptimin dhe interpretimin e pikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës ka pasur qëndrime të ndryshme në praktikën parlamentare. Me këtë rast Gjykata risjell në vëmendje çështjen e deputetit I. B. (vendimi nr. 44, datë 7.10.2011), ku ajo u vu në lëvizje nga vetë Kuvendi për shqyrtimin në themel të kërkesës dhe vlerësimin e papajtueshmërisë së mandatit të këtij deputeti.

25. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkuesi arriti të argumentojë nevojën për një interpretim përfundimtar të përmbajtjes së pikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës, për rrjedhojë ai legjitimohet për të vënë në lëvizje këtë Gjykatë.

26. Gjykata vëren se parashikimi nga kushtetutëbërësi i rasteve të papajtueshmërive që lidhen me mandatin e deputetit përbën një garanci për respektimin e parimit të ndarjes së pushteteve, pavarësisë në ushtrimin e mandatit parlamentar, si dhe evitimin e konflikteve të interesave. Ndërsa sipas pikës 2 të nenit 70 Kushtetuta jonë ia ka deleguar ligjeve të posaçme rastet e papajtueshmërisë, në pikën 3 të kësaj dispozite ka preferuar të vendosë ndalimin në rang kushtetues dhe ta cilësojë si të papajtueshëm me funksionin e deputetit ushtrimin e aktivitetit fitimprurës prej tij, kur të ardhurat nga ky aktivitet burojnë nga buxheti i shtetit. Ky ndalim është i shprehur qartë dhe pa ekuivok nga kushtetutëbërësi, i cili ka pasur si qëllim eliminimin e plotë të shkaqeve për ta konsideruar funksionin e deputetit si një mundësi e mirë për

të shtuar burimin e të ardhurave private nëpërmjet pozitës së favorshme që ka ai si anëtar i organit më të lartë përfaqësues (*shih vendimin nr. 44, datë 7.10.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Gjykata në vlerësimin e kësaj çështjeje niset nga premisa që një normë duhet të interpretohet në kuptimin që lejon zbatimin e saj, jo në atë që e përjashton këtë zbatim (*actus interpretandus est potius ut valeat quam ut pereat*). Sipas pikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës, për çdo shkelje të pikës 3 të këtij neni Gjykata vihet në lëvizje nga Kuvendi për ushtrimin e kompetencës së saj për konstatimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit. Në kuptim të kësaj dispozite kushtetutëbërësi ka parashikuar ndërhyrjen e Gjykatës vetëm për konstatimin e rasteve të papajtueshmërisë të parashikuara në pikën 3 të nenit 70. Gjykata, bazuar në interpretimin literal, sistematik dhe teleologjik të kësaj dispozite, vlerëson se përfshirja e saj në këtë proces është bërë për të eliminuar një vendimarrje me natyrë politike nga ana e Kuvendit. Vënia në lëvizje e gjykimit kushtetues vetëm për rastin e verifikimit të papajtueshmërisë sipas pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës, konsiderohet një instrument kontrolli ndaj pushtetit ligjvënës që kërkon gjykim, gjë që del jashtë tagrave dhe mundësive të Kuvendit. Nëse do t'i jepej një interpretim i ndryshëm kësaj dispozite, ndërhyrja e Gjykatës Kushtetuese do të ishte formale, çka do e bënte atë të panevojshme, dhe vendimarrja e Kuvendit do të bëhej e pakontrollueshme nga pikëpamja e kushtetutshmërisë.

28. Gjykata thekson se në një demokraci parlamentare ekziston një balancë ndërmjet shumicës dhe pakicës, çka krijon një formë ndërveprimi që siguron një qeverisje efektive, demokratike dhe legjitime. Ekzistenca e një pakice parlamentare brenda dhe jashtë Parlamentit është një element i rëndësishëm i një demokracie mirëfunktionale. Duke mbikëqyrur dhe kritikuar punën e shumicës, pakica synon të sigurojë transparencën e vendimarrjes publike dhe eficiencën në menaxhimin e punëve publike, duke siguruar në këtë mënyrë mbrojtjen e interesit publik dhe parandalimin e keqpërdorimit të pushtetit. Edhe pse brenda Parlamentit si rregull pakica nuk ka kompetencën për të marrë vendime, funksioni i saj është, mes



të tjerash, përmirësimi i procedurës së vendimmarrjes politike, kontrolli i qeverisjes, si dhe rritja e stabilitetit, legjitimitetit dhe përgjegjësisë e transparencës në proceset politike. Ekzistenca e rregullimeve kushtetuese e ligjore në të tilla raste është një mënyrë e institucionalizimit të rolit të pakicës parlamentare. Një demokraci kushtetuese, ku ushtrimi i pushteteve rregullohet përmes procedurave të mbrojtura kushtetutshmërisht, respektimi i të cilave nuk lihet në diskrecionin e shumicës, është garancia më e mirë për ekzistencën e një pakice efektive politike.

29. Në kuptim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se kushtetutëbërësi e ka ngritur në nivel kushtetues të drejtën e pakicës parlamentare (në këtë rast një e dhjeta e deputetëve) për të kërkuar vënien në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese, si shprehje të ushtrimit të pushtetit të saj kontrollues ndaj shumicës parlamentare. Duke i dhënë asaj një mbrojtje kushtetuese kushtetutëbërësi ka evituar ndërhyrjen e shumicës në ushtrimin e kësaj të drejte, si dhe diskrecionin e shumicës në interpretimin dhe vlerësimin e saj rast pas rasti. Megjithatë, Gjykata vlerëson se përmbajtja e pikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës nuk e ka zhveshur tërësisht Kuvendin nga vendimmarrja, por i ka kufizuar hapësirën e vlerësimit, duke ia njohur atë vetëm për verifikimin e kriterëve juridiko-formale për iniciimin e procesit. Në të tilla raste Kuvendi, nëpërmjet Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetet, verifikon nëse mocioni i paraqitur plotëson kërkesat juridiko-formale, siç janë numri i anëtarëve nënshkrues, ekzistenca e dokumentacionit dhe provave që mbështesin mocionin e paraqitur, verifikon momentin e marrjes së mandatit nga deputeti, verifikon nëse mocioni plotëson kriteret kushtetuese të parashikuara në pikën 3 të nenit 70 për vënien në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese, si dhe kujdeset për respektimin e procedurës parlamentare për votimin e mocionit në seancë plenare, në përputhje me parashikimet e Rregullores së tij.

30. Gjykata vlerëson se në të tilla raste Kuvendi nuk mund të vërë në diskutim mocionin e paraqitur dhe nuk mund t'ia nënshtrojë atë debatit parlamentar, por vendimmarrja e tij si organ kolegjal është e domosdoshme me qëllim vënien në lëvizje të

kësaj Gjykate për t'u shprehur për themelin e çështjes, për sa kohë që pa një vendim të shumicës parlamentare Gjykata nuk mund të shqyrtojë kërkesa të tilla. Vendimmarrja e Kuvendit në raste të tilla është në funksion të legjitimitetit të këtij organi si një nga subjektet që mund të vënë në lëvizje juridiksionin kushtetues. Kuvendi në këto raste nuk mund t'i hyjë themelit të çështjes, pra vlerësimit nëse veprimet konkrete të pretenduara të kryera nga deputeti janë të papajtueshme me mandatin e tij, sepse në të kundërt do të ndërhynte në kompetencat që kushtetutëbërësi ia ka njohur vetëm Gjykatës Kushtetuese. Me fjalë të tjera, ndonëse verifikimi dhe vlerësimi i kriterëve juridiko-formale të kërkesave të kësaj natyre është një çështje që i përket Kuvendit, vlerësimi i meritës së çështjes, pra nëse me veprimet e tij deputeti ka shkelur ndalimin kushtetues të pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës, me pasojë konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit, është një çështje që i përket ekskluzivisht Gjykatës Kushtetuese. Një përfundim i tillë gjen mbështetje edhe në jurisprudencën e kësaj Gjykate, e cila ka theksuar edhe më parë se është organi i vetëm që ka kompetencën të vendosë nëse veprimet konkrete të një anëtarit të Parlamentit, kundër të cilit është iniciuar procedura për konstatimin e papajtueshmërisë me mandatin, janë në kundërshtim me Kushtetutën (*shih vendimet nr. 29, datë 30.6.2011; nr. 44, datë 7.10.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Gjykata, në ndryshim nga sa pretendojnë subjektet e interesuara, vlerëson se edhe pse në përmbajtjen e pikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës nuk është përdorur termi “është i detyruar”, kjo nuk nënkupton se vlerësimi në këtë rast është në kompetencë të Kuvendit, por se vënia në lëvizje e Gjykatës kërkon një vendimmarrje të këtij organi, e cila është produkt i seancës plenare, pas respektimit të procedurave parlamentare. Nëse do të pranohej një pushtet i tillë i pakufizuar i Kuvendit, atëherë parashikimi kushtetues do të zhvishej nga qëllimi i tij, çka do të përbënte një abuzim me pushtetin e shumicës dhe do të ishte në kundërshtim me parimin e ndarjes dhe të balancimit ndërmjet pushteteve. Institucionalizimi i pushtetit të pakicës parlamentare, i materializuar në të drejtën për të kërkuar vënien në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese, është bërë



nga kushtetutëbërësi me qëllim shmangien e qëndrimeve politike nga ana e shumicës parlamentare. Në rast se do të pranohej një interpretim i ndryshëm i kësaj norme, atëherë pakica parlamentare do të diskriminohej në raport me shumicën parlamentare, për sa kohë që ushtrimi i së drejtës së saj kushtetuese, i garantuar në pikën 4 të nenit 70 të Kushtetutës, do të ishte në diskrecionin e kësaj të fundit.

32. Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se për çdo shkelje të pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës, kur kërkohet konstatimi i papajtueshmërisë me mandatin e deputetit, Kuvendi është i detyruar ta dërgojë çështjen në Gjykatën Kushtetuese, e cila është organi i vetëm që ka kompetencën ta shqyrtojë në themel çështjen. Në raste të tilla hapësira e vlerësimit të Kuvendit lidhet vetëm me verifikimin e kritereve juridiko-formale, duke respektuar procedurat parlamentare të parashikuara në Rregulloren e këtij organi.

33. Bazuar në argumentet e lartpërmendura, Gjykata vlerëson se edhe pretendimi i kërkuesit për të konstatuar papajtueshmërinë me Kushtetutën të vendimit nr. 48/2015 të Kuvendit, “Për mosdërgimin në Gjykatën Kushtetuese të çështjes për konstatimin e papajtueshmërisë me detyrën e deputetit të zotit Koço Kokëdhima”, është i bazuar dhe si i tillë duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 124 dhe 134/1/c të Kushtetutës, si dhe të neneve 71, 72 dhe 79 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
- Interpretimin e nenit 70/4 të Kushtetutës si vijon:

Në rast se Kuvendi i Shqipërisë vihet në lëvizje me mocion të kryetarit të Kuvendit ose një të dhjetës së anëtarëve të tij, në kuptim të pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës, ai duhet të vendosë dërgimin e çështjes në Gjykatën

Kushtetuese, e cila është organi i vetëm që ka kompetencën të shqyrtojë në themel çështjen dhe të vendosë mbi papajtueshmërinë e mandatit të deputetit.

- Konstatimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 48/2015 të Kuvendit të Shqipërisë, “Për mosdërgimin në Gjykatën Kushtetuese të çështjes për konstatimin e papajtueshmërisë me detyrën e deputetit të zotit Koço Kokëdhima”.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe ka fuqi prapavepruese.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Fatmir Hoxha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

Anëtar kundër: Sokol Berberi

MENDIM PAKICE

1. Në çështjen konkrete nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën lidhur me përfundimin e arritur për sa i përket interpretimit të pikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës, si dhe me argumentet mbi të cilat mbështetet ky qëndrim, ndaj e çmoj të rëndësishme të shprehem me mendim pakice. Jam dakord me shumicën vetëm në lidhje me legjitimitimin e kërkuesit për të kërkuar interpretimin e nenit 70 të Kushtetutës.

2. Nëpërmjet arsytimit të saj shumica ka arritur në përfundimin se për çdo shkelje të pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës, kur kërkohet konstatimi i papajtueshmërisë me mandatin e deputetit, Kuvendi është i detyruar ta dërgojë çështjen në Gjykatën Kushtetuese, e cila është organi i vetëm që ka kompetencën ta shqyrtojë në themel çështjen. Në raste të tilla hapësira e vlerësimit të Kuvendit lidhet vetëm me verifikimin e kritereve juridiko-formale, duke respektuar procedurat parlamentare të parashikuara në Rregulloren e këtij organi (§ 32 i vendimit).

3. Përpara se të shpjegoj qëndrimin tim në lidhje me interpretimin e pikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës, e çmoj të nevojshme të paraqes disa vlerësime të përgjithshme mbi argumentet që ka përdorur shumica për të arritur në konkluzionin e mësipërm.

4. Së pari, shumica nisat nga një premisë e gabuar, duke e konsideruar vendimmarrjen e



Kuvendit, sipas pikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës, me natyrë politike. Kështu shumica është shprehur se *“përfaqshirja e Gjykatës Kushtetuese në këtë proces është bërë për të eliminuar një vendimarrje me natyrë politike nga ana e Kuvendit. Vënia në lëvizje e gjyqimit kushtetues vetëm për rastin e verifikimit të papajtueshmërisë, sipas pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës, konsiderohet një instrument kontrolli ndaj pushtetit ligjvënës që kërkon gjykim, gjë që del jashtë tagrave dhe mundësive të Kuvendit (§ 27 i vendimit). Nëse do të pranohej një pushtet i tillë i pakufizuar i Kuvendit, atëherë parashikimi kushtetues do të zbrishej nga qëllimi i tij, çka do të përbente një abuzim me pushtetin e shumicës dhe do të ishte në kundërshtim me parimin e ndarjes dhe të balancimit ndërmjet pushteteve” (§ 31 i vendimit).* Kuvendi, ndryshe nga premisa mbi të cilën bazohet shumica, ngarkohet nga Kushtetuta për të ushtruar disa funksione. Është e qartë se funksioni ligjvënës dhe funksioni kontrollues ndaj qeverisë janë me natyrë politike dhe Kuvendi i ushtron ato si organ përfaqësues i sovranitetit të popullit. Përveç funksioneve klasike, ky institucion ushtron edhe disa funksione të cilat nuk konsiderohen me natyrë politike. Në rastet kur Kuvendi, sipas Kushtetutës, kontrollon përgjegjshmërinë e Presidentit të Republikës (neni 90), të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese (neni 128), të anëtarëve të Gjykatës së Lartë (140), të Prokurorit të Përgjithshëm (neni 149), ky organ nuk vepron si organ politik, por si një organ i procedimit disiplinor. Edhe pika 4 e nenit 70 të Kushtetutës e ngarkon Kuvendin me përgjegjësinë e organit të procedimit disiplinor. Për këtë arsye, shumica duhej të nisej nga prezumimi se Kuvendi, si një organ kushtetues që gëzon mirëbesimin publik, në ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të tij, zbaton Kushtetutën dhe parimet që rrjedhin prej saj. Parimi i luajalitetit kushtetues, i elaboruar nga jurisprudenca e Gjykatës, shpreh respektin e ndërsjelltë që secili nga organet kushtetuese duhet të ketë ndaj organeve të tjera dhe kompetencave të tyre (*shih vendimin nr. 24, datë 9.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin konkret, Kuvendi, gjatë ushtrimit të kompetencave të tij të parashikuara në pikën 4 të nenit 70 të Kushtetutës, ka marrë një vendim duke u mbështetur në interpretimin që vetë ai i ka bërë normës kushtetuese. Papajtueshmëria me mandatin e deputetit është një çështje që hyn në

sferën parlamentare dhe është një element i natyrshëm i së drejtës parlamentare, çka mbështetet edhe nga doktrina juridike kushtetuese (*shih Raportin e Komisionit të Venecias CDL-AD (2012) 027, datë 31.1.2013, §83; §109; §112*). Rrjedhimisht, Kuvendi si organ kushtetues që përfaqëson një pushtet të caktuar, në frymën e parimit të autonomisë dhe vetërregullimit, brenda kufijve kushtetues, ka një rol vendimarrës në procedurën e konstatimit të papajtueshmërisë me mandatin të anëtarëve të vet, siç është përcaktuar nga Kushtetuta në pikën 4 të nenit 70 të saj.

5. Së dyti, shumica, me qëndrimin e saj, është përpjekur të evidentojë ekskluzivitetin vendimarrës që Gjykata ka në proces, duke e reduktuar rolin e Kuvendit në një rol krejtësisht formal. Ndryshe nga shumica vlerësoj se Gjykata, si rregull, është një organ që ka funksion rishikues, si dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës (neni 124 i Kushtetutës). Ajo nuk bën vlerësimin fillestar të çështjes në themel, por kontrollon, në aspektin kushtetues, vendimarrjen e institucioneve kushtetuese pasi këto janë shprehur. Në këtë kuptim edhe në rastin konkret ajo rishikon vendimarrjen e Kuvendit, sipas pikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës, pasi Kuvendi ka marrë vendimin t’ia dërgojë çështjen për konstatimin e papajtueshmërisë.

6. Së treti, vërej se shumica, megjithëse gjatë arsyetimit shprehet se është bazuar në interpretimin literal, sistematik dhe teleologjik, nuk ka shpjeguar se si i ka zbatuar dhe përdorur konkretisht këto metoda interpretuese (§ 27 i vendimit). Nëse Gjykata u referohet në vendim metodave të interpretimit kushtetues/juridik, ajo është e detyruar të elaborojë në mënyrë të qartë dhe logjike zbatimin e këtyre metodave interpretuese në rastin konkret, për të mbështetur më pas konkluzionet e saj. Kjo merr akoma më tepër rëndësi në aspektin e përmbushjes së kriterëve dhe respektimin e garancive të arsyetimit të vendimit gjyqësor, të cilat vetë Gjykata i ka përcaktuar në jurisprudencën e saj dhe është e detyruar t’i zbatojë. Konkluzioni i arritur nga shumica më shumë se sa mbështetet në argumente të kontrollit kushtetues, reflekton një qëndrim si të ishte në rolin e kushtetutëbërësit.



7. Së katërti, argumenti kryesor mbi të cilin bazohet konkluzioni i shumicës, është respektimi i të drejtave dhe garancive kushtetuese për pakicën parlamentare. Ajo, ndër të tjera, është shprehur se *“edhe pse brenda Parlamentit si rregull pakica nuk ka kompetencën për të marrë vendime, funksioni i saj është, mes të tjerash, përmirësimi i procedurës së vendimmarrjes politike, kontrolli i qeverisjes, si dhe rritja e stabilitetit, legjitimitetit dhe përgjegjësisë e transparencës në proceset politike (...) Gjykata vlerëson se kushtetutëbërësi e ka ngritur në nivel kushtetues të drejtën e pakicës parlamentare (në këtë rast një e dhjeta e deputetëve) për të kërkuar vënien në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese, si shprehje të ushtrimit të pushtetit të saj kontrollues ndaj shumicës parlamentare. Duke i dhënë asaj një mbrojtje kushtetuese kushtetutëbërësi ka evituar ndërhyrjen e shumicës në ushtrimin e kësaj të drejte, si dhe diskrecionin e shumicës në interpretimin dhe vlerësimin e saj rast pas rasti”* (§ 28-29 të vendimit). Vënien e theksit të të drejtat dhe garancitë kushtetuese të pakicës parlamentare, referuar në jurisprudencën kushtetuese përkatëse, e çmoj të pavend dhe jashtë kontekstit të gjykimit kushtetues abstrakt të çështjes së shtruar përpara Gjykatës. Gjykata këtë jurisprudencë e ka zhvilluar kryesisht në funksion të interpretimit të nenit 77/2 të Kushtetutës, lidhur me të drejtën e një të katërtës së anëtarëve të Kuvendit për ngritjen e një komisioni hetimor për të shqyrtuar një çështje të caktuar. Rasti konkret që është shtruar përpara Gjykatës, siç është përmendur më sipër, lidhet me verifikimin e papajftueshmërisë me mandatin e deputetit dhe në kuptim të interpretimit abstrakt nuk është e rëndësishme nëse deputeti ndaj të cilit pretendohet se ka shkelur pikën 3 të nenit 70 të Kushtetutës i përket pakicës apo shumicës parlamentare. Për më tepër, mendoj se interpretimi që shumica i ka bërë pikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës, duke e konsideruar rolin e Kuvendit si formal në këtë proces, në fakt ka dobësuar rolin e opozitës në veprimtarinë parlamentare, sepse i ka hequr mundësinë asaj për të debatuar si në komisionin përkatës, ashtu dhe në seancën plenare. Në lidhje me këtë argument do të jap shpjegime në mënyrë më të zgjeruar më poshtë.

8. Së pesti, vërej se referencat në precedentët e Gjykatës të përdorura nga shumica, nuk i përmbahen saktësisht tekstit të vendimeve të

mëparshme të Gjykatës. Fillimisht, shumica ka arsyetuar se verifikimi dhe vlerësimi i kritereve juridiko-formale të kërkesave të kësaj natyre i përket Kuvendit, ndërsa vlerësimi i meritës së çështjes, pra nëse me veprimet e tij deputeti ka shkelur ndalimin kushtetues të pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës, është një çështje që i përket ekskluzivisht Gjykatës Kushtetuese. Më pas, ajo është shprehur se një përfundim i tillë gjen mbështetje edhe në jurisprudencën e kësaj Gjykate, e cila ka theksuar edhe më parë se është organi i vetëm që ka kompetencën të vendosë nëse veprimet konkrete të një anëtarit të Parlamentit, kundër të cilit është iniciuar procedura për konstatimin e papajftueshmërisë me mandatin, janë në kundërshtim me Kushtetutën. Ky përfundim nuk gjendet i pasqyruar në tekstet e vendimeve të cituara nga shumica, përkatësisht vendimet nr. 29, datë 30.6.2011 dhe nr. 44, datë 7.10.2011 të Gjykatës Kushtetuese. Nga leximi integral i këtyre vendimeve vërehet se: *“(…) bazuar në nenin 70, pika 4, të Kushtetutës, konstatimi i papajftueshmërisë me mandatin e deputetit është në kompetencën e kësaj Gjykate. Kjo normë ka përcaktuar Kuvendin si subjekt të posaçëm që vë në lëvizje këtë gjykim kushtetues, si dhe subjektet që iniciojnë procedurat parlamentare për këtë qëllim (Kryetari i Kuvendit ose një e dhjeta e anëtarëve të tij) (§ 18 i vendimit nr. 29, datë 30.6.2011 dhe § 9 i vendimit nr. 44, datë 7.10.2011).* Në asnjërin prej këtyre vendimeve nuk është theksuar tekstualisht se Gjykata është organi i vetëm që vendos për themelin e çështjes, pra nëse veprimet konkrete të një anëtarit të Parlamentit, kundër të cilit është iniciuar procedura për konstatimin e papajftueshmërisë me mandatin, janë në kundërshtim me Kushtetutën.

9. Në vlerësimin tim, kuptimi i ikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës është ky: Kuvendi vihet në lëvizje për shkelje të pikës 3 të nenit 70; Kuvendi vihet në lëvizje nga Kryetari i Kuvendit ose një e dhjeta e anëtarëve të tij; Kuvendi vendos për shkeljen e pikës 3 të nenit 70 dhe, për rrjedhojë, dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese; Gjykata Kushtetuese konstaton papajftueshmërinë. Kuvendi nuk ka rol formal dhe nuk është i detyruar ta dërgojë në çdo rast për shqyrtim çështjen në Gjykatën Kushtetuese.



Vendimi i Kuvendit që ka verifikuar shkeljen e pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës nga ana e deputetit, ndaj të cilit është kërkuar procedimi, detyrimisht i dërgohet Gjykatës Kushtetuese. Këtë konkluzion e bazoj në argumentet në vijim, duke u mbështetur në interpretimin literal, historik, teleologjik dhe sistematik të pikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës.

10. Neni 70 i Kushtetutës, në paragrafët 3 dhe 4, parashikon se “(...) 3. *Deputetët nuk mund të kryejnë asnjë veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor dhe as të fitojnë pasuri të këtyre.* 4. *Për çdo shkelje të paragrafit 3 të këtij neni, me mocion të kryetarit të Kuvendit ose të një së dhjetës së anëtarëve të tij, Kuvendi vendos për dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese, e cila konstaton papajtueshmërinë*”. Norma e përcaktuar në pikën 4 të nenit 70 të Kushtetutës parashikon procedurën për iniciimin, shqyrtimin dhe vendimmarrjen për pretendimet që lidhen me shkeljen e pikës 3 të po të njëjtit nen. Pasoja që parashikon kjo dispozitë është “konstatimi i papajtueshmërisë”, që në thelb sjell shkarkimin e deputetit dhe mbarimin e mandatit sipas nenit 71/2/c të Kushtetutës. Ardhja e kësaj pasoje është e kushtëzuar nga përmbushja e katër elementeve: a) Kuvendi vihet në lëvizje për shkeljen e pikës 3 të nenit 70; b) Kuvendi vihet në lëvizje nga Kryetari i Kuvendit ose një e dhjeta e anëtarëve të tij; c) Kuvendi vendos për shkeljen e pikës 3 të nenit 70 dhe, për rrjedhojë, dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese; ç) Gjykata Kushtetuese konstaton papajtueshmërinë. Shprehja “për çdo shkelje të paragrafit 3 të këtij neni”, e vendosur në fillim të fjalisë, nënkupton se pretendimi për shkelje duhet të jetë verifikuar dhe kjo të jetë arritur me vendim të Kuvendit. Kushtetutëbërësi ka përdorur termat “vendos”, “mocion” dhe “konstaton”, të cilat kanë domethënie të caktuara në gjuhën kushtetuese dhe në të drejtën parlamentare. Termi “vendos”, në kuptim të procedurave parlamentare, nënkupton se duhet të ketë një procedurë shqyrtimi dhe në fund të shqyrtimit të ketë një proces votimi, ku deputetët janë të lirë të shprehin vullnetin e tyre për çështjen që shtrohet për votim. Nëse nuk ka çështje të shtruar për votim, është absurde të mendosh se duhet të ketë vendim. Në rast se kushtetutëbërësi do të kishte qëllim t’i jepte Kuvendit një rol formal në këtë

proces, do të kishte shmangur termin “vendos”, siç ka bërë në raste të tjera. Detyrimi që imponon pika 4 e nenit 70 të Kushtetutës për marrjen e një vendimi për shkeljen e pikës 3 të po të njëjtit nen, është pohuar edhe nga jurisprudenca e kësaj Gjykate, e cila në vendimin nr. 44, datë 7.10.2011, përpara se të konstatonte papajtueshmërinë, ka shqyrtuar vlefshmërinë e vendimit të Kuvendit për t’ia dërguar çështjen Gjykatës Kushtetuese. Sipas “Fjalorit të gjuhës shqipe”¹ termi “vendos” do të thotë: caktoj përfundimisht diçka; bëj të mundshëm zhvillimin e mëtejshëm të diçkaje, ndikoj shumë në përfundimin e diçkaje; arrij të zgjidh një çështje a të përfundoj një punë, pasi e kam menduar mirë, e kam shqyrtuar ose e kam rrahur me të tjerë; i gjej zgjidhje një çështjeje. Ndërsa sipas “Fjalorit juridik”² termi “vendos” nënkupton pushtetin dhe të drejtën për të diskutuar, peshuar argumentet pro dhe kundër, për të parë cili prevalon dhe të udhëhequrit nga kjo prevalencë.

11. Shumica është shprehur se “Kuvendi nuk mund të vërë në diskutim mocionin e paraqitur dhe nuk mund t’ia nënshtrojë atë debatit parlamentar, por vendimmarrja e tij si organ kolegjial është e domosdoshme me qëllim vënien në lëvizje të kësaj Gjykate për t’u shprehur për themelin e çështjes, për sa kohë që pa një vendim të shumicës parlamentare Gjykata nuk mund të shqyrtojë kërkesa të tilla.” (§ 30 i vendimit). Ky qëndrim i shumicës ka një kontradiksion në vetvete dhe shpreh një keqkuptim për instrumentin e *mocionit*, si dhe vendimmarrjen parlamentare. Termi “mocion” në të drejtën parlamentare është një instrument për vënien në lëvizje të Parlamentit dhe kërkon në mënyrë të natyrshme shqyrtim, debat parlamentar dhe vendim nëpërmjet votimit.

12. Kushtetutëbërësi, duke parashikuar dërgimin në Gjykatën Kushtetuese të vendimit të Kuvendit që ka verifikuar shkeljen e pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës, ka përjashtuar rastin sipas të cilit Kuvendi do të ishte i detyruar që t’ia dërgonte çështjen Gjykatës Kushtetuese edhe kur ai vendos për mosverifikimin e shkeljes (*expressio unius est exclusio alterius*). Termi “konstaton” nënkupton që Gjykata Kushtetuese ka kompetencë konstatuese të shkeljes, e cila është

¹ <http://www.fjalori.shkenca.org/>

² Black’s Law Dictionary



verifikuar më parë. Sipas “Fjalorit të gjuhës shqipe” termi “konstatoj” do të thotë: vë re a diktoj një fakt, një gabim etj.; vërtetoj të qenët a gjendjen e diçkaje. Ndërsa sipas “Fjalorit juridik” termi “konstatoj” do të thotë: të bësh të sigurt ose të përcaktuar diçka; të heqësh çdo dyshim ose paqartësi nga një çështje. A do të kishte kuptim nga pikëpamja literale përdorimi i termit “konstaton” nëse Kuvendi do të ishte i detyruar t’ia dërgonte Gjykatës çdo çështje të këtij lloji, pavarësisht bindjes së tij në vendim për mosverifikimin e shkëljes? Unë çmoj që jo sepse sipas kësaj logjike Gjykata do të *konstatonte mosshkeljen* e pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës.

13. Edhe ligji organik i Gjykatës Kushtetuese ka parashikuar rregullime që vijnë në harmoni me kuptimin e dhënë më sipër të pikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës. Kështu, në pikën 3 të nenit 66 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” parashikohet se: “kërkesa për papajtueshmëri mund të paraqitet në Gjykatën Kushtetuese nga Kuvendi, për sa kohë vazhdon mandati i deputetit, ndërsa kërkesa për shqyrtimin e zgjedhshmërisë së deputetëve mund të paraqitet brenda 6 muajve nga konstatimi i faktit të pazgjedhshmërisë”. Pra, formulimi i kësaj dispozite nuk kërkon detyrimisht që kërkesa nga ana e Kuvendit të paraqitet në Gjykatën Kushtetuese. Çka lë të nënkuptohet se Kuvendi duhet të marrë vendim fillimisht për verifikimin e shkëljes dhe më pas çështja i dërgohet Gjykatës.

14. Kundër analizës së mësipërme, për kuptimin literal të pikës 4 të nenit 70, si kundërgargument mund të pretendohet se kushtetutëbërësi mund të ishte shprehur më qartë dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë se Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje vetëm në rastin kur Kuvendi vendos për verifikimin e shkëljes së pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës. Edhe nëse do të pranojmë se formulimi i pikës 4 të nenit 70 ka një farë dykuptimesie, për të mbështetur kuptimin që unë i jap kësaj dispozite referohem edhe në interpretimin historik, teleologjik dhe sistematik.

15. Bazuar në interpretimin historik, konkretisht në “Debati Kushtetues” (vëllimi I, f. 262), vërehet se kushtetutëbërësi ka pasur si qëllim përfshirjen e dy organeve – Kuvendit dhe

Gjykatës Kushtetuese - në procedurën e heqjes së mandatit të deputetit si pasojë e konstatimit të rasteve të papajtueshmërisë. Nga këto diskutime del e qartë se Kuvendi merr vendim për dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese. Për pyetjen që është shtruar gjatë diskutimit për këtë çështje, se “kush vendos përfundimisht për mandatin”, përgjigjja ka qenë “Parlamenti”, dhe ky pohim nuk është kundërshtuar. Sipas kuptimit që i ka dhënë shumica pikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës, roli i Kuvendit në këto lloj çështjesh është formal dhe Gjykata Kushtetuese është organi i vetëm që ka kompetencën për të shqyrtuar në themel për papajtueshmërinë e mandatit të deputetit. Pas konstatimit të papajtueshmërisë nga ana e Gjykatës Kushtetuese, mandati i deputetit, *ipso jure*, quhet i mbaruar, sipas nenit 71, pika 2, shkronja “c”. Pra, sipas interpretimit të shumicës, Kuvendi nuk ka ndonjë rol thelbësor për çështjen e heqjes/mbarimit të mandatit. Ky qëndrim, siç del nga *Debati Kushtetues*, i referuar më lart, nuk është në harmoni me frymën dhe synimin e kushtetutëbërësit.

16. Nisur nga këndvështrimi sistematik i rregullimeve kushtetuese, Kuvendi, ndryshe nga premisa mbi të cilën bazohet shumica, ngarkohet nga Kushtetuta për të ushtruar disa funksione. Siç është përmendur më sipër, në rastet kur Kuvendi thirret nga Kushtetuta për të kontrolluar përgjegjshmërinë e Presidentit të Republikës (neni 90), të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese (neni 128), të anëtarëve të Gjykatës së Lartë (neni 140), të Prokurorit të Përgjithshëm (neni 149), ky organ nuk vepron si organ politik, por si një organ i procedimit disiplinor. Për ushtrimin e këtyre kompetencave Kuvendi duhet të respektojë elementet e procesit të rregullt, siç është theksuar edhe nga jurisprudenca e Gjykatës (*shih vendimet nr. 12, datë 20.5.2008; nr. 21, datë 1.10.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Në të gjitha këto raste Kuvendi nuk ka një rol formal, por shqyrton themelin e çështjes. Në dispozitat përkatëse janë parashikuar procedurat për vënien në lëvizje të Kuvendit, propozuesit dhe vendimmarrjet e kërkuara për çdo rast. Kur nuk arrihet të merret vendim me shumicën e kërkuar, çështja nuk mund të kalojë për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese. Nëse do të niseshim nga premisa se Kuvendi është organ politik, atëherë



edhe për këto raste mund të gjykohet se çështja duhet t'i kalojë Gjykatës Kushtetuese, sepse vetëm në këtë mënyrë do të garantoheshin të drejtat e subjekteve parlamentare që kanë vënë në lëvizje procedurën e shkarkimit. Por kushtetutëbërësi nuk është nisur nga premisa mbi të cilën bazohet shumica. Në çështjen konkrete Kuvendi, sipas pikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës, vepron si një organ disiplinor dhe nuk niset nga motivime politike. Siç është theksuar në jurisprudencën e kësaj Gjykate, çdo dispozitë e Kushtetutës duhet të interpretohet në mënyrë që të jetë e pajtueshme me parimet themelore kushtetuese. Kjo për arsye se të gjitha normat dhe parimet kushtetuese formojnë një sistem harmonik. Natyra e Kushtetutës, koncepti i kushtetutshmërisë, nënkupton se Kushtetuta nuk mund të ketë kontradikta të brendshme. Për pasojë, asnjë dispozitë e Kushtetutës nuk mund të nxirret jashtë kontekstit të saj dhe të interpretohet më vete. Një nen i Kushtetutës duhet të interpretohet në kontekstin e Kushtetutës si një e tërë dhe jo i izoluar (*shih vendimet nr. 25, datë 24.9.2009; nr. 2, datë 19.1.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Argumenti i dhënë më sipër mund të kundërshtohet me pretendimin se çështjet që lidhen me zgjedhshmërinë dhe papajtueshmërinë me mandatin e deputetit Kushtetuta i ka parashikuar në kompetencat që i janë dhënë Gjykatës Kushtetuese për të vendosur sipas nenit 131/e të Kushtetutës. Edhe ky pretendim nuk do të rezultonte i mbështetur. Së pari, pika 4 e nenit 70 të Kushtetutës përbën një rregullim specifik dhe bazuar në rregullin interpretues, sipas të cilit norma specifike ka përparësi mbi normën e përgjithshme (*lex specialis derogat lex generalis; shih vendimin nr. 2/2010 të Gjykatës Kushtetuese*), ka përparësi mbi nenin 131/e, i cili përmban një dispozitë të përgjithshme ku listohen kompetencat e Gjykatës Kushtetuese. Së dyti, në nenin 131/dh parashikohet kompetenca e Gjykatës Kushtetuese edhe për të vendosur për “shkarkimin nga detyra të Presidentit të Republikës dhe vërtetimin e pamundësisë së ushtrimit të funksioneve të tij”. Leximi i këtij parashikimi nuk mund të shkëputet nga rregullimet specifike të neneve 90 dhe 91 të Kushtetutës, ku parashikohet respektivisht procedura për shkarkimin dhe vërtetimin e

pamundësisë të ushtrimit të funksioneve të Presidentit. Kjo do të thotë që pavarësisht se Kushtetuta e ngarkon Gjykatën Kushtetuese me përgjegjësinë për të vendosur për shkarkimin e Presidentit të Republikës, ajo e ushtron këtë kompetencë pasi të ketë marrë vendim Kuvendi me dy të tretat, sipas parashikimeve të nenit 90 të Kushtetutës. Kuvendi edhe në këtë rast nuk ka një funksion formal, por vlerëson edhe meritën.

18. Pra, nga analiza sistematike e rregullimeve kushtetuese evidentohen dy aspekte: i) Kuvendi, në rastet kur Kushtetuta e ngarkon me funksionin e organit disiplinor për të kontrolluar përgjegjshmërinë e organeve dhe subjekteve të caktuara kushtetuese, nuk ka funksion formal, por vlerëson edhe meritën; ii) në këto raste, Gjykata Kushtetuese ka një funksion rishikues, jo fillestar dhe vlerëson si aspektet formale, ashtu dhe meritën e çështjes. Për më tepër, edhe Rregullorja e Kuvendit, në çështjet që lidhen me mandatin e deputetit, nuk e përcakton rolin e Kuvendit si formal. Në Rregullore është parashikuar se Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin (Këshilli) shqyrton të gjitha çështjet që lidhen me mandatin e deputetit dhe paraqet raportin përkatës në seancë plenare (neni 13); Komisioni i Përkohshëm për Verifikimin e Mandateve shqyrton dokumentacionin përkatës të zgjedhjeve dhe brenda 2 ditëve i paraqet Kuvendit në seancë plenare raportin për vlefshmërinë e mandateve të deputetëve të Kuvendit. Në rast se Komisioni vëren paligjshmëri në zgjedhje, i propozon Kuvendit dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese (neni 3); në përfundim të shqyrtimit të kërkesës për heqjen e imunitetit të deputetit, Këshilli, brenda 4 javëve, harton një raport për në seancë plenare, në të cilin rekomandon rrëzimin ose miratimin e dhënies së autorizimit për masën e sigurimit me arrest në burg ndaj deputetit (118). Nëse Kuvendi nuk e jep autorizimin, ky vendim nuk mund të kontrollohet nga Gjykata (*shih mendimin paralel në vendimin nr. 75, datë 22.12.2015 të Gjykatës Kushtetuese, i cili i referohet edhe vendimit Kart kundër Turqisë (2009) të GJEDNJ-së*). Në të gjitha këto raste të parashikuara në Rregullore, Kuvendi bën një vlerësim jo formal të çështjeve që lidhen me mandatin e anëtarëve të tij.

19. Sipas shumicës, qëllimi i kushtetutëbërësit për përfshirjen e Gjykatës Kushtetuese në



procesin e konstatimit të papajtueshmërisë, sipas pikës 4 të nenit 70, *“është bërë për të eliminuar një vendimarrje me natyrë politike nga ana e Kuvendit”*. Në vijim të këtij qëndrimi shumica shprehet se *“nëse do të pranohet një pushtet i tillë i pakufizuar i Kuvendit, atëherë parashikimi kushtetues do të zhvishet nga qëllimi i tij, çka do të përbënte një abuzim me pushtetin e shumicës dhe do të ishte në kundërshtim me parimin e ndarjes dhe të balancimit ndërmjet pushteteve”*(§ 27 dhe 31 të vendimit). Në thelb, qëndrimi i shumicës shpreh paragjykimin se shumica parlamentare, në çdo rast, për çështje që lidhen me papajtueshmërinë me mandatin e deputetit, kur kërkohet verifikimi i shkeljes për anëtarë të kësaj shumice, do të marrë vendim nisur nga motive politike, duke mos verifikuar në mënyrë objektive nëse deputeti ka shkelur apo jo detyrimet që rrjedhin nga pika 3 e nenit 70 të Kushtetutës. Shumica nuk tregon se si ka arritur në këtë konkluzion dhe burimet autoritare të cilat është mbështetur. Siç u argumentua më sipër, *Debatë Kushtetues* dhe vështrimi sistematik i Kushtetutës nuk e mbështesin këtë qëndrim të shumicës.

20. Për kontrollin dhe zbatimin e detyrimit që përcakton pika 3 e nenit 70 për deputetin, kushtetutëbërësi, në pikën 4 të këtij neni, ka vendosur një mekanizëm, i cili reflekton balancën ndërmjet interesit kushtetues për shmangien e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetit dhe mbrojtjes së mandatit të deputetit nga cenimi dhe shkarkimi i padrejtë. Kjo balancë garantohet nëpërmjet procedurave parlamentare për iniciimin e procesit, shqyrtimin e mocionit dhe vendimarrjen. Nëse Kryetari i Kuvendit ose një e dhjeta e anëtarëve të tij paraqesin një mocion ndaj një deputeti, pavarësisht nga përkatësia e këtij deputeti në grupin politik parlamentar, Kuvendi është i detyruar ta marrë në shqyrtim, fillimisht nëpërmjet komisionit parlamentar përkatës për mandatet, dhe më pas në seancë plenare. Në këtë proces, si subjekti që ka paraqitur mocionin, ashtu dhe deputeti ndaj të cilit pretendohet shkelja duhet të kenë mundësi për t'u dëgjuar, për të paraqitur provat, për t'i kundërshtuar dhe debatuar ato. Në këtë kuptim, Kuvendi, në funksion të rolit të tij si organ i procedimit disiplinor, duhet të respektojë kërkesat që imponon një proces i rregullt ligjor, siç janë evidentuar nga jurisprudenca e Gjykatës

Kushtetuese. Nëse Kuvendi nëpërmjet vendimarrjes verifikon shkeljen e pikës 3, të nenit 70 nga ana e deputetit ndaj të cilit pretendohet kjo shkelje, ky vendim detyrimisht i kalon Gjykatës Kushtetuese për konstatimin e shkeljes. Dërgimi i çështjes në Gjykatën Kushtetuese në këtë rast nuk i nënshtrohet vullnetit të Kuvendit, por është *ipso jure*, detyrim që rrjedh nga Kushtetuta, si pasojë e marrjes së vendimit nga ana e Kuvendit për verifikimin e shkeljes. Vendimi i Kuvendit, sipas pikës 4 të nenit 70 sjell si pasojë plotësimin e njërit prej kushteve për mbarimin e mandatit të deputetit. Deputeti është mbajtës i mandatit të lirë, i besimit të shprehur të zgjedhësit me anë të votës për ta përfaqësuar atë gjatë gjithë periudhës që zgjat legjislatura. Duke pasur parasysh këtë pasojë të rëndë mbi mandatin përfaqësues të deputetit, kushtetutëbërësi, ndryshe nga premisa mbi të cilën mbështetet shumica, ka përfshirë Gjykatën Kushtetuese si garanci në këtë mekanizëm për mbrojtjen e mandatit të deputetit nga cenime të padrejta. Këtë synim kushtetutëbërësi e ka reflektuar edhe në mekanizmat për shkarkimin e disa organeve kushtetuese apo anëtarëve të tyre, siç u shpjegua edhe më lart. Kjo garanci merr rëndësi të veçantë sidomos në rastet kur deputeti, mandati i të cilit rrezikohet të hiqet, i përket pakicës parlamentare.

21. Në rastin kur Kuvendi vendos se nuk ka shkelje të pikës 3 të nenit 70, sipas kuptimit të pikës 4 të nenit 70, çështja nuk i kalon Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në arsyet e dhëna më lart, kushtetutëbërësi ka bërë një dallim ndërmjet pasojave të ndryshme që vijnë nga vendimi i Kuvendit, në rastin kur verifikon shkeljen (papajtueshmërinë), nga rasti kur ai nuk e konsideron si shkelje, duke vendosur një garanci më shumë kur rrezikohet heqja e mandatit. Shumica, duke u nisur nga një premisë e gabuar kushtetuese, sipas të cilës Kuvendi si organ politik është i “paafte” për të përmbushur detyrimin që cakton pika 3 e nenit 70 të Kushtetutës, i ka dhënë një kuptim të pabazuar pikës 4 të nenit 70. Për më tepër, siç u përmend edhe më lart, me një argument të pavend dhe jashtë kontekstit të gjykimit kushtetues të çështjes së shtruar përpara Gjykatës, shprehet se *“në rast se do të pranohet një interpretim i ndryshëm i kësaj norme, atëherë pakica parlamentare do të*



diskriminohet në raport me shumicën parlamentare, për sa kohë që ushtrimi i së drejtës së saj kushtetuese, i garantuar në pikën 4 të nenit 70 të Kushtetutës, do të ishte në diskrecionin e kësaj të fundit (§ 31 i vendimit).

22. Neni 70 i Kushtetutës vendos detyrime për deputetet dhe Kuvendin si organ kolegjal, të cilat synojnë shmangien e papajtueshmërisë me mandatin e deputetit dhe përfaqësimin e popullit në mënyrë të lirë dhe me mirëbesim. Çdo deputet përpara fillimit të ushtrimit të mandatit bën betimin për respektimin e Kushtetutës dhe të ligjeve. Deputeti mban përgjegjësi politike përpara zgjedhësve dhe forcës politike përkatëse që e ka mbështetur. Nëse ai nuk përmbush detyrimet që rrjedhin nga mandati, për të cilat është betuar, rrezikon të mos e rifitojë sërish mandatin e deputetit. Për shkelje të etikës parlamentare deputeti mban përgjegjësi sipas rregullave të caktuara nga vetë deputetët në mënyrë kolegjiale. Gjithashtu, përveç përgjegjësisë politike dhe etike, deputeti, si çdo qytetar tjetër, mban përgjegjësi civile dhe penale.

23. Sipas pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës, deputetët nuk mund të kryejnë asnjë veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor dhe as të fitojnë pasuri të këtyre. Deputeti është i detyruar të marrë masa për të respektuar këtë detyrim kushtetues dhe për të shmangur çdo marrëdhënie që do të cenonte respektimin e këtij detyrimi. Nëse ka pretendime se ai nuk e ka përmbushur këtë detyrim, pika 4 e nenit 70 të Kushtetutës parashikon një proces kontrollues, fillimisht në Kuvend dhe më pas në Gjykatën Kushtetuese. Kur Kuvendi me vendimmarrjen e tij verifikon shkeljen e pikës 3 të nenit 70 dhe kjo shkelje konstatohet nga Gjykata Kushtetuese, deputetit ndaj të cilit pretendohet shkelja i hiqet mandati. Në rastin kur Kuvendi, sipas pikës 4 të nenit 70, nuk vendos se ka shkelje dhe çështja nuk i kalon Gjykatës Kushtetuese, deputeti dhe Kuvendi (shumica parlamentare) nuk shmangen nga përgjegjësia politike. Përveç përgjegjësisë politike, siç u përmend edhe më lart, deputeti, nëse vërtetohet se ai ka ndërhyrë dhe ka ndikuar në mënyrë joligjore për të përfutur nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor, mund të vihet përpara përgjegjësisë penale dhe procedimi penal nuk është i ndërvarur nga fakti nëse është konstatuar papajtueshmëria apo jo nga Kuvendi dhe Gjykata Kushtetuese. Gjithashtu, kontratat

dhe marrëveshjet sipas të cilave është përfutur pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor nga ana e deputetit, në shkelje të detyrimeve ligjore dhe kushtetuese, mund të kontestohen si kontrata absolutisht të pavlefshme në gjykimin administrativ.

24. Në mbështetje të argumenteve të mësipërme sjell edhe përvojën e vendeve të tjera demokratike, lidhur me mekanizmat rregullues të kësaj çështjeje. Rregullimet kushtetuese dhe ligjore në këto vende për shmangien e konfliktit të interesave dhe papajtueshmërisë me mandatin e deputetit tregojnë disa karakteristika dhe tipare të përbashkëta. Konkretisht, nga vështrimi krahasues rezulton se: a) Parlamenti nuk ka një rol formal kur bëhet fjalë për çështjet e papajtueshmërisë me mandatin e deputetit (*shih rregullimet kushtetuese e ligjore, si dhe rregulloret parlamentare në Francë³; Austri⁴; Belgjikë⁵; Itali⁶; Lituanë⁷; Sllovaki⁸; Hungari⁹*); b) Parlamenti, si

³ *Shih Raportin e Komisionit të Venecias CDL-AD (2012) 027, datë 31.1.2013, prg. 93.* Në Francë Byroja e Asamblesë bën kontrollin e veprimtarive që janë të papajtueshme me mandatin e deputetit. Deputetët bëjnë deklaratimet e detyrueshme përpara Byrosë e cila shqyrton deklaratat. Ligji parlamentar i jep një periudhë prej 15 ditësh deputetit për të vendosur cilin funksion do të mbajë. Nëse ai nuk e bën këtë brenda këtij afati, mandati i tij pushon.

⁴ https://www.parlament.gv.at/ENGL/PERK/RGES/GO/BR/gog01_P1-5.shtml. Sipas nenit 3 të Rregullores së Parlamentit *Austriak*, nëse Kryetari i Parlamentit informohet për shkaqe ligjore të vlefshme për të cilat një deputet mund të humbasë mandatin, ai ia kalon për shqyrtim çështjen Komisionit parlamentar përkatës, i cili përcakton nëse ekzistojnë kushtet ligjore për humbjen e mandatit dhe për gatit një mocion.

⁵ *shih Raportin e Komisionit të Venecias CDL-AD (2012) 027, datë 31.1.2013, prg. 94.* Në Belgjikë u takon vetë anëtarëve të Parlamentit të verifikojnë papajtueshmërinë dhe të zgjedhin cilin funksion do të mbajnë.

⁶ Neni 17 i Rregullores së Dhomës së Deputetëve; neni 87 i D.P.R. 30 mars 1957, n. 361. Në Itali një komision i posaçëm (*Giunta delle Elezioni*) ka kompetencën të verifikojë mungesën e rasteve të papajtueshmërisë me mandatin e deputetit. Vendimet e tij *ky komision* ia referon Asamblesë Parlamentare, e cila, sipas Kushtetutës Italiane ka kompetencën ekskluzive të vendosë sipas rastit në lidhje me mandatin.

⁷ <http://www.legislationline.org/download/action/download/id/838/file/1d3069e22bf427292ff15e253dd9.htm/preview>. Në rastin e Lituanisë procedura për heqjen e mandatit mund të nisë vetëm me propozim (iniciativë) të anëtarëve të Parlamentit. Për këtë qëllim ngrihet një Komision special hetimor për të hetuar mbi shkeljen.



rregull, përfshihet në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me mandatin e deputetit (*shih, përveç vendeve të përmendura në pikën "a", Shtetet e Bashkuara të Amerikës¹⁰ dhe Anglinë¹¹*); c) Në rastet kur përfshihet kontrolli kushtetues, kjo synon të garantojë, si shkallë e dytë, mbrojtjen e mandatit të deputetit dhe procesin e rregullt të procedurës

së papajtueshmërisë me mandatin (shih rastin e Francës¹²; Lituanisë¹³; Sllovakisë¹⁴ dhe Austrisë¹⁵).

25. Si përfundim, në çështjen konkrete vlerësoj se interpretimi i pikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës duhej të bëhej nga shumica në linjë e arsyetimit të mësipërm.

Anëtar: Sokol Berberi

VENDIM

Nr. 8, datë 26.2.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	"	"
Sokol Berberi	anëtar i	"	"
Vitore Tusha	anëtare e	"	"
Altina Xhoxhaj	anëtare e	"	"
Gani Dizdari	anëtar i	"	"
Besnik Imeraj	anëtar i	"	"
Fatos Lulo	anëtar i	"	"
Fatmir Hoxha	anëtar i	"	"

⁸ Në Sllovaki, sipas Rregullores së Parlamentit, një komision i veçantë parlamentar vendos mbi papajtueshmërinë me mandatin e deputetit. Ky komision ka kompetenca shqyrtuese dhe kontrolluese, pasi vërteton nëse deputeti ka shkelur detyrimet e parashikuara me ligj. Ai i paraqet Parlamentit një vendim të arsyetuar që përmban deklarin e shkeljes. Parlamenti voton me 2/3-at e anëtarëve për të miratuar këtë vendim të Komisionit.

⁹<http://www-archiv.parlament.hu/hazszabaly/-resolution.htm>. Në Hungari Komisioni Parlamentar për Papajtueshmërinë dhe Imunitetin shqyrton rastet e papajtueshmërisë që i referohen nga Kryetari i Parlamentit. Pasi shqyrton rastin e papajtueshmërisë ky komision përgatit një propozim dhe ia referon Parlamentit, i cili pas diskutimit në seancë duhet të votojë me 2/3-at e anëtarëve të tij për deklarin e papajtueshmërisë (sipas nenit 4 të Kushtetutës).

¹⁰ Neni 1/5 i Kushtetutës. Në SHBA çdo dhomë gjykon mbi zgjedhjet, kthimet dhe kualifikimet e anëtarëve të saj, mund të përcaktojë rregullat e procedurës së saj, të ndëshkojë anëtarët e saj për sjellje të parregullt, si dhe me pëlqimin e dy të tretave (2/3), përjashtimin e anëtarit të saj. Nëse Komisioni i Etikës gjen se deklarimi i interesave nuk është bërë ose është i rremë, anëtar i dhomës mund të paditet civilisht në gjykatën e distriktit.

¹¹ Dhoma e Ulët, Manuali i Procedurës në Çështje Publike. Në Angli çdo anëtar i cili qëllimisht nuk arrin të paraqesë një deklaratë apo jep informacione të rreme, është fajtor për shpërfillje të Parlamentit. Ankesat ndaj një deputeti që nuk ka përmbushur detyrimet e tij, siç janë detyrimet në lidhje me regjistrimin ose bërjen të ditur të interesave financiare, duhet t'i adresohen me shkrim Komisionerit Parlamentar për Standardet (Komisioneri). Nëse Komisioneri bindet se provat në mbështetje të ankesës janë të mjaftueshme për të justifikuar çuarjen më tej të çështjes, ai i kërkon anëtarit t'i përgjigjet ankesës dhe pastaj kryen një hetim paraprak. Nëse pas hetimit ai vendos se nuk ka çështje *prima facie*, ai do të raportojë te Komisioni Parlamentar për Standardet (Komisioni). Nëse ai gjen se ka çështje *prima facie* ose se ankesa ngre çështje me rëndësi më të gjerë, ai do të raportojë faktet dhe konkluzionet te Komisioni, i cili i rekomandon Dhomës së Deputetëve nëse është e nevojshme të merren veprime të mëtejshme.

¹² Nenet L.O. 151-2 dhe L.O. 297 të Kodit Zgjedhor Francez. Këshilli Kushtetues mund investohet nga Byroja e Parlamentit nëse ka ndonjë dyshim apo kontestim në lidhje me përshtatshmërinë e funksioneve apo aktiviteteve të kryera nga anëtar i Parlamentit me mandatin e tij kombëtar. Nëse Këshilli Kushtetues konstaton papajtueshmërinë, anëtar i Parlamentit duhet të rregullojë situatën brenda një afati kohor prej tridhjetë ditësh. Nëse kjo nuk ndodh, Këshilli do ta largojë atë nga detyra.

¹³<http://www.legislationline.org/download/action/download/id/838/file/1d3069e22bf427292ff15e253dd9.htm/preview>. Parlamenti i kërkon Gjykatës Kushtetuese të konkludojë nëse veprimet konkrete përbëjnë shkelje të Kushtetutës. Nëse Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se personi ka shkelur rëndë Kushtetutën, sipas nenit 74 të saj, Parlamenti mund ta largojë personin nga detyra ose të revokojë mandatin e një anëtar i me jo më pak se 3/5 e votave të të gjithë anëtarëve.

¹⁴ Rregullorja e Parlamentit të Sllovakisë. Nëse vendimi i Komisionit parlamentar i miratuar nga Parlamenti ka përcaktuar humbjen e mandatit, deputeti mund të paraqesë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese për kontrollin e këtij vendimi.

¹⁵ Rregullorja e Parlamentit (pika 4 supra). Parlamenti Austriak vendos nëse një kërkesë e tillë për papajtueshmërinë me mandatin e deputetit duhet të paraqitet apo jo në Gjykatën Kushtetuese; nëse Komisioni përkatës vendos të mos ia referojë çështjen Gjykatës Kushtetuese, pakica parlamentare nuk konsiderohet e prekur në të drejtat e saj.



me sekretare Edmira Babaj, në datën 2.7.2015 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 35/3 Akti, që i përket:

KËRKUES: Hysni Çoçka

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. 381, datë 12.3.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 138, datë 13.2.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2013-1013, datë 19.7.2013 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 29, 41, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6 dhe 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fatmir Hoxha, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuari Hysni Çoçka është hetuar dhe gjykuar në gjendje të lirë për akuzën e kryerjes së veprës penale ushtarake “Shpërdorimi i detyrës” kryer nga kuadri komandues, në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 70/2 dhe 2 të Kodit Penal Ushtarak (KPU) dhe neni 25 i Kodit Penal (KP).

2. Pas përfundimit të gjykimit të çështjes në ngarkim të kërkuarit dhe 29 të gjykuarve të tjerë, me vendimin nr. 381, datë 12.3.2012, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur: “*Deklarimin fajtor të të pandehurit Hysni Çoçka për kryerjen e veprës penale ushtarake “Shpërdorimi i detyrës”, kryer nga kuadri komandues, parashikuar nga neni 70/2 i KPU-së dhe dënimin e tij me 3 vjet burgim.... Bashkë me dënimin kryesor, bazuar në nenet 8/1 dhe 13 të KPU-së dhe nenin 35 të KP-së, për të pandehurin Hysni Çoçka të jepet si dënim plotësues “Ndalimi i së drejtës për të*

ushtruar një detyrë shtetërore”, për një periudhë prej 1 viti.”.

3. Me vendimin nr. 138, datë 13.2.2013, Gjykata e Apelit Tiranë ka lënë në fuqi vendimin nr. 381, datë 12.3.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për sa i përket kërkuarit.

4. Me vendimin nr. 00-2013-1013, datë 19.7.2013, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi ka vendosur mospranimin e rekurseve të paraqitura nga Prokurori pranë Prokurorisë së Apelit Tiranë dhe 18 prej të gjykuarve, ku nuk përfshihet kërkuari Hysni Çoçka.

II

5. **Kërkuari Hysni Çoçka** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) për shfuqizimin e vendimeve objekt kërkesë, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur këto pretendime për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor:

5.1. Është cenuar *parimi i barazisë së armëve*, pasi gjykatat nuk kanë lejuar marrjen e provave të kërkuara, të cilat kanë qenë thelbësore për procesin, si dhe nuk kanë lejuar riekspertimin tekniko-ushtarak. Vendimet e gjykatave janë mbështetur në prova të marra në mënyrë jo të ligjshme.

5.2. Është cenuar *parimi i arsyetimit të vendimeve gjyqësore*. Vendimet janë të paarsyetuara dhe alogjike lidhur me përjashtimin e provave të paraqitura gjatë gjykimit. Gjykatat janë kontradiktore në arsyetimin e vendimeve të tyre, duke mbajtur qëndrime të dyfishta dhe duke përdorur dy standarde për të njëjtin arsyetim. Ato kanë dhënë arsyetime të ndryshme lidhur me argumentet për përgjegjësinë penale të të pandehurit.

5.3. Është cenuar *e drejta e aksesit* në Gjykatën e Lartë, pasi edhe pse rekursi përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), Kolegji Penal vendosi mospranimin e tij për shqyrtim në seancë gjyqësore.

6. **Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme**, paraqiti prapësime me shkrim, duke argumentuar:

6.1. Kërkuari nuk legjitimohet për pretendimet e parashtruara prej tij, pasi ato nuk janë ngritur më parë në Gjykatën e Lartë. Ai nuk ka



shteruar mjetet ligjore në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës.

6.2. Nga përmbajtja e vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nuk rezulton që kërkuesi të këtë ushtruar rekurs dhe emri i tij nuk pasqyrohet në dispozitivin e atij vendimi. Po ashtu edhe prokurori në rekursin e tij nuk është shprehur lidhur me kërkuenin dhe disa të gjykuar të tjerë, sepse në lidhje me ta ka qenë dakord me vendimin e Gjykatës së Apelit.

6.3. Edhe pse kërkuesi ka paraqitur bashkëlidhur kërkesës një kopje të rekursit me të cilin pretendon se i është drejtuar Gjykatës së Lartë, ky dokument nuk dihet se kur është bërë dhe nuk vërteton se realisht ai e ka depozituar atë në gjykatë brenda afatit ligjor. Shënimi që gjendet në rekurs nuk të lë të kuptosh se te cili punonjës i sekretarisë së gjykatës është dorëzuar dhe në cilën datë është marrë në dorëzim zyrtarisht.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuetit

7. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka ngritur pretendime lidhur me legjitimitimin e kërkuetit. Sipas këtij subjekti kërkuesi nuk ka shteruar mjetet ligjore në dispozicion, pasi pretendimet e paraqitura në kërkesë nuk janë ngritur më parë në Gjykatën e Lartë. Nga përmbajtja e vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nuk rezulton që kërkuesi të këtë ushtruar rekurs dhe emri i tij nuk pasqyrohet në dispozitivin e atij vendimi.

8. Gjykata vëren se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, pasi ai është një nga subjektet që mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues në bazë të nenit 134/1/g të Kushtetutës. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 2-vjeçar që ka parashikuar neni 30/2 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

9. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae* Gjykata ka theksuar se bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës ajo vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individit për shkeljen e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi ai të këtë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e kësaj të drejte. Gjykata

ka theksuar se juridiksioni kushtetues për shkeljen e së drejtës themelore për një proces të rregullt bëhet i mundur kur kërkuesi shteron mjetet e ankimit pranë gjykatave të sistemit gjyqësor, çka nënkupton që kërkuesi duhet t'i shfrytëzojë, në shkallët e sistemit gjyqësor, të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të së drejtës së pretenduar. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimin nr. 48, datë 6.7.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Kontrolli i ushtruar nga Gjykata në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës është një kontroll subsidiar, që do të thotë se individi duhet t'i këtë shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore përpara se t'i drejtohet asaj. Duke qenë se mbrojtja kushtetuese ka një funksion subsidiar, ajo mund të kërkohej vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme, që përmbyll procesin gjyqësor dhe pretendimet për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor mund të ngrihen në Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mjetet ligjore të ofruara nga sistemi i brendshëm (*shih vendimin nr. 48, datë 6.7.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Bazuar në sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i subjektit të interesuar se kërkuesi nuk ka shteruar mjetet ligjore në dispozicion është i pabazuar. Nga materialet e kësaj çështjeje, siç do të arsyetohet në vijim në vendim, rezulton se kërkuesi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, ku ka ngritur edhe pretendimet e tij lidhur me procesin penal të zhvilluar në gjykatat e faktit. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet t'i drejtohet asaj në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës.

B. Për thelbin e pretendimeve

12. Kërkuesi ka pretenduar para Gjykatës se procesi gjyqësor i kundërshtuar nuk ka respektuar kërkesat e një procesi të rregullt në drejtim të parimit të barazisë së armëve, parimit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, si dhe respektimit të së drejtës së aksesit në Gjykatën e Lartë.

13. Gjykata ka theksuar se kontrolli i kushtetutshmërisë së një vendimi gjyqësor vlerësohet në një kontekst të caktuar faktesh që lidhen me të drejtën për proces të rregullt ligjor.



Rastet që i paraqiten Gjykatës mbi bazën e ankimit të individëve, duhet të shqyrtohen domosdoshmërisht në bazë të provueshmërisë së fakteve të dhëna. Marrja e vendimit për çështje kushtetuese kondicionohet nga përcaktimi i fakteve kushtetuese, mbi bazën e të cilave vlerësohet respektimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Përderisa Gjykata Kushtetuese ka autoritetin për të vendosur përfundimisht për çështje të kushtetutshmërisë së procesit gjyqësor, ajo nuk mund ta ushtrojë këtë kompetencë pa analizuar faktet e natyrës kushtetuese (*shih vendimin nr. 5, datë 2.3.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në kuptim të sa më sipër, Gjykata, referuar përmbajtjes së vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 00-2013-1013, datë 19.7.2013, vëren se në të janë pasqyruar palët në proces, disponimet e gjykatave më të ulëta, subjektet që kanë paraqitur rekurs, si dhe shkaqet e parashtruara në rekurset respektive, por nuk rezulton nëse kërkuesi ka paraqitur rekurs kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë. Ndërkohë, kërkuesi ka paraqitur para Gjykatës një dokument, i cili titullohet “Rekurs shtesë”, i datës 11.3.2013, dhe mban vulën e Gjykatës së Lartë nr. H-18 prot., datë 11.3.2013.

15. Për efekt të këtij gjykimi Gjykata u është drejtuar gjykatave të tria shkallëve të gjykimit për kërkim informacioni. Sipas shkresës nr. 5199/1, datë 30.4.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nga kontrolli i ushtruar në librat e regjistrimit të rekurseve dhe dosjes penale nr. 381, datë 12.3.2012 nuk figuron të ketë rekurs dhe shtesë rekursi të paraqitur nga shtetasi Hysni Çoçka. Sipas shkresës nr. 1972, datë 14.5.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë, pranë kësaj gjykate nuk është depozituar rekurs apo shtesë rekursi nga kërkuesi, kurse sipas shkresës nr. 210/1, datë 19.5.2015 të kancelarit të Gjykatës së Lartë, shtesa e rekursit penal e protokolluar pranë Gjykatës së Lartë me nr. H-18 prot., datë 11.3.2013 i është kthyer të dënuarit Hysni Çoçka në institucionin ku ai ishte duke vuajtur dënimin, duke e vënë në dijeni se rekursi duhet të depozitohet në gjykatën që ka dhënë vendimin.

16. Gjykata, bazuar në materialet e dosjes gjyqësore, vëren, gjithashtu, se kërkuesi ka depozituar në Gjykatën e Lartë edhe kërkesën nr. H-10 prot., datë 15.2.2013, me objekt pezullimin e ekzekutimit të vendimeve nr. 138, datë

13.2.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr. 381, datë 12.3.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me urdhrin nr. 22, datë 7.5.2013 të Kryetarit të Gjykatës së Lartë është vendosur rrëzimi i kërkesës për pezullim dhe në përmbajtje të këtij urdhri rezulton i pasqyruar fakti i depozitimit të rekursit penal nga kërkuesi.

17. Për efekt të provueshmërisë së fakteve, të cilat janë përcaktuese për marrjen e një vendimi të drejtë nga ana e Gjykatës, ajo mund të bazohet në çdo lloj mjeti të lejuar nga ligji procedural. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se vetëm fakti i pasqyrimin të ekzistencës së rekursit në urdhrin e Kryetarit të Gjykatës së Lartë, është i mjaftueshëm për të arritur në përfundimin se kërkuesi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

18. Në nenin 42/2 të Kushtetutës parashikohet se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t’i drejtohen një gjykate, e cila do t’i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë, për t’i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Në rast se mohohet kjo e drejtë procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t’iu drejtuar gjykatës (*shih vendimin nr. 8, datë 26.2.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).



19. Megjithatë, Gjykata ka vlerësuar se, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Një linjë e tillë lidhur me raportin ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit). Gjykata e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, ka për detyrë të kontrollojë mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta. Ndërsa gjykimi kushtetues synon të vlerësojë nëse procesi, si i tërë, ka qenë i rregullt, duke u ndalur në ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të palëve në proces. Gjykata investohet vetëm nëse konstaton shkelje të parimeve të procesit të rregullt ligjor dhe nëse këto shkelje nuk janë konstatuar e riparuar nga Gjykata e Lartë, pasi një qëndrim i ndryshëm do ta kthente Gjykatën Kushtetuese në një instancë të zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj (*shih vendimin nr. 3, datë 26.1.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në kuptim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se i takon Gjykatës së Lartë të marrë në shqyrtim pretendimet e ngritura në rekursin e paraqitur nga kërkuesi Hysni Çoçka përpara se të vihet në lëvizje gjykimi kushtetues. E drejta e ankimit, ashtu si edhe ajo e aksesit në gjykatë nuk mund t'i cenohen kërkuesit për shkaqe që rrjedhin nga mangësitë ose gabimet në veprimtaritë e vetë organeve shtetërore (*shih vendimin nr. 32, datë 22.7.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin konkret edhe pse kërkuesi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, brenda afatit ligjor 30-ditor të parashikuar në nenin 435/1 të KPP-së, për shkak të defekteve në sistem dhe në veprimtarinë e administratës së Gjykatës së Lartë atij i është mohuar e drejta e aksesit si pasojë e moshqyrtimit të tij së bashku me rekursin e të pandehurve të tjerë në dosjen penale nr. 381, datë 12.3.2012. Gjykata vëren se sipas nenit 407/5 të KPP-së kur ankimi bëhet në gjykatën jokompetente, ajo ia dërgon aktet gjykatës kompetente. Në përputhje me këtë

dispozitë Gjykata e Lartë kishte detyrimin që t'ia dërgonte rekursin gjykatës kompetente për efekt të regjistrimit dhe komunikimit të tij.

21. Në përfundim, Gjykata konstaton cenimin e së drejtës së aksesit në Gjykatën e Lartë, si një nga elementet e së drejtës për një proces të rregullt ligjor të sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1, shkronja “g”, të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Konstatimin e cenimit të së drejtës së aksesit në Gjykatën e Lartë.

- Rrëzimin e kërkesës për pretendimet e tjera.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Fatmir Hoxha

Anëtarë kundër: Fatos Lulo, Besnik Imeraj

VENDIM

Nr. 9, datë 26.2.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“

me sekretare Blerina Basha, në datën 13.10.2015 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 45/8, Akti, që i përket:



KËRKUESE: Gjykata e Apelit Vlorë

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në mungesë.

KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar në gjykim nga z.Artur Metani.

OBJEKTI: Papajtueshmëria e paragrafit të dytë të nenit 55 të Kodit Penal dhe e paragrafit të katërt të nenit 278 të Kodit Penal me nenet 7, 17/1, 135/1 dhe 145/1 të Kushtetutës.

BAZA LIGJORE: Nenet 134/1/d dhe 145/2 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, si dhe nenet 68 e 70 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Bashkim Dedja, shqyrtoi pretendimet e kërkuarit, i cili kërkonte pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Këshillin të Ministrave, i cili kërkonte rrëzimin e kërkesës, si dhe e diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Gjykata e Shkallës së Parë Lushnjë, me vendimin nr. 362, datë 4.12.2014, ka vendosur: deklarimin fajtor të të pandehurit SH.B. për veprën penale të *vrasjes me dashje të mbetur në tentativë*, dhe në bazë të nenit 76 dhe 22 të Kodit Penal (KP) dënimin e tij me 12 vjet burg; deklarimin fajtor të të pandehurit për veprën penale “Prodhim dhe mbajtja pa leje të armëve luftarakë dhe municionit”, dhe në bazë të nenit 278/4 të KP-së dënimin e tij me 8 vjet burg. Në aplikim të nenit 55, në bashkim të dënimeve të mësipërme, i pandehuri është dënuar me 20 vjet burg. Në aplikim të nenit 406 të KPP-së i është ulur 1/3-ta e dënimit dhe përfundimisht është dënuar me 13 vjet e 4 muaj burgim.

2. I pandehuri e ka apeluar çështjen pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, (gjykata referuese), duke kërkuar ndryshimin e kualifikimit juridik të veprës penale “Vrasje me dashje” në tentativë në “Plagosje të rëndë me dashje”, të parashikuar nga neni 88/1 i KP-së, dhe dënimin sa më të ulët për të pandehurin.

3. Gjykata referuese, me vendimin e ndërmjetëm nr. 583, datë 9.4.2015, ka vendosur

pezullimin e çështjes dhe i ka kërkuar Gjykatës Kushtetuese që të vlerësojë papajtueshmërinë me nenet 7, 17/1, 135/1 dhe 145/1 të Kushtetutës të paragrafit të dytë të nenit 55 dhe paragrafit të katërt të nenit 278 të Kodit Penal.

4. Në nenin 55/2 të KP-së përcaktohet: “*Dënimi më i rëndë i shtuar në rastin kur personi ka kryer një krim kundër jetës me dashje, me përdorimin pa leje të armëve luftarakë dhe municionit, përbëhet nga shuma e përgjithshme e dënimeve për secilën veprë penale*” (neni 9 i ligjit nr. 144/2013, që ka shtuar nenin 55 të KP-së).

5. Në paragrafin e katërt të nenit 278/4 të KP-së përcaktohet se “*mbajtja e armëve, e bombave apo minave, ose lëndëve plasëse në automjete apo në çdo mjet tjetër të motorizuar, në mjedise publike ose në mjedise të hapura për publikun, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet*” (në vijim gjykata do t’i referohet si paragrafi i pestë, pasi me ligjin nr. 98/2014, që ka ndryshuar nenin 278, paragrafi i katërt ekzistues është bërë paragrafi i pestë).

6. Gjithashtu, gjykata referuese, edhe pse pranon se i mungon kriteri lidhës me çështjen konkrete, për paragrafët 1, 3, 4 dhe 6 të nenit 278 të KP-së, i kërkon Gjykatës Kushtetuese që bazuar në nenin 48 të ligjit nr. 8577, datë 10.10.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” të çmojë të shprehet me nismën e saj edhe për këto dispozita.

7. Gjatë shqyrtimit paraprak, Kolegji i Gjykatës Kushtetuese vendosi kalimin në seancë plenare të çështjes dhe shqyrtimin e saj mbi bazë dokumentesh.

II

8. **Kërkesja, gjykata referuese**, pretendon se nenet e sipërcituara bien ndesh me nenet 7, 17/1, 135/1 dhe 145/1 të Kushtetutës, përkatësisht ndarjen e pushteteve, ushtrimin e pushtetit gjyqësor, pavarësinë e pushtetit gjyqësor, si dhe kriteret kufizuese mbi proporcionalitetin lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut, duke argumentuar në mënyrë të përmbledhur për sa vijon:

8.1. Ndërhyrja në paragrafin e dytë të nenit 55 të KP-së cenon nenin 7 të Kushtetutës, pasi ligjvënësi ka ushtruar pushtetin gjyqësor kur ka përcaktuar mënyrën e caktimit të dënimit, duke i



hequr mundësinë gjykatës të zbatojë kriteret ligjore të caktimit të dënimit, që është atribut i këtij pushteti.

8.2. Përcaktimi i ligjvënësit për të gjitha krimet kundër jetës që kryhen me dashje dhe shoqërohen me përdorimin pa leje të armëve luftarake dhe municionit, të cilat janë jo më pak se 16 dispozita të Kodit Penal, parashikuar në paragrafin e dytë të nenit 55 të KP-së, u ka hequr gjykatave të sistemit gjyqësor të drejtën të zbatojnë rregullat e përcaktuara në nenet 47 dhe 55 të KP-së për gjykimin e këtyre veprave, duke cenuar ushtrimin e pushtetit gjyqësor, në kundërshtim me nenin 135/1 të Kushtetutës.

8.3. Ndërhyrja në nenin 55 është në kundërshtim edhe me nenin 145/1 të Kushtetutës, pasi ky rregullim, duke penguar gjykatat në dhënien e drejtësisë në caktimin e dënimit ndaj të pandehurve, cenon edhe pavarësinë e pushtetit gjyqësor.

8.4. Sanksioni për mbajtjen e armëve, të bombave apo minave ose lëndëve plasëse në automjete apo në çdo mjet tjetër të motorizuar, në mjedise publike ose në mjedise të hapura për publikun, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet, parashikuar në nenin 278/5 të KP-së, nuk i përgjigjet dukshëm rrezikshmërisë shoqërore të veprës, si dhe nuk përmbush funksionin kryesor të dënimit, që nuk është ndëshkimi i fajtorit, por edukimi dhe rehabilitimi i tij, gjë që vjen në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit, duke rënë ndesh me nenin 17 të Kushtetutës.

8.5. Ashpërsimi i dënimit dhe ndërhyrja në nenin 278 të Kodit Penal bie në kundërshtim edhe me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, konkretisht me vendimin nr. 47, datë 26.7.2012.

9. Subjekti i interesuar, **Këshilli i Ministrave**, ka paraqitur këto prapësime:

9.1. Ligjvënësi ka hapësirë të gjerë veprimi në ushtrimin e kompetencave legjislative. Ai është përgjegjës në hartimin e politikave penale, për rrjedhojë është brenda juridiksionit të tij legjislativ në përcaktimin e llogaritjes së dënimeve penale dhe masës së dënimeve.

9.2. Në ndryshimet e dispozitave ligjore objekt kundërshtimi, ligjvënësi është udhëhequr nga interesi publik, konkretisht nga lufta kundër krimit të organizuar, siguria e rendit publik dhe

shoqëror, si dhe rritja e efektivitetit të masave shtrënguese ndaj autorëve të veprave penale.

9.3. Parimi i proporcionalitetit përmban tri aspekte: përshtatshmërinë, nevojën dhe domosdoshmërinë, që do të thotë se ligjvënësi i ka pasur në konsideratë këto tri aspekte me ndryshimet e realizuara në paragrafin e dytë të nenit 55 dhe paragrafin e pestë të nenit 278 të KP-së.

9.4. Ligjvënësi me këtë rregullim të ri përjashtues ka pasur si synim ashpërsimin e masës së dënimit për autorët që dënohen për kategorinë e veprave penale të përfshira në krimet kundër jetës me dashje me përdorimin pa leje të armëve dhe municionit, për shkak të rritjes së kriminalitetit në këtë fushë.

10. Subjekti i interesuar, **Kuvendi i Republikës së Shqipërisë**, nuk ka paraqitur prapësime para Gjykatës Kushtetuese.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuarës

11. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm legjitimohen t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese nëse plotësojnë kushtet e parashikuara nga neni 145/2 i Kushtetutës dhe neni 68 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë". Neni 145/2 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon se kur gjyqtarët çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me Kushtetutën, nuk i zbatojnë ato, duke vendosur pezullimin e çështjes dhe dërgimin e saj Gjykatës Kushtetuese.

12. Gjykata ka theksuar se përpara marrjes së vendimit të pezullimit të çështjes, gjykata referuese duhet të konkludojë se gjykimi që ka nisur nuk mund të përfundojë pa iu dhënë përgjigje çështjes së kushtetutshmërisë së ligjit nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Nëse gjykata referuese çmon se një ligj nuk do të zbatohet nga ana e saj për zgjidhjen e çështjes, edhe pse sipas saj vlerësohet si jokushtetues, ajo duhet të vazhdojë me gjykimin e çështjes (*shih vendimin nr. 39, datë 30.6.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Po ashtu, gjykata referuese, në zbatim të parimit të kushtetutshmërisë, përpara se t'i drejtohet kësaj Gjykate duhet të bëjë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar ligjin e zbatueshëm në përputhje me



Kushtetutën. Është detyrim i gjykatës referuese të zgjidhë dyshimet interpretative, duke i dhënë normës së zbatueshme një interpretim që përputhet me parimet kushtetuese. Në rast se ajo vlerëson se të gjitha interpretimet e mundshme bien në kundërshtim me Kushtetutën, atëherë duhet t'i drejtohet Gjykatës, duke kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së normës të individualizuar si e zbatueshme në rastin konkret (*shih vendimet nr. 7, datë 27.2.2013; nr. 39, datë 30.6.2014; nr. 7, datë 16.2.2015; nr. 55 datë 21.7.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Bazuar në standardet e mësipërme, Gjykata vlerëson se në rastin konkret gjykata referuese i ka plotësuar kriteret për iniciimin e gjykimit incidental, duke identifikuar normat konkrete, duke argumentuar jokushtetutshmërinë e tyre bazuar në parimet dhe kërkesat kushtetuese, si dhe duke argumentuar se zgjidhja e çështjes konkrete varet nga zbatueshmëria e këtyre normave, për të cilat nuk kishte mundësi dhe hapësirë interpretimi, përveçse duke ushtruar kontrollin incidental ndaj tyre.

B. Për pretendimin se shtesa që i është bërë nenit 55/2 të KP-së vjen në kundërshtim me nenet 7, 135/1 dhe 145/1 të Kushtetutës, duke cenuar për këtë arsye parimin e ndarjes dhe pavarësisë së pushteteve

14. Gjykata referuese pretendon se me shtesën e realizuar në paragrafin e dytë të nenit 55 të KP-së ligjvënësi i ka hequr të drejtën pushtetit gjyqësor të japë drejtësi, në përputhje me parashikimet e nenit 47/2 të KP-së, sipas të cilit në caktimin e dënimit ndaj personit gjykata merr parasysh rrezikshmërinë e veprës, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Po kështu, gjykata referuese pretendon se mjeti që ka përzgjedhur ligjvënësi për të arritur synimin e tij, konkretisht: luftën kundër krimit të organizuar, sigurinë e rendit publik dhe shoqëror, si dhe rritjen e efektivitetit të masave shtrënguese ndaj autorëve të veprave penale, bie në kundërshtim me pavarësinë funksionale të gjykatave në atributin që kanë për dhënien e drejtësisë.

15. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, prapëson se ligjvënësi ka hapësirë të gjerë veprimi në ushtrimin e kompetencave legjislativë. Ai është përgjegjës në hartimin e politikave penale, për rrjedhojë është brenda juridiksionit të

tij legjislativ për këtë rregullim të ri në lidhje me përcaktimin e dënimeve.

16. Gjykata rithekson se parimi i shtetit të së drejtës, ku mbështetet një shtet demokratik, nënkupton sundimin e ligjit dhe mënjanimin e arbitraritetit, me qëllim që të arrihet respektimi dhe garantimi i dinjitetit njerëzor, drejtësisë dhe sigurisë juridike. Disa nga elementet e shtetit të së drejtës janë: parimi i ndarjes së pushteteve, siguria juridike dhe respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut (*shih vendimin nr. 29, datë 31.5.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Gjykata ka theksuar se legjislatiioni penal ka për detyrë të mbrojë vlera të rëndësishme, të tilla si pavarësinë e shtetit dhe tërësinë e tij territoriale, dinjitetin e njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, rendin kushtetues, pronën etj. (*neni 1/b të KP-së*). Ai bazohet në parimet kushtetuese të shtetit të së drejtës, të barazisë përpara ligjit, të drejtësisë në caktimin e fajësisë dhe të dënimit, si dhe të humanizmit (*neni 1/c të KP-së*). Ky legjislatiion është një tregues kuptimplotë për çdo vend, në kuptimin se sa ai është në gjendje të balancojë të drejtën e shtetit për të siguruar rendin publik e shoqëror, nga njëra anë, me të drejtat dhe liritë e individit, nga ana tjetër (*shih vendimet nr. 1, datë 12.1.2011; nr. 47, datë 27.6.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve parashikohet në nenin 7 të Kushtetutës, sipas të cilit: “Sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor”. Ky formulim do të thotë se ligjvënësi, ekzekutivi dhe gjyqësori janë të ndarë, efektivisht të pavarur dhe midis tyre duhet të ketë një balancë. Në varësi të kësaj ndarjeje, fusha e ushtrimit të kompetencave nga institucionet e ndryshme kushtetuese varet nga fakti se cilit pushtet i përket institucioni, nga vendi i tij midis institucioneve të tjera dhe nga raportet e tij me ato të institucioneve të pushtetit shtetëror. Në përputhje me detyrat që u ka ngarkuar Kushtetuta, secili prej tyre është i pajisur me pushtet të mjaftueshëm, gjë që i jep mundësinë të marrë vendime në mënyrë të lirë e të pavarur. Asnjë organ apo institucion tjetër, në përbërje ose jo të njërit prej tri pushteteve, nuk mund të ndërhyjë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve, që, sipas rastit, do të përbënin objektin



qendror të veprimtarisë së organeve apo institucioneve të tjera kushtetuese (*shih vendimet nr. 16 datë 10.4.2015; nr. 36 datë 1.6.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Po sipas Gjykatës, “pavarësia e gjyqtarëve dhe gjykatave nuk është një qëllim në vetvete. Respektimi i këtij parimi është një kusht i nevojshëm për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Garantimi i një standardi të tillë përbën dhe kriterin orientues për të vlerësuar pavarësinë e gjyqtarëve dhe të gjykatave” (*shih vendimet nr. 11, datë 2.4.2008; nr. 11, datë 6.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Referuar këtyre standardeve, Gjykata vlerëson se nëse me ndryshimet e bëra në rastin konkret ligjvënësi ka respektuar parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, si dhe parimin e pavarësisë së pushtetit gjyqësor, si i vetmi pushtet i ngarkuar nga kushtetutbërësi për dhënien e drejtësisë.

21. Gjykata konstaton se paragrafi i dytë i shtuar i nenit 55 të Kodit Penal objekt kundërshtimi parashikon se *dënimi më i rëndë i shtuar në rastin kur personi ka kryer një krim kundër jetës me dashje, me përdorimin pa leje të armëve luftarake dhe municionit, përbëhet nga shuma e përgjithshme e dënimeve për secilën veprë penale*. Duket se qëllimi i ligjvënësit, duke shtuar këtë paragraf në nenin 55 të Kodit Penal, ka qenë që të detyrojë gjykatat që në të gjitha rastet kur personat kryejnë krime kundër jetës me dashje, me përdorimin pa leje të armëve luftarake dhe municionit, të aplikojnë si masë dënimi përfundimtar sistemin e mbledhjes aritmetike të dënimeve të caktuara më parë për secilën veprë penale.

22. Gjykata vëren se para shtesës së bërë në nenin 55 të Kodit Penal gjykatat nuk kishin asnjë pengesë që si dënim më të rëndë të shtuar të zbatonin mënyrën e mbledhjes aritmetike të dënimeve. Kështu, sipas paragrafit të parë të nenit 55 të Kodit Penal “*kur veprimet ose mosveprimet përmbajnë elementet e disa veprave penale, si dhe kur personi ka kryer disa vepra penale për të cilat nuk është dhënë akoma dënim, gjykata më parë cakton dënimin për çdo veprë penale dhe në përfundim jep një dënim të vetëm, që përbëhet nga dënimi më i rëndë i shtuar*”. Ndërsa në paragrafin e tretë (ish-paragrafi i dytë para ndryshimeve) përcaktohet rregullisht sipas të cilit “*dënimi më i rëndë i shtuar nuk mund të kapërcejë shumën e përgjithshme të dënimeve, të caktuara*

veç e veç, as kufirin më të lartë të parashikuar për llojin e dënimit të dhënë”.

23. Nga ana tjetër, Gjykata çmon me vend të nënvizojë se neni 55 i Kodit Penal zbatohet dhe duhet të zbatohet nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm në lidhje me nenin 47 të Kodit Penal, sipas të cilit “gjykata cakton dënimin, duke respektuar dispozitat e pjesës së përgjithshme të Kodit dhe kufijtë e dënimeve të parashikuara me ligj për veprën penale”, dhe se “në caktimin e dënimit ndaj personit ajo merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese”.

24. Gjykata rithekson se ndonëse ligjvënësi në përcaktimin e veprave penale dhe llojit të dënimit ka fushë të gjerë veprimi, kjo liri është e kufizuar kur është fjala për vlerësimin e fajit si element i domosdoshëm i përgjegjësisë penale dhe në raport me shkallën e tij për caktimin e llojit dhe masës së dënimit konkret, pasi këto elemente janë të vlerësueshme vetëm nga gjykatat e zakonshme rast pas rasti (*shih vendimin nr. 47, datë 27.6.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Si pasojë, në përcaktimin e dënimit, për vepra të ndryshme penale, organi legjislativ nuk duhet të ketë parasysh vetëm parimin e parashikimit me ligj të dënimit dhe atë të sigurisë juridike. Ai duhet të marrë parasysh mjaftueshëm edhe konceptin e fajit në kuadër të parimit të shtetit të së drejtës dhe nëpërmjet formulimit të sanksionit t'i mundësojë gjyqtarit dhënien e një gjykimi të drejtë dhe proporcional në raste konkrete. Koncepti i fajit dhe përcaktueshmëria e pasojave juridike janë në një marrëdhënie tensioni njëra me tjetrën, marrëdhënie kjo për të cilën duhet gjetur një balancë funksionale kushtetuese (*shih vendimin BVerfGE 105, 135 të Gjykatës Kushtetuese Gjermane*).

25. Prandaj kjo Gjykatë ka vlerësuar se dënimi penal është rezultat i vlerësimit të rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, nga njëra anë, dhe shkallës së fajit të autorit të saj, nga ana tjetër. Në këtë drejtim, përcaktimi i veprave penale dhe llojeve të dënimeve janë në diskrecion të ligjvënësit, ndërsa individualizimi i tyre, rast pas rasti, është në diskrecion të gjykatës, e cila duke shqyrtuar të gjitha elementet juridike të veprës penale, shkallën e fajit dhe pasojat e ardhura nga vepra penale, cakton llojin dhe masën e dënimit



për autorët e veprave penale (*shih vendimin nr. 47, datë 27.6.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Në këtë kontekst, duke përcaktuar mënyrën e dhënies së dënimit, sipas metodologjisë së parashikuar në paragrafin e dytë të nenit 55 të KP-së, ligjvënësi u ka hequr gjykatave të sistemit gjyqësor të drejtën të vlerësojnë pikërisht elementet e parashikuara në paragrafin e dytë të nenit 47 të KP-së të përmendura më lart (*prg. 23*), të cilat janë jo vetëm përcaktuese në individualizimin e drejtë të dënimeve penale, por njëkohësisht janë edhe në kompetencën ekskluzive të gjyqësorit. Në vlerësimin e Gjykatës ky rregullim i ri përbën cenim të parimit të ndarjes së pushteteve dhe të pavarësisë funksionale të pushtetit gjyqësor.

27. Si konkluzion, Gjykata arrin në përfundimin se shtesa e bërë në nenin 55, paragrafi i dytë i KP-së, cenon parimin e ndarjes së pushteteve, të pavarësisë së pushtetit gjyqësor, si dhe përbën kufizim të kompetencave në dhënien e drejtësisë. Për pasojë, pretendimi i gjykatës referuese se ky rregullim vjen në kundërshtim me nenet 7, 135/1 dhe 145/1 të Kushtetutës, është i bazuar.

C. Për pretendimin se ndryshimet e bëra në paragrafin e pestë të nenit 278 të KP-së cenojnë parimin e proporcionalitetit dhe si të tilla bien ndesh me nenin 17/1 të Kushtetutës

28. Kërkuesi pretendon se sanksioni i parashikuar në paragrafin e pestë të nenit 278 të Kodit Penal, sipas të cilit: “Mbajtja e armëve, e bombave apo minave, ose lëndëve plasëse në automjete apo në çdo mjet tjetër të motorizuar, në mjedise publike ose në mjedise të hapura për publikun, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet”, është jo proporcional, nuk i përgjigjet dukshëm rrezikshmërisë shoqërore të veprës, në raport me veprat e tjera të këtij seksioni dhe të tjerat në Kodin Penal, dhe si i tillë vjen në kundërshtim me nenin 17 të Kushtetutës.

29. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, prapëson se parimi i proporcionalitetit përmban tri aspekte: përshtatshmërinë, nevojën dhe domosdoshmërinë, që do të thotë se ligjvënësi, duke pasur në konsideratë këto tri aspekte, në ndryshimet në nenet 55 dhe 278 të KP-së, është udhëhequr nga interesi publik, konkretisht nga lufta kundër krimit të organizuar, siguria e rendit publik dhe shoqëror, si dhe rritja e efektivitetit të

masave shtrënguese ndaj autorëve të veprave penale.

30. Gjykata vëren se ligjvënësi në periudha kohore të ndryshme ka ndërhyrë në legjislacionin penal, si duke përcaktuar vepra të reja penale, ashtu edhe duke ndryshuar marzhet e masave të dënimit për t’iu përgjigjur shqetësimeve të shoqërisë, si pasojë e zhvillimit të kriminalitetit, në veçanti të krimit të organizuar. Gjykata ka theksuar edhe më parë se ndërhyrje të tilla të ligjvënësit jo vetëm duhet të synojnë uljen e kriminalitetit, por duhet të jenë realisht efektive, në mënyrë që t’i shërbejnë në radhë të parë parandalimit të veprave penale.

31. Gjykata çmon se edhe në çështjen në shqyrtim, balanca mes së drejtës së kufizuar dhe interesit publik nuk është gjë tjetër veçse gjetja nga legjislatori e pikës së ekuilibrit midis së drejtës së shtetit për të siguruar rendin publik e shoqëror, nga njëra anë, dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të individit, nga ana tjetër. Për këtë arsye sanksionet penale, për shkak të kufizimeve që përcaktojnë në të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, parashikohen vetëm për ato lloj veprimesh ose mosveprimesh, të cilat, në përputhje me parimin e proporcionalitetit, janë të krahasueshme për nga rëndësia me vlerat që mbrojnë. Është e vërtetë se është në diskrecionin e ligjvënësit vlerësimi i mjetit të zgjedhur për ndëshkimin e shkelësve të ligjit dhe qëllimin që kërkohet të arrihet, por kur është fjala për parashikimin e dispozitave penale dhe sanksioneve përkatëse si “ultima ratio”, Gjykata vlerëson se ligjvënësi duhet të udhëhiqet nga parimet kushtetuese dhe funksionet që karakterizojnë dënimet penale. Ndërkohë, i përket Gjykatës Kushtetuese të analizojë proporcionalitetin e kësaj mase në raport me gjendjen dhe me shkeljet për të cilat është parashikuar dhënia e tyre (*shih vendimet nr. 12, datë 14.4.2010; nr. 47, datë 27.6.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Të njëjtin qëndrim kanë mbajtur edhe gjykatat homologe kushtetuese, si Gjykata Kushtetuese e Gjermanisë, sipas të cilës: “Parimi i proporcionalitetit rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës, në fakt nga vetë thelbi i të drejtave themelore, sidomos i lirisë personale, të cilat duhet të kufizohen nga pushteti shtetëror vetëm në atë masë sa të jetë e domosdoshme për



mbrojtjen e interesit publik. Pra, rëndësi të veçantë në fushën penale, sidomos në atë të parashikimit të dënimeve dhe ekzekutimit të tyre, zë mbrojtja e të drejtave të njeriut. Kjo do të thotë se edhe pse prej kohësh e drejta penale ka detyrën e mbrojtjes së bazave të një bashkëjetese të rregulluar në shoqëri, ajo nuk është mjeti kryesor i mbrojtjes ligjore, me gjithë karakterin e saj më të fuqishëm. Si pasojë, përdorimi i saj duhet t'u nënshtrohet kërkesave të parimit të proporcionalitetit. Për këtë arsye, neni 103, paragrafi 2 i ligjit themelor gjerman përcakton konceptin e thelbit të dënimit dhe raportin e fajit me dënimin, në kuptimin që çdo dënim duhet të jetë në një raport të drejtë me rrezikshmërinë e veprës penale dhe me shkallën e fajit të autorit” (*shih vendimet BVerfGE 19,342; BVerfGE 88,203; BVerfGE 45,187 të Gjykatës Kushtetuese Gjermane*).

33. Ligji objekt shqyrtimi ka parashikuar disa ndryshime, të cilat referuar këtyre konsideratave Gjykata çmon t'i prezantojë për të analizuar, nga njëra anë, strategjinë e ndërhyrjes së ligjvënësit ndër vite dhe, nga ana tjetër, efektivitetin e këtyre ndërhyrjeve në raport me respektimin e parimeve kushtetuese.

34. Me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, vepra penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municioneve” u parashikua fillimisht në nenin 278, sipas të cilit: “Prodhimi i armëve dhe i municionit luftarak, i bombave apo i minave, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet *me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet*. Mbjatja, blerja ose shitja e armëve, bombave apo minave, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet *me gjobë ose me burgim deri në shtatë vjet*. Mbjatja e fishekëve të armëve të lehta luftarake, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet *me gjobë ose me burgim deri në një vit*.”.

35. Me ligjin nr. 8279, datë 15.1.1998, në nenin 278 u bënë disa shtesa në paragrafët e parë dhe të dytë, ku pas fjalëve “minave”, u shtuan fjalët “lëndët plasëse”.

36. Me ligjin nr. 8733, datë 24.1.2001 në nenin 278 u bënë disa shtesa dhe ndryshime ndërmjet të cilave u përcaktua se “mbajtja e municionit luftarak, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet *me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet*”, si dhe

“kur vepra kryhet në sasi të mëdha në bashkëpunim, më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda, dënohet *me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet*.”.

37. Me ligjin nr. 144/2013, neni 278 u ndryshua për sa vijon: “Prodhimi i armëve dhe i municioneve luftarake, i lëndëve plasëse, i bombave apo i minave, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim *nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet*. Mbjatja e municioneve luftarake, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet *me gjobë ose me burgim deri në dy vjet*. Mbjatja e armëve, e bombave apo e minave ose e lëndëve plasëse në banesë, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet *me burgim nga një deri në pesë vjet*. Mbjatja e armëve, e bombave apo e minave, ose e lëndëve plasëse në automjete apo në çdo mjet tjetër të motorizuar, në mjedise publike ose në mjedise të hapura për publikun, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga *shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet*. Kur vepra penale kryhet në sasi të mëdha, në bashkëpunim, më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda, dënohet *me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet*.”.

38. Me ligjin nr. 98/2014 në nenin 278 u bënë disa ndryshime të tjera, ndërmjet të cilave u shtua një paragraf (i katërti) me këtë përmbajtje: “Mbjatja e bombave, minave ose lëndëve plasëse në banesë, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet *me burgim nga pesë deri në tetë vjet*.”. Gjithashtu, u ashpërsua masa e dënimit për vepra penale që kryhen në sasi të mëdha, në bashkëpunim, më shumë se një herë ose kanë sjellë pasoja të rënda, për të cilat dënimi me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet u zëvendësua me dënimin *me burgim nga pesëmbëdhjetë deri në njëzet vjet* (paragrafi i gjashtë i nenit 278 të KP-së).

39. Bazuar në këtë qasje historike të analizës së dispozitës, Gjykata evidenton se vepra penale e prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe të municionit, e parashikuar si e tillë në Kodin Penal të vitit 1995, ka pësuar ndryshime në kohë katër herë, përkatësisht në vitet 1998, 2001, 2013 dhe 2014.

40. Ligjvënësi në vitin 2001 ka ulur marzhin e dënimit minimal nga pesë në tre vjet për prodhimin e armëve dhe të municionit luftarak,



të bombave apo minave, pa lejen e organeve kompetente shtetërore (*neni 278/1 i ligjit nr. 8733*). Po me të njëjtin ligj është shtuar kryerja e së njëjtës vepër, por në sasi të mëdha në bashkëpunim, më shumë se një herë ose që ka sjellë pasoja të rënda (*neni 278/4 i ligjit nr. 8733*).

41. Ndërkohë në vitin 2013, ligjvënësi ka rritur marzhin e dënimit minimal dhe maksimal për prodhimin e armëve dhe të municionit luftarak, të bombave apo minave, pa lejen e organeve kompetente, nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet (*neni 278/1 i ligjit nr. 144*). Po me këtë ligj, ligjvënësi ka parashikuar marzhe të ndryshme dënimi për mbajtje të armëve, të bombave apo minave ose lëndëve plasëse, por me diferencën e konsumimit në banesë, në automjete apo në mjedise publike dhe në mjedise të hapura për publikun (*neni 278/3/4 i ligjit nr. 144*). Gjithashtu, u rrit marzhi minimal i dënimit nga pesë në dhjetë vjet, si dhe marzhi maksimal nga pesëmbëdhjetë në njëzet vjet, kur kjo vepër kryhet në sasi të mëdha, në bashkëpunim, më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda (*neni 278/5 i ligjit nr. 144*).

42. Për më tepër, në vitin 2014 ligjvënësi realizon një ndërhyrje tjetër në dispozitën penale objekt shqyrtimi në drejtim të rritjes së sanksioneve penale, si dhe në ndarjen e veprës penale, sipas llojit të armëve, përkatësisht në mbajtje të armëve në banesë (*prg. 3*) nga mbajtje e bombave, minave ose lëndëve plasëse në banesë, (*prg. 4*), e cila nga një vepër që dënohej me burgim nga një deri në pesë vjet, aktualisht dënohet me burgim nga pesë deri në tetë vjet (*neni 278/3/4 i ligjit nr. 98*). Kurse, kur kjo vepër kryhet në sasi të mëdha, në bashkëpunim, më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë deri në njëzet vjet, duke u rritur përsëri marzhi minimal i dënimit nga dhjetë në pesëmbëdhjetë vjet (*neni 278/6 i ligjit nr. 98*).

43. Bazuar në analizën historike të dispozitës, në parim, Gjykatës i rezulton se ligjvënësi është mbështetur thellësisht në strategjinë e ndërhyrjes ndëshkuese, e karakterizuar posaçërisht nga parashikimi i instrumenteve ashpërsuese, sikundër është rritja e marzheve minimale dhe maksimale të dënimit dhe përpjekja për të parashikuar të gjitha rastet dhe rrethanat e mundshme të prodhimit dhe të mbajtjes së të gjitha kategorive të armëve, municioneve

luftarake, bombave, minave ose lëndëve plasëse në banesë, në automjete, në mjete të motorizuara, në mjedise publike apo mjedise të hapura për publikun.

44. Në këto kushte, Gjykata gjen me vend të sjellë në vëmendje qëllimin e dënimeve penale në një shoqëri demokratike dhe parimet që duhet të udhëheqin ligjvënësin në caktimin e dënimeve penale.

45. Në lidhje me arsyen e ekzistencës së dënimit penal, Gjykata është shprehur se ai përmbush dy funksione të ndryshme, të cilat mund të konsiderohen si edukative. Nga njëra anë, qëndron *funkcioni i parandalimit të përgjithshëm* të veprave penale, pasi kërcënimi se shteti do të zbatojë sanksione penale sa herë që shtetasit do të kryejnë veprime të dënueshme nga legjislacioni penal, funksionon si një mënyrë për të dekurajuar dhe parandaluar cilindo shtetas që të ndërmarrë veprime që bien në kundërshtim me normat penale. Nga ana tjetër, qëndron *funkcioni i parandalimit të posaçëm*, i cili lidhet drejtpërsëdrejti me autorin e veprës, pasi duke zbatuar sanksionin penal synohet riedukimi i tij, në mënyrë që pas kryerjes së dënimit të mos ndërmarrë në të ardhmen veprime kriminale (*shih vendimet nr. 19, datë 1.6.2011; nr. 47, datë 27.6.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

46. Në përputhje me frymën e Kushtetutës, sanksioni penal i çfarëdolloj natyre duhet të synojë vetëm riedukimin dhe më pas integrimin e të dënuarit në jetën shoqërore. Gjykata, duke pasur parasysh edhe doktrinën e konsoliduar evropiane në këtë fushë, ka theksuar se që të jetë i pranueshëm dënimi penal në aspektin kushtetues, në përputhje me nenin 17/1 të Kushtetutës, duhet të jetë i drejtë edhe në përpjesëtim me veprën. Në këtë mënyrë, që të mund të ketë një proces riedukativ të suksesshëm, duhet që ndëshkimi penal të perceptohet nga autori i veprës si i drejtë dhe në përpjesëtim me veprën e kryer (*shih vendimin nr. 19, datë 1.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

47. Gjykata vëren se ndryshimet e ndërmarrë nga ligjvënësi në dispozitat objekt shqyrtimi (por edhe të tjera të shqyrtuara më parë nga kjo Gjykatë), kanë qenë përgjithësisht spontane, nisur nga synimi për të luftuar kriminalitetin, por pa iu nënshtruar më parë studimeve të thelluara për të shmangur prishjen e balancave jo vetëm



midis masave të dënimit të veprave penale të një kapitulli, por edhe në raport me veprat e tjera penale, në varësi të rrezikshmërisë shoqërore të tyre. Një qasje (strategji) e tillë e gabuar ka deformuar strukturën e Kodit Penal, duke krijuar disproporcione të pashpjegueshme (paarsyeshme) midis dënimeve të parashikuara për vepra të ndryshme të Kodit, në kundërshtim me parimet e shtetit të së drejtës dhe të proporcionalitetit, në rastet e kufizimit të të drejtave dhe lirive të individit. Përfaqësuesit e subjekteve të interesuara (KM) nuk ishin në gjendje të argumentonin para kësaj Gjykate nevojën e domosdoshme për ndërhyrjen në Kodin Penal, duke u mjaftuar vetëm me argumente të përgjithshme, si p.sh. “kriminaliteti ka pësuar rritje” apo “për të luftuar krimin e organizuar”.

48. Duke iu kthyer edhe një herë evidentimit të standardeve, Gjykata rithekson se përcaktimi me ligj i veprave të reja penale, si dhe caktimi i llojit dhe i masës së dënimit për to është në diskrecion të ligjvënësit, në përputhje me nevojat e vendit dhe të shoqërisë për parandalimin e kriminalitetit. Balanca mes së drejtës së kufizuar dhe interesit publik, nuk është gjë tjetër veçse gjetja nga legjislatori e pikës së ekuilibrit midis së drejtës së shtetit për të siguruar rendin publik e shoqëror, nga njëra anë, dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të individit, nga ana tjetër. Për këtë arsye sanksionet penale, për shkak të kufizimeve që përcaktojnë në të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, parashikohen vetëm për ato lloj veprimesh ose mosveprimesh, të cilat, në përputhje me parimin e proporcionalitetit, janë të krahasueshme për nga rëndësia me vlerat që mbrojnë (*shih vendimet nr. 19, datë 1.6.2011; nr. 47, datë 27.6.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

49. Gjykata, për të arritur në një përfundim të drejtë nëse ndërhyrjet e ligjvënësit në nenin 278 të Kodit Penal janë proporcionale në raport me gjendjen që i ka diktuar, e sheh me vend të bëjë një vështrim krahasues midis paragrafëve të vetë nenit, midis nenit 278 dhe dispozitave të tjera të të njëjtit kre, midis nenit 278 dhe veprave të ndryshme penale që kryhen me përdorimin e armëve dhe midis Kodit tonë Penal për veprën në fjalë dhe kodeve penale të vendeve të rajonit.

50. Veprat penale të mbajtjes pa leje të armëve, bombave, minave ose lëndëve plasëse në banesë, në automjete apo çdo mjet të motorizuar,

ose në mjedise publike, bëjnë pjesë në kategorinë e veprave penale që cenojnë rendin dhe sigurinë publike brenda seksionit III “Mbi veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike”.

51. Duke iu referuar, së pari, paragrafëve të ndryshëm të nenit 278 të KP-së rezulton se *mbajtja e armëve në banesë* pa lejen e organeve kompetente dënohet nga një deri pesë vjet (*prg. 3*). Më tej, *mbajtja e bombave, minave ose lëndëve plasëse në banesë* dënohet nga pesë deri në tetë vjet (*prg. 4*), kurse *mbajtja e armëve, bombave, minave ose lëndëve plasëse në automjete apo në çdo mjet tjetër të motorizuar, në mjedise publike ose në mjedise të hapura për publikun*, dënohet nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet, dallim që nuk e justifikon arsyen apo qëllimin e këtij ndryshimi (*prg. 5*).

52. Gjykata vëren se sipas doktrinës së të drejtës penale, prodhimi apo mbajtja pa lejen e organeve kompetente të armëve luftarake është element thelbësor i anës objektive të kësaj vepre penale. Ligjvënësi e ka konsideruar vepër të dënueshme penalisht mbajtjen e armëve pa leje, pavarësisht nga qëllimi i mbajtjes së tyre (për t’i përdorur ose jo). Në këtë kontekst, Gjykata e sheh të pajustificuar përpjekjen e ligjvënësit për të përcaktuar rrezikshmërinë e kësaj vepre penale dhe përcaktimin e masës së dënimit nisur nga kritere të tilla, si lloji i armës luftarake, dhe në veçanti vendi i mbajtjes së tyre (banesë, automjet, vendi i punës etj.). Për më tepër, Gjykata i konsideron joproporcionale dallimet në masat e dënimit të paragrafit të pestë të KP-së dhe paragrafëve të tretë dhe të katërt të këtij neni. Për ilustrim, një qytetar që mban një armë pa leje në banesë për të mbrojtur pronën, veten apo familjen, dënohet nga një deri në pesë vjet burgim. I njëjti person kur armën e mban për të njëjtën arsye në automjetin e tij, dënohet nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet burgim.

53. Gjykata e konsideron joproporcionale ndërhyrjen në paragrafin e pestë të nenit 278 të Kodit Penal, duke e krahasuar këtë dispozitë edhe me të tjera që ndodhen në të njëjtin kre të Kodit, “Veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike”. Kështu, trafikimi i armëve dhe municioneve, një krim ndërkombëtar, dënohet sipas Kodit Penal nga shtatë deri pesëmbëdhjetë vjet burgim (*neni 278/a, paragrafi i parë*). Të njëjtën masë dënimi ligjvënësi ka parashikuar edhe për veprat penale të trafikimit të lëndëve



plasëse, djegëse, helmuese dhe radioaktive (*neni 282/a, paragrafi i parë*) etj.

54. Gjykata vlerëson se armët nuk përfaqësojnë gjë tjetër veçse mjetin për të kryer vepra të tjera penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore, të cilat prekin kryesisht marrëdhëniet shoqërore që lidhen me mbrojtjen e jetës. Në këtë kuptim, edhe dënimet e parashikuara për to duhet të jenë në proporcion të drejtë me natyrën e krimit të kryer nëpërmjet përdorimit të tyre. Veprat penale mbulojnë një shkallë të gjerë veprimesh ose mosveprimesh, të cilat dallojnë mes tyre për sa i përket natyrës së shkeljes dhe rrezikut që i kanoset interesit që ligji synon të mbrojtë. Mjafton t'u referohemi disa veprave të parashikuara në seksione të ndryshme të Kodit Penal, që kryhen nëpërmjet përdorimit të armëve, për të arritur në përfundimin se ndryshimet objekt shqyrtimi janë disproporcionale.

55. Gjykata vëren se vrasja e kryer nga një person me një armë që e mban pa leje, në gjendjen e tronditjes së fortë psikike të çastit, të shkaktuar nga dhuna ose fyerja e rëndë e viktimës, dënohet me burgim gjer në tetë vjet (*neni 82, sek.I, "Krim kundër jetës të kryera me dashje"*). Ndërsa, për armën që ka shërbyer si mjet për kryerjen e krimit, dënimi do të ishte jo më pak se shtatë deri pesëmbëdhjetë vjet. E njëjta logjikë vlen edhe për vrasjen e kryer me kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme, që dënohet me burgim gjer në shtatë vjet (*neni 83, sek.I, "Krim kundër jetës të kryera me dashje"*).

56. Në të njëjtën linjë arsyetimi mund të përmenden edhe vepra të tjera penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore që kryhen me përdorimin e armëve. Gjykata konstaton se - vrasja me dashje dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet (*neni 76*); - marrëdhëniet seksuale ose homoseksuale me kërcënim me përdorimin e armës dënohen me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet (*neni 104*); - shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë me përdorimin e armës dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet (*neni 109/b/2*); - rrëmbimi i avionëve, anijeve dhe mjeteve të tjera me kërcënim me armë dënohen me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet (*neni 111*) etj.

57. Po në mbështetje të këtij argumenti mbi disproporcionalitetin e dënimeve për vepra penale të përcaktuara në seksione dhe krerë të ndryshëm, bazuar në shkallën e rrezikshmërisë së tyre shoqërore, Gjykata konstaton se Kodi Penal parashikon të njëjtin marzh dënimi me atë të parashikuar në paragrafin e pestë të Kodit Penal edhe për vepra të tjera penale me rrezikshmëri tejet të lartë shoqërore. Kështu, vepra penale mbi trafikimin e personave të rritur, e parashikuar te seksioni VII "Vepra penale kundër lirisë së personit", dhe më konkretisht, organizimi, drejtimi dhe financimi i trafikimit të personave, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet (*neni 110/a/3*). Gjithashtu, te kreu VII "Vepra me qëllime terroriste", prodhimi, mbajtja, transportimi i armëve luftarake, kimike, biologjike, bërthamore, me bazë helmuese ose eksplozive, me qëllim për të kryer vepra terrori, dënohen me burgim nga pesë deri pesëmbëdhjetë vjet (*neni 234*). Ndërsa pjesëmarrja në organizata terroriste dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet (*neni 234/a, prg. 2*).

58. Përveç argumenteve të sipërpërmendura, Gjykata e konsideron me vend të shtojë se ndërhyrjet në legjislacion lidhur me veprat penale të armëmbajtjes pa leje në mjedise publike janë tejet të ashpra edhe në raport me disa vende evropiane. Për të argumentuar sa më lart, ajo vlerëson të ofrojë dhe një qasje krahasimore në lidhje me veprën penale të prodhimit apo mbajtjes pa leje të armëve apo lëndëve të tjera plasëse të kodeve penale të disa vendeve të rajonit, si dhe më gjerë, listuar për sa vijon:

58.1. Kodi Penal i Malit të Zi në nenin 403 "Mbajtja e paligjshme e armëve të zjarrit dhe lëndëve shpërthyesë" parashikon: "1. Çdo person i cili pa leje prodhon, shet, siguron, shkëmben, mbart ose mban armë zjarri, municione apo lëndë shpërthyesë, dënohet me burgim për një periudhë jo më shumë se tre vjet. 2. Nëse objekti i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni është një pjesë e armës së zjarrit, municion, eksploziv apo armë gazi, prodhimi, shitja, blerja, shkëmbimi, ose mbajtja e së cilës është e ndaluar për qytetarët, personi dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet. 3. Nëse objekti i përmendur në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, përbën një sasi të madhe të armëve ose ajo është një armë me fuqi



të madhe shkatërruese, personi *dënohet me burgim nga një vit deri në tetë vjet.*”.

58.2. Kodi Penal i Maqedonisë në nenin 396 “Mbajtja e paligjshme e armëve dhe materialeve eksplozive” parashikon: “1. Çdo person i cili pa pasur leje prodhon, shet, siguron ose shkëmben armë zjarri, municione apo lëndë shpërthyesë, apo një person i cili pa leje mban armë zjarri, municione ose lëndë shpërthyesë, të cilat janë të ndaluara për qytetarët, *dënohet me burgim nga një deri në 10 vjet.* 2. Nëse objekti i veprës së parashikuar në paragrafin 1 është një sasi shumë e madhe armësh zjarri, municionesh apo lëndësh shpërthyesë, shkelësi *dënohet me burgim nga 3 deri në 10 vjet.* 3. Nëse veprat e parashikuara në paragrafët 1 dhe 2 kryhet duke qenë pjesë e një grupi, organizate apo organizimi tjetër kriminal, autori i veprës *dënohet me burgim deri 8 vjet.*”.

58.3. Kodi Penal i Serbisë në nenin 348 parashikon: “1. Çdo person i cili pa autorizim prodhon, shet, blen, shkëmben apo zotëron armë zjarri, pjesë të tyre, municione apo eksplozivë, *dënohet me burgim nga tre muaj deri në tre vjet dhe me gjobë.* 2. Nëse objekti i veprës penale të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni janë armët e zjarrit, municionet, eksplozivët apo substancat, të cilat janë të ndaluara për publikun, personi *dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet dhe me gjobë.* 3. Nëse objekti i veprës penale të përcaktuar në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni është një sasi e madhe armësh, municioni dhe pajisjesh të tjera me fuqi të madhe shkatërruese ose vepra është kryer në kundërshtim me rregullat e së drejtës ndërkombëtare, personi *dënohet me burgim nga një deri në tetë vjet.* 4. Çdo person që kryen veprat penale të përmendura në paragrafët 1 dhe 2 të këtij ligji me armë pa licencë *dënohet me burgim nga dy deri në dhjetë vjet.* 5. Çdo person që kryen veprat penale të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni pa leje, megjithëse ka leje për të blerë dhe për të mbajtur objekte të njëjta, *dënohet me gjobë ose me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet.*”.

58.4. Kodi Penal i Kroacisë në nenin 335 “Posedimi i paligjshëm i armëve të zjarrit dhe lëndëve shpërthyesë” parashikon: “1. Çdo person që pa autorizim përgatit, siguron, posedon apo në çfarëdo mënyre siguron për veten e tij apo një të tretë armë zjarri, municion ose substanca shpërthyesë në mënyrë të paligjshme, *dënohet me gjobë ose burgim jo më shumë se tre vjet.* 2. Çdo person

që pa autorizim siguron, zotëron, shet, prodhon ose shkëmben sasi të mëdha të armëve të zjarrit, municionit apo substancave shpërthyesë, *dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.*”.

58.5. Kodi Penal i Bullgarisë në nenin 337 parashikon: “1. Çdo person i cili prodhon, përpunon, riparon, krijon, mban, tregton, transporton, importon apo eksporton lëndë shpërthyesë, armë zjarri, kimike, biologjike apo bërthamore ose municione, pa pasur leje për ta bërë një gjë të tillë nga organi respektiv, apo vepron në kundërshtim me parashikimet e lejes së dhënë, *dënohet një deri në gjashtë vjet burgim.* 2. Dënimi është nga dy deri në tetë vjet burgim kur akti është kryer nga: a) një zyrtar që përfiton nga pozita e tij zyrtare; b) kur është përsëritës, përveç rastit kur personi është minoren. 3. Kur krimi kryhet në sasi të mëdha, *dënimi është nga tre deri në dhjetë vjet burgim.* 4. Kur krimi kryhet në sasi veçanërisht shumë të mëdha dhe çështja është veçanërisht e rrezikshme, dënimi është nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet burgim.”.

58.6. Kodi Penal i Sllovakisë në seksionin 294 “Blerja dhe mbajtja e armëve të zjarrit dhe trafikimi i tyre” parashikon: 1. Çdo person i cili për vete apo dikë tjetër fabrikon, importon, eksporton, transporton, siguron apo zotëron municione pa licencë ose kush ndërmjetëson një aktivitet të tillë, *dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.* 2. Çdo person i cili për vete apo dikë tjetër fabrikon, importon, eksporton, siguron apo zotëron një armë zjarri, pjesë apo elemente përbërëse të saj pa pasur licencë ose pa pasur një markë identifikimi të armës sipas një marrëveshjeje ndërkombëtare, ku Republika e Sllovakisë është palë nënshkruese, apo i cili ndërmjetëson një aktivitet të tillë, *dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet [...]* 4. Personi *dënohet me burgim nga katër deri në dhjetë vjet* nëse kryen veprën sipas paragrafëve 1, 2 ose 3: a) duke vepruar në një mënyrë të rëndë; b) për shkak të një motivi të veçantë; c) në një shkallë më të gjerë. 5. Personi *dënohet me burgim nga tetë deri në pesëmbëdhjetë vjet* në qoftë se e kryen veprën sipas paragrafëve 1, 2 ose 3: a) si anëtar i një grupi me rrezikshmëri shoqërore; b) në një shkallë më të gjerë; c) nën një situatë krize”.

59. Për të njëjtat arsye të marra në analizë më lart, Gjykata çmon se ligjvënësi ka cenuar edhe parimin e sigurisë juridike, pasi ky parim lidhet



me plotësimin e disa kërkesave paraprake të detyrueshme gjatë procesit ligjvënës. Sipas Gjykatës, parimi i sigurisë juridike ka si kërkesë të domosdoshme faktin që ligji në tërësi, pjesë apo dispozita të veçanta të tij në përmbajtjen e tyre duhet të jenë të qarta, të përcaktuara dhe të kuptueshme. Për të kuptuar dhe zbatuar drejt këtë parim kërkohej që ligji në një shoqëri të ofrojë siguri, qartësi dhe vazhdimësi, në mënyrë që individët t'i drejtojnë veprimet e tyre në mënyrë korrekte e në përputhje me të. Një rregullim i pasaktë i normës ligjore dhe që sjell pasoja, nuk shkon në përputhje me qëllimin, stabilitetin, besueshmërinë dhe efektivitetin që synon vetë norma (*shih vendimet nr. 9, datë 26.2.2007; nr. 36, datë 15.10.2007; nr. 52, datë 1.12.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Me ndërhyrjen në nenin 278 të KP-së ligjvënësi nuk ka respektuar aspektin harmonik që duhet të kenë dispozitat e Kodit Penal, të cilat në tërësinë e tyre duhet të përbëjnë një entitet të vetëm, ku të bashkohen vlerat dhe parimet kryesore që udhëheqin këtë kod, që janë shteti i së drejtës, barazia para ligjit, drejtësia në caktimin e fajësisë dhe të dënimit, si dhe humanizmi (*neni 1/c i Kodit Penal*).

60. Gjithashtu, po në këtë drejtim, kjo Gjykatë thekson se që ligji të kuptohet saktë dhe drejt duhet të dalë qartë qëllimi i hartimit të tij. Gjykata konstaton se në relacionin bashkëshoqërues të ligjit nuk ka argumente të mjaftueshme mbi domosdoshmërinë e këtij mjeti ashpërsues. Për më tepër, Kuvendi, si palë e interesuar, nuk paraqiti argumente kushtetuese mbi nevojën, përshtatshmërinë dhe domosdoshmërinë e ashpërsimit të dënimit të mbajtjes pa leje të armëve, bombave, minave ose lëndëve plasëse në mjedise publike apo të hapura për publikun, parashikuar në nenin 278/5 të KP-së, si e vetmja mënyrë për arritjen e qëllimit të ligjvënësit në kuadër të luftës kundër krimit të organizuar dhe sigurisë së rendit publik edhe shoqëror. Në këto kushte, Gjykata vëren paqartësi dhe spontanitet në qëllimin e përzgjedhjes së mjetit të ashpërsimit të dënimit, për rrjedhojë edhe kjo është një arsye e cenimit të parimit të sigurisë juridike.

61. Bazuar mbi analizën e mësipërme, Gjykata gjen rastin të përsërisë qëndrimin e saj të mëparshëm dhe të sjellë në vëmendje të

ligjvënësit se ndërhyrje të tilla duhet të jenë realisht efektive, në mënyrë që t'i shërbejnë jo vetëm luftës ndaj kriminalitetit, por për më tepër parandalimit të kryerjes së veprave penale. Kjo gjykatë ka evidentuar edhe me vendime të mëparshme se eksperiencia ka treguar që ashpërsimi jo proporcional i sanksioneve penale nuk ka pasur gjithmonë ndikim pozitiv ose ndikimi ka qenë i papërfillshëm në arritjen e qëllimeve të legjislacionit penal. Si pasojë, gjatë përcaktimit të dënimit, organi legjislativ nuk duhet të ketë parasysh vetëm parimin e parashikimit me ligj të dënimit. Ai duhet që nëpërmjet formulimit të sanksionit t'i mundësojë gjyqtarit dhënien e një gjykimi të drejtë dhe proporcional në raste konkrete, në përputhje me kërkesat e parimit të shtetit të së drejtës, sigurisë juridike dhe respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të individit (*shih vendimet nr. 13, datë 29.5.1997; nr. 65, datë 10.12.1999; nr. 47, datë 27.6.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

62. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se paragrafi i pestë i nenit 278 të Kodit Penal bie në kundërshtim me parimet kushtetuese të proporcionalitetit dhe të sigurisë juridike, për rrjedhojë duhet shfuqizuar.

63. Përveç sa më lart, Gjykata në ushtrim të kompetencave të saj, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", vlerëson të shprehet me nismën e saj edhe mbi paragrafin e gjashtë të nenit 278 të KP-së. Në këtë dispozitë parashikohet se *kur vepra kryhet në sasi të mëdha, në bashkëpunim, me shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë deri në njëzet vjet*.

64. Gjykata konstaton se paragrafi i gjashtë i nenit 278 të KP-së, mbart të njëjtat probleme kushtetutshmërie, si dhe paragrafi i pestë i nenit 278, i konsideruar si i papajtueshëm me Kushtetutën. Sipas Gjykatës, edhe ky dënim është dukshëm joproporcional. Për më tepër, dhe shprehja "pasoja të rënda" është e paqartë dhe lë vend për interpretime të ndryshme, në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike, për rrjedhojë edhe ky paragraf duhet shfuqizuar.

65. Ndërsa për pretendimin për shfuqizimin e paragrafëve 1, 3 dhe 4 të nenit 278 të KP-së, për shkak se bien në kundërshtim me nenin 17/1 të



Kushtetutës, Gjykata, pasi i mori në analizë, arriti në konkluzionin se nuk kanë elemente të papajtueshme me Kushtetutën.

66. Si konkluzion, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuases për shfuqizimin e paragrafit të dytë të nenit 55, si dhe paragrafit të pestë dhe të gjashtë të nenit 278 të Kodit Penal, për shkak se bien në kundërshtim me nenet 7, 17/1, 135/1 dhe 145/1 të Kushtetutës, janë të bazuara.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 134/ 1/d dhe 145/2 të Kushtetutës, si dhe të neneve 68, 69, 70 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.

- Shfuqizimin e paragrafit të dytë të nenit 55 të Kodit Penal, shtuar me ligjin nr. 144/2013¹⁶, si dhe të paragrafit të pestë dhe të gjashtë të nenit 278 të Kodit Penal, shtuar me ligjin nr. 144/2013, ndryshuar me ligjin nr. 98/2014¹⁷.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletore Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

MENDIM PAKICE

1. Për arsye se nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën lidhur me përfundimin e arritur në këtë çështje dhe argumentet mbi të cilat mbështetet ky qëndrim, e çmojmë të rëndësishme të shprehemi me mendim pakice për secilën nga dispozitat objekt gjykimi.

A. Për pretendimin për cenimin e parimit të pavarësisë së gjyqësorit për shkak të shtesës në nenin

55/2 të KP-së, në kundërshtim me nenet 7, 135/1 dhe 145/1 të Kushtetutës

2. Nëpërmjet arsytimit të saj shumica ka vlerësuar se paragrafi i dytë i nenit 55 të KP-së ndërhyr në atributet ekskluzive të gjykatës lidhur me caktimin e dënimit dhe dhënien e drejtësisë, për rrjedhojë vjen në kundërshtim me nenet 7, 135/1 dhe 145/1 të Kushtetutës dhe si i tillë duhet shfuqizuar (*prg.27 i vendimit*).

3. Shumica është shprehur se neni 55 i KP-së zbatohet dhe duhet të zbatohet nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm në lidhje me nenin 47 të Kodit Penal, sipas të cilit “gjykata cakton dënimin, duke respektuar dispozitat e pjesës së përgjithshme të Kodit dhe kufijtë e dënimeve të parashikuara me ligj për veprën penale”, dhe se “në caktimin e dënimit ndaj personit ajo merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese” (*prg. 23 i vendimit*). Përcaktimi i veprave penale dhe llojeve të dënimeve janë në diskrecion të ligjvënësit, ndërsa individualizimi i tyre, rast pas rasti, është në diskrecion të gjykatës, e cila, duke shqyrtuar të gjitha elementet juridike të veprës penale, shkallën e fajit dhe pasojat e ardhura nga vepra penale, cakton llojin dhe masën e dënimit për autorët e veprave penale. Në këtë kontekst, duke përcaktuar mënyrën e dhënies së dënimit, sipas metodologjisë së parashikuar në paragrafin e dytë të nenit 55 të KP-së, ligjvënësi u ka hequr gjykatave të sistemit gjyqësor të drejtën të vlerësojnë pikërisht elementet e parashikuara në paragrafin e dytë të nenit 47 të KP-së (*prg. 25-26 i vendimit*).

4. Duke pasur parasysh sa më sipër, duket se shumica në thelb i referohet parimit të ndarjes së pushteteve dhe pavarësisë së pushtetit gjyqësor. Ndryshe nga sa argumenton shumica, ne mendojmë se duke zbatuar paragrafin e dytë të nenit 55 të KP-së në caktimin e dënimit, gjykata nuk pengohet në individualizimin e dënimit për veprat penale të krimeve kundër jetës me dashje, me përdorimin pa leje të armëve luftarake dhe municionit, për rrjedhojë ajo nuk pengohet në ushtrimin e atributit gjyqësor, dhënien e drejtësisë.

5. Në vlerësimin tonë, shumica në gjykimin e kësaj çështjeje nuk ka bërë dallimin mes individualizimit të dënimit *in concreto*, si

¹⁶ Votuan kundër shfuqizimit të këtij neni gjyqtarët: S. Berberi, B.Imeraj dhe F.Lulo.

¹⁷ Votuan kundër shfuqizimit të këtyre paragrafëve gjyqtarët: B.Dedja, S. Berberi dhe B.Imeraj.



kompetencë ekskluzive e pushtetit gjyqësor, dhe kompetencës së ligjvënësit për të përcaktuar rregulla *in abstracto* mbi metodologjinë e caktimit të dënimeve.

6. Në lidhje me kontrollin kushtetues të normës penale që përcakton kualifikimin e veprës penale, llojin e dënimeve dhe masën e dënimeve si kompetencë e ligjvënësit, kjo gjykatë ka dhënë në vazhdimësi disa vlerësime në jurisprudencën e saj. Kështu, Gjykata ka theksuar se Kuvendi, në ushtrimin e funksionit ligjvënës, vendos dhe konkretizon politika të caktuara për përmirësimin e qeverisjes dhe zhvillimin e vendit në tërësi ose u përgjigjet prioriteteve apo problemeve të ndryshme të vendit. Vendosja me ligj e llojit të dënimeve ashtu, si dhe vetë masa e tyre është diskrecion i pushtetit legjislativ, i cili në përputhje me kërkesat dhe me nevojat në ndryshim të shoqërisë bën rregullimin ligjor përkatës. Megjithatë, ligjet ose dispozita të veçanta të tyre, të miratuara nga ligjvënësi për këtë qëllim, nuk duhet të vijnë në kundërshtim me dispozitat e Kushtetutës. Detyrë e Gjykatës Kushtetuese është të vlerësojë nëse zgjidhjet ligjore të aplikuara nuk shkelin normat dhe vlerat kushtetuese (*shih vendimet nr. 55 datë 21.7.2015, nr. 71, datë 27.11.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Paragrafi i dytë i shtuar, i cili është bërë objekt kundërshtimi në Gjykatën Kushtetuese, përcakton se *dënimi më i rëndë i shtuar në rastin kur personi ka kryer një krim kundër jetës me dashje, me përdorimin pa leje të armëve luftarake dhe municionit, përbëhet nga shuma e përgjithshme e dënimeve për secilën vepër penale*. Ndërkohë, paragrafi i parë sanksionon se *kur veprimet ose mosveprimet përbëjnë elementet e disa veprave penale, për të cilat nuk është dhënë akoma dënim, gjykata më parë cakton dënimin për çdo vepër penale dhe në përfundim jep një dënim të vetëm, që përbëhet nga dënimi më i rëndë i shtuar*.

8. Referuar paragrafit të dytë të shtuar të dispozitës objekt gjykimi rezulton se gjykatat gjatë gjykimit të veprave penale të lidhura me krimet e vrasjes me dashje, të kryera me përdorimin e armëve, kanë të drejtën e përcaktimit të secilit dënim më vete sipas nenit 47 të KP-së, pra vlerësimin e caktimit të dënimit për secilin nga veprimet apo mosveprimet kriminale, duke marrë parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Ndërsa

në momentin e dhënies së dënimit përfundimtar, si “dënimi më i rëndë i shtuar”, duhet të bëjnë mbledhjen aritmetike të shumës së dënimeve të dhëna veç e veç. Me zbatimin e paragrafit të parë, gjykatat e kishin në vlerësimin e tyre që si dënim përfundimtar të jepnin jo domosdoshmërisht shumën e përgjithshme të dënimeve për secilën vepër penale.

9. Sipas parashtrimeve të subjektit të interesuar (KM), synimi i ligjvënësit për këtë ndërhyrje është bërë me qëllim forcimin e luftës kundër kriminalitetit për veprat penale të vrasjes me dashje, të realizuara me armë pa leje. Po sipas këtij subjekti, ky synim nuk arrihej duke aplikuar rregullat e përgjithshme të parashikuara në paragrafin e parë të nenit 55 të KP-së, por duke parashikuar rregulla të reja për llogaritje të dënimit, me qëllim që të garantohej vuajtja e plotë e dënimit nga personat me rrezikshmëri të lartë shoqërore, të cilët nuk duhej të përfitonin ulje në dëm të interesit publik që mbrohet në këtë rast.

10. Ky qëllim i ligjvënësit shpjegon arsyen për miratimin e paragrafit të dytë të nenit 55 të KP-së, i cili parashikon një rregullim specifik, si përjashtim nga rregulli i përgjithshëm për sa i përket diskrecionit në për llogaritjen e “dënimit më të rëndë të shtuar”. Gjyqtari, referuar paragrafit të dytë të nenit 55, për gjykimin e autorëve të akuzuar për krim kundër jetës me dashje, me përdorimin pa leje të armëve luftarake dhe municionit, është i detyruar të aplikojë si dënim përfundimtar shumën e përgjithshme e dënimeve për secilën vepër penale.

11. Çështja që është shtruar përpara Gjykatës në rastin konkret është nëse dispozita objekt shqyrtimi kufizon diskrecionin e gjykatës për caktimin e dënimit përfundimtar deri në atë pikë sa të cenojë atributin e gjykatës për dhënien e drejtësisë në mënyrë të pavarur.

12. Në çmujmë se në rastin konkret paragrafi i dytë i nenit 55 të KP-së ka rregulluar mënyrën e llogaritjes së dënimit për një kategori të caktuar veprash penale, pa i hequr të drejtën gjykatës që në fazën e parë, duke shqyrtuar të gjitha elementet juridike të veprës penale, rrezikshmërinë e autorit, të veprës, shkallën e fajit dhe pasojat e ardhura, të caktojë llojin dhe masën e dënimit për autorin e veprave penale veç e veç. Për rrjedhojë, gjykata bën individualizimin



e dënimit për çdo veprë penale në përputhje me funksionin e saj të dhënies së drejtësisë. Prandaj, pakica vlerëson se gjyqtari ka pavarësi të plotë për të proceduar mbi individualizimin e dënimit për secilën nga veprat penale, brenda hapësirës që lejon vepra përkatëse. Ndërsa, në fazën e dytë, për dhënien e vendimit përfundimtar, ligjvënësia ka kufizuar diskrecionin gjykatës në përllogaritjen përfundimtare të dënimit më të rëndë të shtuar, pasi është atribut i pushtetit ligjvënës parashikimi i instrumenteve dhe mekanizmave ligjorë efikasë për arritjen e qëllimeve të caktuara në fushën e politikave penale.

13. Për sa më lart, në gjykimin tonë, thelbi i së drejtës, që është dhënia e vendimit për secilën veprë penale nga gjykata në mënyrë të pavarur bazuar në nenin 47 të KP-së, nuk është cenuar. Për më tepër, ky rregullim përjashtimor është bërë jo për të gjitha llojet e veprave penale të parashikuara në Kodin Penal, por vetëm për ato të parashikuara në kreun “Krime kundër jetës të kryera me dashje”, të realizuar me përdorimin e armëve pa leje.

14. Gjithashtu, pakica vlerëson të sjellë si argument bindës një vendim të gjykatës homologe rumune për një normë të ngjashme të shqyrtuar prej saj mbi përllogaritjen e dënimeve, me këtë përmbajtje: *Në rast të kryerjes së disa veprave penale, përcaktohet dënimi për secilën veprë individualisht dhe dënimi aplikohet për sa vijon: “ (...) b) kur janë përcaktuar vetëm dënime me burgim, duhet të zbatohet dënimi më i rëndë, i cili mund të shtohet me 1/3-ën e totalit të të gjitha dënimeve të tjera (...)”*. Kjo gjykatë e ka rrëzuar kërkesën për papajtueshmëri me Kushtetutën, duke konkluduar se “përcaktimi i dënimit penal për kryerjen e disa veprave, që përfshin veprat për të cilat janë përcaktuar vetëm dënime me burgim, duke aplikuar sistemin komulativ (mbledhës/grumbullues) me shtim të detyrueshëm dhe fiks, bie në juridiksionin e ligjvënës, në përputhje me rolin e tij kushtetues si i vetmi autoritet ligjvënës i vendit” (vendim i Gjykatës Kushtetuese Rumune nr. 711, datë 27 tetor 2015, prg. 4, përktim i Gjykatës).

15. Për të gjitha këto, gjyqtarët në pakicë vlerësojnë se pretendimet mbi papajtueshmërinë e paragrafit të dytë të nenit 55 të KP-së me nenet 7, 135/1 dhe 145/1 të Kushtetutës nuk janë të bazuara.

B. Për pretendimin se ndryshimet e bëra në paragrafin pestë të nenit 278 të KP-së cenojnë parimin e proporcionalitetit dhe si të tilla bien ndesh me nenin 17/1 të Kushtetutës

16. Shumica ka konkluduar se paragrafi i pestë i nenit 278 të KP-së bie në kundërshtim me parimet kushtetuese të proporcionalitetit dhe të sigurisë juridike, për rrjedhojë duhet shfuqizuar (prg. 62 i vendimit).

17. Për të vlerësuar shkeljen e standardeve të kërkuara mbi proporcionalitetin shumica ka përdorur si metodologji qasjen krahasimore. Sipas saj: *“Gjykata, për të arritur në një përfundim të drejtë nëse ndërhyrjet e ligjvënësit në nenin 278 të KP-së janë proporcionale në raport me gjendjen që i ka diktuar, e sheh me vend të bëjë një vështirësi krahasues midis paragrafëve të vetë nenit, midis nenit 278 dhe dispozitave të tjera të të njëjtit kre, midis nenit 278 dhe veprave të ndryshme penale që kryhen me përdorimin e armëve dhe midis Kodit tonë Penal për veprën në fjalë dhe kodeve penale të vendeve të rajonit”* (prg. 49 i vendimit).

18. Konstatojmë se shumica për të analizuar shkeljen e parimit të proporcionalitetit i referohet vetëm krahasimit nga pikëpamja normativiste e dispozitës objekt shqyrtimi në raport me dispozitat e tjera të KP-së, pa u mbështetur në argumente faktike, të dhëna statistikore apo konkluzione që vlerësojnë proporcionalitetin.

19. Gjykata ka çmuar në jurisprudencën e saj se vendosja me ligj e llojit të dënimeve, ashtu si dhe vetë masa e tyre është diskrecion i pushtetit legjislativ, i cili në përputhje me kërkesat dhe me nevojat në ndryshim të shoqërisë bën rregullimin ligjor përkatës. Balanca mes së drejtës së kufizuar dhe interesit publik nuk është gjë tjetër veçse gjetja nga legjislatori e pikës së ekuilibrit midis së drejtës së shtetit për të siguruar rendin publik e shoqëror, nga njëra anë, dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të individit, nga ana tjetër (shih vendimet nr. 19, datë 1.6.2011; nr. 47, datë 27.6.2012 të Gjykatës Kushtetuese).

20. Në përputhje me parimin e proporcionalitetit është thelbësore për ligjvënësin të përcaktojë se cilat janë ato veprime të individit që konsiderohen të dënueshme dhe në këtë kuptim nuk i takon Gjykatës të përcaktojë nëse ky vlerësim është mënyra më e përshtatshme, më e arsyeshme ose e duhura, por roli i saj është të kontrollojë nëse përmbajtja e vetë dispozitës penale është e pajtueshme me të drejtat, liritë dhe



parimet themelore kushtetuese (*shih vendimin nr. 55 datë 21.7.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Po kështu, Gjykata, në zbatim të nenit 17 të Kushtetutës, ka zbërthyer kriteret për të vlerësuar nëse një kufizim do të konsiderohej në përputhje me standardet e parimit të proporcionalitetit. Këto kriteret janë: i) objektivi i ligjvënësit është mjaftueshëm i rëndësishëm për të justifikuar kufizimin e së drejtës; ii) masat e marra janë të lidhura në mënyrë të arsyeshme me objektivin - ato nuk mund të jenë arbitrare, të padrejta ose të bazuara mbi vlerësime alogjike; iii) mjetet e përdorura nuk janë më të ashpra se sa për të arritur objektivin e kërkuar - sa më të mëdha efektet e dëmshme të masës së përzgjedhur, aq më tepër objektivi për t'u arritur duhet të jetë i rëndësishëm, në mënyrë që masa të justifikohet si e nevojshme" (*shih vendimet nr. 52, datë 5.12.2012; nr. 7, datë 16.2.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në këtë këndvështrim vlerësojmë se tri parametrat e mekanizmit ligjvënës ndërhyrës: i) nevoja; ii) përshtatshmëria; iii) domosdoshmëria, i imponojnë ligjvënësit të evidentojë nevojën reale të ndërhyrjes në ashpërsinë e dënimit si masë kufizimi e lirisë së personit, si dhe të aplikojë mjete të tilla ligjore, të cilat duhet të jenë efektive, d.m.th. ashpërsia e dënimit të jetë e zgjedhur në mënyrë të tillë që të jetë të përshtatshme për parandalimin e veprave penale të krimit kundër jetës të kryera me armë pa leje. Gjithashtu, domosdoshmëria e detyron ligjvënësin të vërtetojë se synimi i parandalimit të kryerjes së veprave penale të krimit kundër jetës me armë pa leje, nuk mund të arrihet me mjete të tjera dhe se ka përdorur mjetin më pak të dëmshëm (ashpërsimin) për subjektet që u kufizohet liria për shkak të konsumimit të kësaj vepre penale.

23. Bazuar në këto vlerësime mendojmë se në rastin konkret, lidhur me ashpërsimin e dënimit për veprën penale të mbajtjes pa leje të armëve, bombave, minave ose lëndëve plasëse në automjete apo në çdo mjet tjetër të motorizuar ose mjedise publike, pa lejen e organeve kompetente, duhen ballafaquar pretendimet e kërkuar/gjykatës referuese dhe prapësimet e subjektit të interesuar.

24. Kështu, gjykata referuese pretendon se sanksioni për mbajtjen e armëve, bombave

minave ose lëndëve plasëse në automjete apo në çdo mjet tjetër të motorizuar, në mjedise publike ose në mjedise të hapura për publikun, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, që parashikon burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet, sipas paragrafit të pestë të nenit 278 të KP-së, nuk i përgjigjet dukshëm rrezikshmërisë shoqërore të veprës, si dhe nuk përmbush funksionin kryesor të dënimit, që nuk është ndëshkimi i fajtorit, por edukimi dhe rehabilitimi i tij, gjë që vjen në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit, duke rënë ndesh me nenin 17 të Kushtetutës.

25. Ndërsa subjekti i interesuar prapëson se në ndryshimet e dispozitave ligjore objekt kundërshtimi, ligjvënësi është udhëhequr nga interesi publik, konkretisht nga lufta kundër krimit të organizuar, siguria e rendit publik dhe shoqëror, si dhe rritja e efektivitetit të masave shtrënguese ndaj autorëve të veprave penale.

26. Edhe duke iu referuar relacionit bashkë-shoqërues të ligjit rezulton se: "...ndryshimi i legjislacionit në përputhje me evolucionin e shoqërisë dhe të problematikave është detyrë parësore e organeve të shtetit. Ministria e Drejtësisë ka gjykuar si thelbësore ndryshimet në Kodin Penal, me qëllim dhënien e një përgjigjeje sa më të përshtatshme dhe efektive problematikave në rritje apo të reja në fushën penale. Me këto ndryshime është synuar forcimi i luftës ndaj kriminalitetit, duke ashpërsuar dënimet për veprat penale të rënda dhe duke parashikuar rregullat të reja, me qëllim garantimin e vuajtjes së plotë të dënimit nga personat me rrezikshmëri të lartë shoqërore".

27. Në analizë të të dhënave të mësipërme vlerësojmë se parimi i proporcionalitetit kërkon që në thelb masa të jetë mjaftueshëm e rëndësishme për të justifikuar kufizimin e së drejtës dhe të jetë e nevojshme aq sa për të arritur objektivin e ligjshëm. Nga ana tjetër, ashtu sikundër ka theksuar dhe më parë, kjo Gjykatë prezumon pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën, derisa palët t'i provojnë asaj të kundërtën. Kjo do të thotë se lidhur me jokushtetutshmërinë e pretenduar duhet të parashtrohen argumente bindëse para Gjykatës Kushtetuese që të vlerësojë nëse zgjidhjet ligjore të aplikuara shkelin normat dhe vlerat kushtetuese (*shih vendimet nr. 16, datë 25.7.2008; 12, datë 14.4.2010; nr. 29, datë 31.5.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).



28. Në rastin konkret, pakica vlerëson se interesi i ligjvënësit për forcimin e luftës ndaj kriminalitetit ka qenë mjaftueshëm i rëndësishëm për të ndërhyrë në nenin 278 të KP-së. Sipas pakicës, nga kërkuesi nuk janë paraqitur argumente të mjaftueshme për të vërtetuar që ka pasur mjete të tjera më pak të ashpra për të arritur qëllimin e kërkuar, të cilat do ta çonin Gjykatën në konkluzionin se ka mjete të tjera më pak kufizuese. Në këtë kuptim, pakica vlerëson se argumentet e shumicës për joproportionalitetin e mjetit të përdorur nga ligjvënësi në ashpërsimin e dënimit për veprën penale të parashikuar në paragrafin e pestë të nenit 278 të KP-së nuk janë bindëse. Për më tepër, edhe krahasimi me kodet penale të vendeve të tjera evropiane në këtë rast nuk mund të jetë kriter përcaktues për arritjen në konkluzione, pasi ashpërsimi ose zbutja e marzheve të dënimit varion nga situata e kriminalitetit në vend dhe ligjvënësi disponon mjetet e tij të reagimit për të përmirësuar situatën. Situatat mbi kriminalitetin në vende të ndryshme janë të ndryshme, për rrjedhojë edhe ndërhyrja mund të jetë në forma dhe mënyra të ndryshme (*prg. 58 i vendimit*).

29. Në mbështetje të këtij qëndrimi e gjejmë me vend të theksojmë se lidhur me vlerësimin e mjetit të zgjedhur për ndëshkimin e shkelësve të ligjit dhe qëllimit që kërkohet të arrihet, ligjvënësi ka një hapësirë të lirë dhe të gjerë veprimi, e cila mund të shqyrtohet në shkallë të kufizuar nga kjo Gjykatë (*shih vendimet nr. 1, datë 12.1.2011; nr. 55 datë 21.7.2015, nr. 71, datë 27.11.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Pakica evidenton se ajo i përmbahet linjës dhe qëndrimeve të shprehura edhe në disa vendimmarrje të tjera të Gjykatës Kushtetuese, për kontrollin kushtetues të normës penale në raport me atributet e pushtetit gjyqësor për dhënien e drejtësisë, balancën mes pushteteve dhe testin e proporcionalitetit sikundër është vendimi nr. 55 datë 21.7.2015, si dhe vendimi nr. 71, datë 27.11.2015.

30. Ky qëndrim i pakicës është në të njëjtën linjë me qëndrime të Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane kur ka theksuar se “ligjvënësi ka të drejtë të vendosë vetë për llojin dhe masën e veprave të dënueshme penalisht, duke caktuar edhe hapësirën e lejueshme brenda të cilës mund të veprojë gjyqtari. Parashikimi i elementeve thelbësore që bëjnë dallimin midis veprave të

ndryshme penale dhe dënimeve përkatëse të tyre është në vlerësimin e ligjvënësit. Gjykata Kushtetuese nuk ka kompetencë të vlerësojë nëse rregullimi ligjor është më i drejti apo më i përshtatshmi për arritjen e qëllimit të shprehur nga ligjvënësi. Detyrë e Gjykatës Kushtetuese është të vlerësojë nëse kufijtë e jashtëm të hapësirës vlerësuese të ligjvënësit janë kapërcyer ose jo” (*Vendim i GJKF-së Gjermane 105 BVERFGE 135 (154) (2002)*).

31. Përveç këtyre konsideratave, gjyqtarët në pakicë vlerësojnë se shumica me këtë vendim, duke shfuqizuar paragrafin e pestë të nenit 278 të KP-së, mund të krijojë paqartësi dhe pasiguri në organet ligjzbatuese dhe më konkretisht gjykatat e zakonshme, në lidhje me perspektivën e çështjeve konkrete, në gjykimin e autorëve të akuzuar për kategorinë e veprës penale objekt shqyrtimi.

32. Për shfuqizimin me nismën e Gjykatës, të paragrafit të gjashtë të nenit 278 të KP-së, pakica i qëndron së njëjtës linjë të argumenteve për rrëzimin e kërkesës si për paragrafin e pestë të nenit 278 të KP-së.

33. Në konkluzion, gjyqtarët në pakicë vlerësojnë se pretendimet e gjykatës referuese për papajtueshmërinë e paragrafit të dytë të nenit 55 të KP-së dhe paragrafit të pestë dhe të gjashtë të nenit 278 të KP-së nuk qëndrojnë, prandaj kërkesa duhej rrëzuar si e tërë.

Anëtarë: Bashkim Dedja¹⁸ (kryetar), Sokol Berberi, Besnik Imeraj, Fatos Lulo¹⁹

¹⁸ Kryetari Bashkim Dedja i bashkohet kësaj pakice vetëm në lidhje me qëndrimin dhe argumentet mbi paragrafin e pestë dhe të gjashtë të nenit 278 të KP-së.

¹⁹ Gjyqtari Fatos Lulo i bashkohet kësaj pakice vetëm në lidhje me qëndrimin dhe argumentet mbi paragrafin e dytë të nenit 55 të KP-së.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 420 lekë